

**QENDRA SHQIPTARE PER KERKIME  
EKONOMIKE**

**Raport**

**VLERESIM I NDIKIMIT TEK PERFITUESIT (VNDP)  
I PROJEKTIT TE SHPERNDARJES SE SHERBIMEVE  
SOCIALE**

*(Sherbim Konsulence CS/CQ/Ref/No/011-C06)*

**Klienti:**  
**Ministria e Punes, Çeshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta**

**Pergatitur nga:**  
**Grupi i Eksperteve te QShKE**

**Tirane, Dhjetor 2006**

## PËRMBAJTJA E RAPORTIT

### OBJEKTIVAT E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT TE PËRFITUESIT

*Hyrje*

- a) Objektivat Kryesore te Vleresimit
- b) Perfitimet dhe Popullsia e Perfshire
- c) Shkurt mbi Metodologjine e Vleresimit
- d) Treguesit Kryesore te Rekomanduar ne Termat e References (ToRS)

### Kapitulli I

#### METODOLOGJIA E VLERËSIMIT

1. Modelimi i institucioneve te intervistuar
2. Modelimi i perfituesve
3. Instrumentet e Vleresimit
4. Trainimi i intervistuesve
5. Mbledhja e te dhenave
6. Cilesia e te dhenave te grumbulluara
7. Analizimi i te dhenave
8. Kufizimet Metodologjik
9. Stadet e Vleresimit (diagrame)

### Kapitulli II

#### REZULTATET KRYESORE

1. Rezultatet kryesore të Vlerësimit Institucional
2. Karakteristikat e modelit. Rajonet e zbatimit të mini-projekteve
  - 2.1 Tirana
  - 2.2 Durrësi
  - 2.3 Vlora
  - 2.4 Shkodra
3. Plotësimi i objektivave të projektit
4. MÇSSHBB
5. Rezultatet ne aspektet Organizative:
6. Disa Rezultate mbi menaxhimin
7. SHSSH
8. Pushteti vendor/Ofruesit
9. Raportimi dhe monitorimi
10. Pershtatshmeria e sherbimeve sociale ndaj nevojave vendore
11. Pjesemarrja e perfituesve ne programet e sherbimeve sociale
12. Zhvillimi i kapaciteteve

### Kapitulli III

#### REZULTATET E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT TEK PËRFITUESIT

1. Ministria e Punes, Çeshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta
2. Ngritja e kapaciteteve njerezore dhe organizative per hartimin e

- politikave te sherbimeve sociale
- 3. Permiresimi i kuadrit ligjor dhe institucional per menaxhimin dhe shperndarjen e sherbimeve sociale
- 4. Sistemi i standardeve dhe monitorimi i sherbimeve sociale
- 5. Informimi i komunitetit
- 6. Krijimi i nje sistemi te qendrueshem per financimin e sherbimeve sociale
- 7. Njesia e Monitorimit te Varferise
- 8. Instituti i Statistikes (INSTAT)
- 9. Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSh)
- 10. Sherbimi Social Shtetror
- 11. Strukturat rajonale te SHSSH
- 12. Njesite e Qeverisjes Vendore
- 13. Decentralizimi i sherbimeve sociale dhe ndikimi i projektit
- 14. Permiresimi i kapaciteteve institucionale dhe njerezore te qeverisjes vendore
- 15. Vleresimi i nevojave per sherbime sociale
- 16. Partneriteti midis pushtetit Vendor, OJF-ve dhe komunitetit
- 17. Roli i OJF-ve ne Sistemin e Sherbimeve Sociale
- 18. Planifikimi i veprimtarive per te ardhmen
- 19. Vleresime mbi veprimtarine e qendrave te sherbimeve sociale
- 19.1 Gjitheperfshirja – ne te gjitha fazat e zhvillimit te sherbimeve sociale
- 19.2 Procedura, aktore te perfshire
- 19.3 Licensimi i OJF - siguri per arritjen e sherbimeve cilesore
- 19.4 Pershtatshmeria e sherbimeve te ofruara nga OJF
- 20. Kapacitetet e OJF si ofruese te sherbimeve
- 21. Karakteristikat socialo-demografike të përfituesve të intervistuar
  - 21.1 Te dhena social demografike per qarkun Tirane
    - 21.1.1 Karakteristikat e perfituesve te intervistuar sipas njesive vendore, ofruesve te sherbimit dhe kategorive sociale per qarkun Tirane
  - 21.2 Te dhena social demografike per qarkun Shkoder
    - 21.2.1 Karakteristikat e perfituesve te intervistuar sipas njesive vendore, ofruesve te sherbimit dhe kategorive sociale per qarkun Shkoder
  - 21.3 Te dhena social demografike per qarkun Durres
    - 21.3.1 Karakteristikat e perfituesve te intervistuar sipas njesive vendore, ofruesve te sherbimit dhe kategorive sociale per qarkun Durres
  - 21.4 Te dhena social demografike per qarkun Vlore
    - 21.4.1 Karakteristikat e perfituesve te intervistuar sipas njesive vendore, ofruesve te sherbimit dhe kategorive sociale per qarkun Vlore
- 22. Përshtatshmëria e shërbimeve të projektit ndaj përfituesve
- 23. Pjesmarrja e perfituesve në faza të ndryshme te sherbimeve
- 24. Përfituesit direkte dhe indirektë te shërbimeve
- 25. Vlefshmëria dhe cilesia e shërbimeve të OJF-ve
- 26. Ndikimi ne jeten e perfituesve
- 27. Ndikimi i sherbimeve te ofruara mbi target grupet ne risk
- 28. Ndikimi ne grupet e varfëra
- 29. Njohurite e përfituesve mbi elementët e sherbimit te ofruar
- 30. Ndikimi i menaxhimit te OJF-ve tek Perfituesit

DISA REKOMANDIME KRYESORE

#### IV. REFERENCA

Literature e zgjedhur

#### V. ANEKSE

## SHKURTIMET (Abbreviations)

- BB - Banka Boterore  
 BC - British Council  
 CBO - Organizata me Baze Komunitare  
 DFID - Departamenti pere Zhvillim Nderkombetar (Britania Madhe)  
 DPSHS - Drejtoria e Politikave te Sherbimeve Sociale  
 GP - Grupi i Punes  
 INEPPAKSS - Inspektorati i Ndhmës Ekonomike, Pagesës për Personat me Aftësi të Kufizuar dhe Shërbimeve Shoqërore  
 INSTAT - Instituti i Statistikes  
 ISSh - Instituti i Sigurimeve Shoqerore  
 KKSh - Kryqi i Kuq Shqiptar  
 KVNPSRK - Komiteti i Vleresimit te Nevojave dhe Planifikimit te Sherbimeve te Reja ne Komunitet  
 LSMS - Matja e Nivelit te Jeteses  
 MB - Ministria e Brendshme  
 MPÇSSHB - Ministria e Punes, Çeshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta  
 MSI - Sistemi i Informacionit per Monitorimin  
 NE - Ndhma Ekonomike  
 NJKP - Njesia e Koordinimit te Projektit  
 NMV - Njesia e Monitorimit te Varferise  
 OJF-të - Organizata Jo-Fitimprurese  
 PAK - Persona me Aftesi te Kufizuar  
 QShKE - Qendra Shqiptare per Kerkime Ekonomike  
 SBGj - Strategjia për Barazine Gjinore  
 ShSSH - Sherbimi Social Shteteror  
 SKShSh - Standardet Kombetare te Sherbimeve Shoqerore  
 SKTQNj - Strategjia Kunder Trafikimit të Qenieve Njerezore  
 SKZHES - Strategjia Kombetare per Zhvillimin Ekonomik dhe Social  
 SMAP - Sektori i Monitorimit, Analizes dhe Programimit  
 SMSF - Sektori i Monitorimit te Strategjise per Femijet  
 SMSKR - Sektori i Monitorimit te Strategjise se Komunitetit Rom  
 SPAK - Strategjia e Personave me Aftesi te Kufizuara  
 SR - Strategjia e Romeve  
 SSD - Projekti i Shperndarjes se Sherbimeve Sociale  
 SSHS - Strategjia e Sherbimeve Sociale  
 ToRs - Termat e References  
 VKM - Vendim i Keshillit te Ministrave  
 VNDP - Vleresim i Ndikimit tek Perfituesit  
 VNICA - Vleresim i Kapcitetit Institucional te Njerezve ne Nevoje  
 WP - Planin e Punes per Zbatimin e Projektit

## OBJEKTIVAT E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT TE PËRFITUESIT

### Hyrje

Ne perputhje me Termat e Referencës (ToRs) në Raportin mbi Vlerësimin e Ndikimit mbi Perfituesit (VNDP) të Projektit të Shpërndarjes së Sherbimeve Sociale (SSD). Grupi i Punës (GP) të Qendres Shqiptare për Kërkime Ekonomike (QSHKE) ka patur parasysh si vlerësimin e institucioneve të angazhuara në hartimin, monitorimin dhe zbatimin e projektit, ashtu edhe ndikimin në perfituesit e drejtperdrejte të tij<sup>1</sup>. Vlerësimi i Ndikimit të Projektit të BB për shërbimet sociale në rajonet pilot të Tiranës, Durrësit, Vlores dhe Shkodrës është realizuar nëpërmjet analizës dyplanëshe: vlerësimi të Ndikimit për rritjen e kapacitetit të institucioneve qendrore, pushtetit vendor, ofruesve të shërbimeve si qendrave për të moshuarit, femijet e braktisur, personave me aftësi të kufizuara, të rinjve e grave dhe, nga ana tjetër, të Ndikimit të këtyre shërbimeve në përmirësimin e jetës së grupeve në risk.

Çështja shtrohet nëse ofruesit e shërbimeve, në të gjitha nivelet, prej MPÇSSH, ShSSH, pushtetit vendor (qarku, bashkia dhe komuna), dhe gjithë iniciativave në nivel komunitar të OJF-ve, janë të aftë për t'u përgjigjur në mënyrë adekuate me shërbime sociale kërkesës për përmirësimin dhe ndryshimin e situatës së grupeve në nevojë? Sepse ky është në fund të fundit edhe prioriteti i të gjitha zhvillimeve institucionale, të lidhura me decentralizimin, gjithëpërfshirjen e aktoreve të komunitetit, de-institucionalizimin: rritja e mundësive të zgjedhjes, të shkallës së pavarësisë së perfituesve të shërbimeve sociale dhe e cilesisë së jetës së tyre në përgjithësi.

Krahas vlerësimeve institucionale, është analizuar gjerësisht tipologjia e shërbimeve të ofruara, ku vihet re një ndryshim çësësor në krahasim me atë të përshkruar në VNICA. Nga studimi konstatohet prirja e rritjes së kapaciteteve të ofruesve: zhvillimi i shërbimeve sociale të reja alternative; detajimi i funksioneve dhe roleve sociale, nivelit profesional të tyre, procedurave të inspektimit; përcaktimi i treguesve për vlerësimin e nevojave sociale në nivel lokal si dhe krijimi i rrjetëve të bashkëpunimit në nivel lokal, rajonal e më gjere, për rritjen e efektivitetit të shërbimeve sociale. Procesi i hartimit, zbatimit dhe vlerësimit të shërbimeve sociale ka përfshirë të gjithë aktoret sociale, ndonëse ndjehet nevojë për një angazhim më të madh të pushtetit vendor, nga komunat, bashkitë e veçanërisht qarkut për zhvillimin e planeve komunitare për shërbime sociale.

### 1. Objektivat Kryesore të Vlerësimit

Objektivi kryesor i Vlerësimit të Ndikimit të Perfituesit (VNDP) është t'i sigurojë Njësise të Koordinimit të Projektit (NJKP) dhe aktoreve të tjere të përfshirë në zbatimin e SSDP një informacion gjithëpërfshirës sasior dhe çësësor mbi efektivitetin e veprimtarive të projektit, të bazuar mbi përfundimet dhe rezultatet e arritura në fazën e parë (pilot) të zbatimit të tij.

Nëpërmjet VNDP synohet të analizohet të matet ndikimi aktual i nderhyrjeve të bera përmes veprimtarive të projektit lidhur me grupet sociale në nevojë (përfshirja dhe përmirësimi i jetës së tyre) si edhe kapacitetet institucionale për shërbimet e kujdesit social (përfshirja dhe përmirësimi i kapaciteteve – formulimi dhe zbatimi i politikave). Gjithashtu, VNDP vlerëson edhe ndikimin e komponenteve të projektit të Shpërndarjes së Sherbimeve Sociale (SSD) në institucionet e mbështetura ((Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shansëve të Barabarta (MPÇSSH); Sherbimi, Social Shtetëror (SHSSH) Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH)), si edhe autoritetet vendore dhe

<sup>1</sup> Shih Aneks #1. "Lista e institucioneve, drejtuesve dhe stafit të nenprojekteve dhe grupeve të perfituesve të intervistuar".

ofruesit e sherbimeve (nen-kontraktoret) ne kater zona pilot: Tirane, Durres, Vlore dhe Shkoder.

## 2. Perfitimet dhe Popullsia e Perfshire

Perfitime afat-gjata perfshijne: mireqenien e permiresuar te disa grupeve te varfera te popullise dhe grupeve ne nevoje ne zonat e percaktuara nga projekti: rritja e kapaciteteve te institucioneve vendore per te ofruar sherbime sociale, permiresimi i sistemit te kujdesit te sherbimit social dhe nje qendrueshmeri me e madhe e sherbimeve.

Perfitimet do te perfshijne gjithashtu politikat, standartet, udhezuesit dhe praktikat e permiresuara per sherbimet e kujdesit social, qe do te zhvillohen gjate zbatimit te projektit SSD. Perfitimet e terthorta perfshijne zhvillimin e shoqerise civile dhe kohezionin social, ndergjegjesimin me te madh te publikut lidhur me shtresat ne nevoje ne komunitetin e tyre dhe krijimin e besimit ne institucionet qytetare.

Grupet kryesore te targetuara (por pa u kufizuar vetem me to), perfshijne grupet e varfera dhe ne nevoje te popullise, te tilla si:

- femijet dhe te rinjte ne riskun e largimit nga shkolla dhe te perfshirjes ne veprimtari kriminale, prostitucion edhe/ose droge;
  - femijet pa kujdes prinderor dhe femijet e institucionalizuar (te vendosur ne jetimore);
  - te moshuarit e vetem dhe te braktisur, grate-kryefamiljare dhe grupe te tjera te popullise te distancuara, te cilat jane ne riskun e vecante te perjashtimit social;
  - komunitetet, te cilave u perkasin keto grupe te popullise.
- Ndersa grupi i dyte i vleresimit VNDP perfshin:
- Organet perfaqesuese te pushtetit vendor;
  - Organizatat Jo-Fitimpruruese (OJF) dhe Organizatat me Baze Komunitetin (CBO);
  - Institucionet qendrore si MPÇSSHB, SHSSH, ISSH, INSTAT;
  - Pjestare te tjere te shoqerise civile, te cilet perfitojne nga trainimi dhe nga ndermarrja e programeve per grupet paresore.

## 3. Shkurt mbi Metodologjine e Vleresimit

VNDP perfshin studimin e hollesishem dhe analiza te ndryshme te te dhenave ne dispozicion dhe intervista te thelluara e diskutime mbi grupet kryesore te perfituesve.

Vleresimi VNDP mbeshetetet gjeresisht ne nocionet dhe analizen e Raportit VNICA te pergatitur gjate fazes se pergatitjes se projektit (Korrik 2000)<sup>2</sup>. Gjate vleresimit VNDP jane kryer intervista me perfaqesues te pushtetit/institucioneve dhe zyrtare publike, OJF-ve vendore dhe individe/grupe perfituesish te drejtperdrejte dhe te terthorte nga zbatimi i projektit.

Grumbullimi i informacionit u perqendrua kryesisht ne:

- Vleresimin e permiresimeve dhe ndryshimeve te politikave ligjore dhe institucionale te realizuara;

<sup>2</sup> Nder te tjera, raporti VNICA permban te dhena baze mbi numrin e popullise ne nevoje, llojin dhe numrin e sherbimeve te mbeshetura ne kater zone (qarqe) te vendit: Tirane, Durres, Vlore dhe Shkoder, etj.

- Vleresimin e kapaciteteve institucional per te grumbulluar, analizuar dhe hartuar informacion te besueshem per monitorimin e varferise dhe vleresimin e programeve sociale;
- Vleresimin e kapacitetit te MPCSSHB per formulimin e politikave dhe monitorimin e politikave te zhvilluara;
- Hartimin dhe sigurimin e informacionit per vellimin dhe llojin e sherbimeve te kujdesit social te zbatuara aktualisht;
- Kapacitetin dhe vleresimin institucional te kategorive te qeverise qendrore dhe vendore, OJF qe sigurojne sherbime sociale per grupet ne nevoje ne rajonet e perzgjedhura per zbatimin e projektit; punonjesit sociale dhe stafin pergjegjes ne qendrat sociale;
- Vleresimin e nivelit te pjesemarrjes dhe te perfshirjes se pushtetit vendor, komuniteteve vendore dhe shoqerise civile ne shperndarjen e sherbimeve. Ne nivel vendor, vleresimi do te zhvillohet ne te kater zonat (qarqet) e perzgjedhura per fazen e pare (pilot) te projektit SSD: Tirana, Durresi, Vlora dhe Shkodra. Gjetjet, pergjithesimet dhe rekomandimet e VNDP do te lehtesojne edhe/ose argumentojne nderhyrjet institucionale dhe ligjore dhe sigurojne informacion te dobishem per fazen vijuese te zbatimit te projektit. Burimet dhe metodat e mbledhjes se te dhenave dhe vleresimi i tyre jane konsultuar, diskutuar dhe bashkerenduar me NJKP dhe institucionet e tjera pjesemarrrese.

#### 4. Treguesit Kryesore te Rekomanduar ne Termat e References (ToRS)

Disa nga indikator te mundshem ne klasifikimin e grupeve/shtresave ne nevoje sipas qarqeve mund te jene si vijon<sup>3</sup>:

- Raporti i popullsise qe ka perfituar nga projekti SSD kundrejt<sup>2</sup> numrit total te popullsise se vendit;
- Numri i sherbimeve sociale me baze komunitare te krijuara si rezultat i zbatimit te projektit;
- Numri i perfituesve qe kane patur akses ne sherbimet sociale;
- Numri i fushatave te ndergjegjesimit publik dhe permiresimi i perceptimit publik per ceshtjet e perfshirjes sociale tek grupet ne nevoje te popullsise;
- Rritja e efciences dhe zvogelimi i kosos per perfitues per sherbime sociale menaxhuar nga SHSSH dhe institucione te tjera;
- Numri i sherbimeve sociale me baze komunitetin te krijuara rishtas;
- Perqindja e popullsise me sherbime te permiresuara, ne total dhe sipas llojit te nen-projekteve;
- Numri i punonjesve sociale dhe shoqatave te tjera te trainuar nga projekti SSD;
- Raporti i njesive te pushtetit vendor te trainuara kundrejt numrit total te pjesemarrsesve;
- Raporti i OJF te trainuara kundrejt totalit te pjesemarrsesve;
- Perqindja e perfituesve qe jane te kenaqur me sherbimet e siguruara ndaj tyre.

<sup>3</sup> Shih Aneks #7, Lista e Indikatoreve te SSDP, sipas NjKP, BIA e SSDP, ACER 2006

## Kapitulli I.

### METODOLOGJIA E VLERËSIMIT

#### Hyrje

Bazuar ne Planin e Punës për Zbatimin e Projektit (WP) dhe ne metodologjine e miratuar nga Njësia e Koordinimit të Projektit (NJKP), ne procesin e grumbullimit të informacionit baze, janë përdorur gjerësisht intervistat në thellësi, si me përfaqësuesit e institucioneve kryesore të përfshira në projekt, OJF të kontraktuara nga NJKP, ashtu edhe me përfituesit e shërbimeve të tyre. Kjo është realizuar mbi bazën e disa pyetesoreve të strukturuar dhe gjysme të strukturuar<sup>4</sup>. Grupet kryesore të përfituesve të intervistuar kanë përfshirë shtresat vulnerabile të popullsisë si: fëmijet dhe të rinjtë në riskun e largimit nga shkolla dhe të përfshirjes në krim, prostitucion dhe ose droga; fëmijet pa kujdes prindëror; të moshuarit e vetëm dhe të braktisur; grata kryefamiljare dhe grupe të tjera specifike të popullsisë, të cilat janë nën kërcenimin e përjashtimit social; komunitetet, të cilave u perkasin keto grupe, etj.

Njohja dhe vlerësimi i tipeve të ndryshme të nenprojekteve të shërbimeve sociale të mbështetura nga projektit SSD<sup>5</sup>, të zbatuara në zona me veçori dalluese nga pikepamja social-ekonomike dhe gjeografike, nga OJF në stadi të ndryshme zhvillimi dhe të adresuara grupeve shoqërore specifike në nevojë të ndryshme dhe tipeve të ndryshme të përfituesve, paraqesin një sfidë të madhe për GP. Në keto kushte, si dhe duke marrë në konsideratë kohën që kishin kaluar nga miratimi i projektit (2002) deri në fillimin e levrimit të fondeve për mbështetjen e shërbimeve me baze komunitare në shkallë të gjere në kater zonat pilot (Tiranë, Shkoder, Durrës dhe Vlorë) (2005), GP ka bërë përpjekje për të trajtuar njëkohësisht si aspektet themelore të performancës së përgjithshme të projektit të SSD, ashtu edhe vlerësim të secilës zone dhe nenprojekt.

Duke marrë parasysh kohën dhe burimet që kishin në dispozicion, në konsultim të vazhdueshëm me NJKP, GP ka përshtatur metodologjinë e kryerjes së VNDP duke shfrytëzuar gjerësisht për këtë qëllim raportin VNICA, përvoja të përafërta të vendeve të tjera, materialet metodike të Bankës Botërore (BB), por edhe vlerësimet periodike të misioneve të BB dhe të paleve të tjera të përfshira në zbatimin e tij<sup>6</sup>.

Si çdo vlerësim i kësaj natyre, edhe VNDP e GP/QSHKE ka anet e veta të forta e të argumentuara si dhe kufizimet e veta. Metodologjia e ndjekur prej nesh synon të bashkërendojë aspektet e përbashkëta të grupeve të ndryshme shoqërore në nevojë, dhe mbi këto baze të mundësive nxjerrjen e disa mesimeve apo përvojave nga zbatimi i nenprojekteve të SSD. Duke qenë se pjesë e rëndësishme e punës së GP ka qenë edhe vjelja e opinionëve të drejtuesve dhe specialistëve të institucioneve qendrore të përfshira në hartimin dhe zbatimin e projektit, po aq sa edhe e përfituesve të drejtperdrejte të tij – grupeve shoqërore në nevojë, në Raportin në vijim jepem të dyja keto aspekte, gjë që shpresojmë se do të mundësojë një perceptim sa më realist të ndikimit të tij. Pavarësisht kësaj, jemi të bindur se në çdo rast kemi të bëjmë me vlerësime subjektive nga individë me nivele të ndryshme të formimit kulturor, shkallë të ndryshme njohjeje rreth përmbajtjes dhe qëllimeve të projektit, ndikimeve të pritshme apo të paparashikuara, të drejtperdrejta apo të tërthorta nga zbatimi i projektit në fjalë. Sidoqoftë, realiteti i ofruar përmes pjesëmarrësve në VNDP, ofron një mundësi të çmueshme për të kuptuar perspektivën e zhvillimit të projektit SSD në fazën e dytë të zbatimit të tij.

<sup>4</sup> Shih Aneks #2/1, Pyetesor për Drejtuesit e OJF, #2/2 Pyetesor për Stafin e OJF-ve, #2/3 Pyetesor për Perfituesit e Drejtperdrejte, #2-4 Pyetesor për Perfituesit e Tërthorte.

<sup>5</sup> Shih Aneks #5, Të dhëna mbi Numrin e Përgjithshëm të Perfituesve, sipas NJKP, BIA e SSDP, ACER 2006

<sup>6</sup> Shih Aneks #3, Lista e Dokumenteve Kryesore të Siguruara nga PCU.

## I. Modelimi i institucioneve te intervistuar

NJKP siguroi nje liste te tipologjise se sherbimeve te ofruara ne kuadrin e projektit SSD, te institucioneve qendrore dhe vendore te perfshira ne zbatimin e tij si dhe te OJF te kontraktuara per zbatimin e nenprojekteve qe jane ne zbatim qysh nga fillimi i fazes pilot te tij. Tipologjia e sherbimeve te ofruara ne kuadrin e projektit SSD perfshinte: qendra multidisiplinore; qendra ditore; qendra informacioni dhe keshillimi; sherbim ne qendra familje; kujdestari; programe parandaluese per shendetin; diagnostikimi i hershem; qendër shëndetsore; edukim; strehëza të përkohshme, etj.

Lista e institucioneve qendrore perfshinte: Ministrine e Punes, Çeshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta (MPCSSHB); Sherbimi, Social Shteteror dhe zyrat rajonale te Sherbimit Social Shteteror (ShSSH); INSTAT; Instituti i Sigurimeve Shoqerore (ISSH) dhe Njesine e Koordimit te Projektit (NJKP). Ndersa ajo e institucioneve vendore perfshinte qarqet: Tirane e Durres, bashkite: Tirane; Durres; Vlore; Shkoder; Puke; Kavaje; Orikum; Kamez dhe Fushe-Kruje si dhe komunat: Kerrabe; Paskuqan; Vaqarr dhe Bushat.

Nje liste me vete perbenin edhe Organizatat Jo-Fitimpruruese (OJF) te kontraktuara nga NJKP per te realizuar sherbimet ne formen e listuar me siper. Te tilla ishin gjithsej 18 OJF, te cilat pavaresisht vendit te regjistrimit apo kohes se fillimit te veprimtarise se tyre (njekohesisht apo me perpara se te fillonte projekti SSD), ishin perzgjedhur per te zbatuar nenprojekte te ketij projekti<sup>7</sup>. Ne kete liste dhe ne te dhena te tjera plotesuese te siguruara nga NJKP perfshiheshin edhe te dhena me karakter te pergjithshem is adresat, emrat dhe numrat e telefonave te personave te kontaktit, etj. Nje e dhene e rendesishme per te ndertuar modelin e vrojtimit dhe per te zgjedhur formen e pershtashme per perzgjedhje sa me perfaqesuese ishte edhe nje informacion mbi numrin gjithsej te perfituesve te drejtperdrejte dhe te terthorte te projektit, qe nga fillimi i zbatimit te tij<sup>8</sup>. Pasi disponoi te dhenat e cituara me lart dhe ne konsultim me NJKP,<sup>9</sup> GP/QSHKE percaktoi se personat e kontaktit ne institucionet qendrore dhe vendore, drejtuesit dhe stafi kryesor i OJF zbatuese te nenprojekteve do te intervistoheshin te gjithe, ndersa per perfituesit e drejtperdrejte dhe te terthorte u percaktua nje norme perzgjedhjeje prej jo me pak se 5%<sup>9</sup> e numrit te pergjithshem te tyre. Natyrisht, numri perkates per secilen nga njesite e vrojtimit (OJF e nenkontraktuara) do te percaktohej ne vartesi te numrit te perfituesve ne momentin kur GP do te vizitonte njesine, nga mundesite per te kontaktuar dhe komunikuar me perfituesit e terthorte, etj. Po keshtu, madhesia e ketij numri kushtezohet edhe nga fakti nese ne momentin e vizites se GP ishin te pranishem ose jo nje numer i konsiderueshem perfituesish te drejtperdrejte. Nese ky numer ishte shume i kufizuar (psh vetem disa vete), atehere norma e perzgjedhjes e percaktuar si me siper nuk merrej parasysh, por u intervistuan gati gjysma e perfituesve te pranishmeve.

Pyetesoret e perdorur per realizimin e VNDP, jane ndertuar si nje seri pyetjesh te integruara ne pyetesoret specifike per drejtuesit dhe stafin kryesor te institucioneve ofruese te sherbimeve sociale, si dhe per perfituesit e drejtperdrejte te ketyre sherbimeve. Ndersa pergjigjet e tyre jane sistemuar ne vijimesi. Mund te konfirmohet se pyetesoret kane qene instrumenti me i rendesishem qe GP/QSHKE ka perdorur per mbledhjen e te dhenave te kategoria e perfituesve te drejtperdrejte te projektit SSD. Ne perpilimin e pyetesoreve jane marre ne konsiderate faktore te ndryshem siç jane: objekti i vleresimit (ToRs te VNDP); matja statistikore e rezultatit/ndikimit atje u eshte e mundur; veçorite e formimit te personave qe do te intervistoheshin; specifikat e sherbimit te ofruar ndaj tyre, etj. Komplexiteti i sherbimeve te ofruara nga nenkontraktoret e projektit SSD dhe dallimet qe ekzistonin ndermjet tyre e kufizuan mundesine qe pyetesoret te perdoreshin si

<sup>7</sup> Shih Aneks #4 Tipologjia e Sherbimeve dhe Perfituesit e Projektit, sipas PCU

<sup>8</sup> Shih Aneks #5. Informacioni: "Te dhena mbi Numrin e e Perfituesve te SSDP", PCU

<sup>9</sup> Shih Aneks #6. Te dhena mbi Numrin e Perfituesve te Projektit SSD, sipas BIA

instrumenti kryesor per vleresimin ne teresi te tij. Pavaresisht kesaj, pergatitja e pyetesoreve dhe perdorimi i tyre ka ndjekur rrugen "klasike", dmth hartimi i tyre i eshte nenshtuar fazes se testimit paraprak nga GP, jane kryer permiresimet e rastit dhe pas kesaj eshte marre edhe miratimi zyrtar nga NJKP, perpara se ato te perdoreshin gjeresisht ne te gjitha njesite e vrojtimit.

Per te formuluar Raportin mbi VNDP te projektit SSD, GP ka perdorur edhe Grupet e Fokusuara, te konceptuara si nje diskutim i perqendruar me grupet e perfituesve per te kuptuar Ndikimin e projektit, perspektivat e nevojave te tyre dhe duke i krahasuar ato me konceptet teorike/abstrakte mbi bazen e nje serie pyetjesh te strukturuara posacerisht per vleresimin e Ndikimit. Kjo eshte realizuar si ne fazen fillestare te projektit, me synim ndertimin e pyetesoreve, ashtu edhe ne fazen permbyllese te Raportit, per te konsoliduar gjetjet kryesore te VNDP.

Pra, modeli i vrojtimit qe u perdor ne rastin e VNDP te projektit SSD eshte nje model i kombinuar, dmth jane perdorur gjeresisht disa teknika te analizes dhe te vleresimit si intervistat, grupet e fokusuara, studimi i dokumenteve baze te projektit SSD, etj. Per kete te fundit (dokumentet baze te projektit SSD)<sup>10</sup>, GP/QSHKE i jane siguruar qysh ne fillim te projektit nje pakete e plote e tyre, por te nje rendesie te vecante ishin Aid Memoires, pergatitur nga misionet e pervitshme te BB si dhe nje vleresim i kryer nga British Council (BC) si konsulent i projektit SSD.

Perfundimisht, ne perputhje me ToRs, nepermjet metodologjise se percaktuar te vleresimit, GP/QSHKE ka synuar te merrte ne konsiderate kriteret e meposhtme:

- te mbuloje te gjitha tipet e sherbimeve te ofruar nga projekti SSD;
- te mbuloje teresisht institucionet qendrore dhe vendore te perfshira ne projekt;
- te mbuloje ne shkalle te mjaftueshme nga pikepamja statistikore te gjitha grupet sociale te perfituesve te drejtperdrejte dhe te terthorte te projektit.

Duke qene se çdo projekt dhe çdo ofruer i tij (OJF), i perzgjedhur si nenkontraktor nga NJKP, paraqesin veçori dhe dallime te medha qe veshitresojne gjetjen e tipareve te perbashketa (bashkematjen) e ndikimit te tij perfituesit. GP/QSHKE percaktoi vleresimin e detajuar mbi bazen e zonave pilot te projektit SSD, si nje mundesi per te zbutur kete kufizim ne pergatitjen e Raportit te VNDP.

GP/QSHKE ka bere perpjekje konstante per te shfrytezuar data-base te NJKP te projektit SSD, por vonesa ne fillimin e ndertimit se Sistemit te Informacionit per Monitorimin (MSI) dhe sidomos mungesa e informatizimit te informacionit ne dispozicion te NJKP, nuk kane lejuar nje gje te tille. Prandaj GP/QSHKE e konsiderojne si mjaft emergjente zgjidhjen e ketij problemi ne menyre qe te grumbullohet, sistemohet dhe te perpunohet me metoda bashkohore nje informacion i detajuar dhe ne vijimesi. Vetem ne kete menyre do te mund te arrihet ne perpilimin e nje vleresimi te vecante per çdo nenprojekt, gje qe rekomandohet per kryerjen e VNDP te ardhshem.

<sup>10</sup> Shih: Aneks #7 "List of SSDP Indicators", e siguruar nga PCU dhe Aneks #3 te cituar me lart.

## 2. Modelimi i perfituesve

Ne procesin e modelimit te perfituesve, GP/QSHKE u perball me disa veshtiresi qe lidhen me pamundesine e sigurimit e informacionit baze mbi te cilin duhej te ngrihej modeli. Keshtu per shkak te mungeses se MSI dhe te data-bases elektronike perkatese, ishte e pamundur te sigurohej nje liste emerore e perfituesve te drejtperdrejte dhe te terthorte (individive pjestare te grupeve perfituese) te projektit SSD qysh nga fillimi i zbatimit te tij. Madje kjo ishte e pamundur te sigurohej edhe nga zyrat e nenkontraktoreve (OJF) te financuara nga projekti. GP u njoh me praktiket qe perdoreshin per dokumentimin e rasteve te shqyrtuara dhe mesoi se ne nje numer syresh mbanin nje dokumentacion te posaqem si kartela personale dhe disa rregjistra te perfituesve, por ende te paunifikuar nga projekti SSD. Te tilla ishin kryesisht ato OJF qe ishin ngritur me pare se te fillonte projekti SSD ose/edhe qe ishin financiar/financoheshin edhe nga donatore te tjere. Ndersa per perfituesit e terthorte, ne perputhje edhe me specifikat e sherbimeve qe ofroheshin, vleresimet e OJF beheshin ne menyre te perafert, gje qe le shteg per pasaktesi ne raportim dhe eventualisht edhe ne matjen e efektiviteti te projektit dhe te ndikimit te tij. Duhet theksuar se nga intervistat me drejtuesit dhe stafin e institucioneve shtetore te perfshira ne zbatimin e projektit SSD dhe materialet e siguruar prej tyre, rezulton se kisahte perfunduar pergatitja e kuadrit rregullator per unifikimin e dokumentacionit duke perfshire edhe treguesit perkates te matjes dhe te vleresimit te ndikimit te projektit tek perfituesit. Ndersa venia ne jete e ketij sistemi pritet te filloje ne vitin 2007.

Ne NJKP dokumentoheshin ne numer kryesisht perfituesit potenciale (ose te planifikuar) ne kohen e paraqitjes se projekt-propozimeve dhe GP/QSHKE u perball me dilemen nese do te perdorte "si nje emerues te perbashket" te gjithe perfituesit e propozuar ne projekt-propozimin e secilit prej nenprojekteve te financuara, apo vetem ato qe kane perfituar ose qe u ka sherbyer drejtpersedrejt çdo nenprojekt. Per qellime studimi, u be nje ndatje e perfituesve ne "perfitues te drejtperdrejte" (numri i pjestareve te grupit social qe u ka sherbyer drejtpersedrejt çdo nenprojekt) dhe ne "perfitues te terthorte" (numri i pjestareve te familjes, rrethit familjar edhe/ose komunitetit qe u ka sherbyer terthorazi çdo nenprojekt). GP grumbulloi informacion njekohesisht si nga NJKP, ashtu edhe nga OJF-te e kontraktuara per zbatimin e nenprojekteve e pushteti vendor i zones ku zbatohet projekti dhe ne perfundim, ne disa raste u konstatuan diferenca, te cilat lidhen me kohen e fillimit dhe statusin e sotem te zbatimit te projektit. Sidoqofte, bazimi ne keto te dhena ne ndertimin e modelit te perfituesve nuk mund te mos permbaje nje shkalle te caktuar pasaktesie, por qe gjykohet se nuk ndikon ne determinimin e tendencave per efekt vleresimi te ndikimit te projektit.

GP/QSHKE çmon se percaktimi i nje menyre te detajuar te dokumentimit te perfituesve, duke perfshire edhe kategorine e emertuar si "perfitues te terthorte", duhet te jete ne fokus te nderhyrjeve per te stabilizuar efektivitetin e zbatimit te projektit SSD, ne fazen e dyte te tij, duke rritur ne kete menyre edhe saktesine e vleresimeve VNDP te ardhshme. Kjo situatë e veshtiresoi ndertimin e modelit per perfituesit, prandaj GP zgjodhi rrugen e sqaruar hollesisht me siper ne kete Raport.

Ne kete menyre, per secilin nenprojekt dhe grup social perfituesish, GP perzgjodhi perfituesit per t'u intervistuar ne menyre te rastesishme, aty ku ishte e mundur dhe ekzistonin regjistrat perkates, si dhe ne bashkepunim me drejtuesit/stafin e OJF-ve ne disa raset te tjera, duke mundesuar nje perfaqesim te mjaftueshem nga pikepamja statistikore.

### 3. Instrumentet e Vleresimit

Mbi bazen e metodologjise se vleresimit te sqaruar me siper, GP/QSHKE perdori nje metode interaktive studimi, duke kombinuar metodat sasore dhe ato cilesore, si dhe duke vene ne perdorim pyetesore pjeserisht te strukturuar, si per drejtuesit dhe stafin kryesor te OJF, ashtu edhe per perfituesit, (te drejtperdrejte dhe te terthorte), te projektit SSD. Sipas kesaj metode, pyetesoret u ndertuan duke marre ne konsiderate çeshtjet e sugjeruara ne ToRS<sup>11</sup> dhe ishin te hapura, nje pjese e mire e tyre, ndersa pergjigjet e te intervistuarve u analizuan dhe debatuan gjeresisht nga GP, duke synuar determinimin e prirjeve dhe e elementet e perbashket te tyre. Per kete qellim, GP/QSHKE hartoi dy instrumente te posaqme vleresimi (Liste Çeshtjesh per intervistat me drejtuesit dhe specialistet e institucioneve qendrore dhe Pyetesor per drejtuesit dhe stafin kryesor te OJF, te pushtetit vendor dhe per Perfituesit e drejtperdrejte dhe te terthorte nga zbatimi i projektit SSD), ne perputhje me objektivat e vleresimit dhe sipas percaktimeve te ToRs.

Lista e Çeshtjeve<sup>12</sup> per intervistat me drejtuesit dhe specialistet e institucioneve qendrore u hartua per te siguruar informacion mbi fusha te tilla si: profili i institucionit; roli i tij dhe detyrat specifike ne zbatimin e projektit SSD; shkalla e njohjes se objektiveve dhe rezultateve te projektit; ndikimi i projektit mbi kapacitetin zhvillues te institucioneve; perfituesmeria e institucioneve nga pikepamja e kapaciteteve per shkak te zbatimit te projektit; etj.

Pyetesoret u testuan ne dy OJF, nje ne Tirane dhe tjetra ne Vaqarr, ne perpjekje per te sqaruar mundesine e zbatimit te tyre ne OJF ne shkalle te ndryshme zhvillimi dhe te ngritura njera shume kohe perpara fillimit te projektit (Tirana) dhe tjera e ngritur per shkak te tij (Vaqarri), por edhe ofruese te kategorive te ndryshme te sherbimeve sociale, si dhe me vendodhje njera ne zone urbane (e kontraktuar nga bashkia) e tjetra ne zone rurale (e kontraktuar nga komuna).

Pas kryerjes se testimit, ne versionin perfundimtar te pyetesoreve u pasqyruan modifikimet e ndryshmet e nevojshme, mbi bazen edhe te komenteteve dhe te reagimeve te marra nga te intervistuarit, si dhe nga drejtuesit dhe stafi kryesor i ketyre OJF.

Pyetesori per Perfituesit u hartua si nje pyetesor pjeserisht i strukturuar, per te kerkuar informacion nga perfituesit e drejtperdrejte, perfaqesues te grupeve sociale perfituese te sherbimeve te ofruara dhe te mbeshtetura nga projekti SSD. Ky pyetesor perfshin rubrika te tilla si: profili individual i perfituesit; informacion rreth sherbimit/sherbimit te marre nga perfituesit; aksesit te tyre ne lidhje me sherbimin (koha, vendi, burimi i informacionit), lidhja ndermjet sherbimeve te ofruara dhe nevojave/perparesive te perfituesve; niveli i kenaqesise (plotesimit te nevojave) me llojin e sherbimeve te marra nga perfituesit; ndikimi i projektit mbi mireqenien e perfituesve dhe te afermeve te tyre; terheqjen e mendimeve opinioneve te perfituesve mbi rruget e permiresimit te zbatimit te projektit ne te ardhmen, etj. Pyetesoret pilot u testuan ne gjithsej 20 perfitues nga rajoni i Tiranes dhe Vaqarrit (ne te njejtat njesi vrojtimi ne te cilat u testuan edhe pyetesoret per drejtuesit dhe stafin kryesor te ofruesve te sherbimeve te projektit SSD). Personat e intervistuar perfaqesonin kategori te ndryshme perfituesish te zgjedhur ne menyre te rastesishme. Pyetesorit iu bene permiresimet perkatese te atyre elementeve qe kishin te benin me njohjen dhe respektimin e standardeve te sherbimeve sociale, te aprovuara para disa muajsh nga qeveria shqiptare, etj. Krahas tyre u vendos qe te kerkoheshin nga ofruesit e sherbimeve nje sere te dhenash qe ato dispononin: rregullore, license veprimtarie, statute, plane pune, tregues stastikore, kartela individuale, etj.

<sup>11</sup> Shih Aneks #2/1 Pyetesoret e BIA per Drejtuesit e Stafin Kryesor te Ofruesve te Sherbimeve

<sup>12</sup> Shih Aneks #10 Liste Çeshtjesh per diskutim me drejtuesit e institucioneve

#### 4. Trainimi i intervistuesve dhe mbledhja e te dhenave

Pas pergatitjes se instrumenteve te vrojtimit dhe testimit te tyre ne dy zona pilot, sikurse u sqarua me siper, gjashte intervistes u trainuan per dy dite nga QSHKE. Pjese e trainimit te tyre, (pervec punes ne terren per vrojtimin), ishte edhe nje pakete njohurish mbi menytrat e grumbullimit te informacionit nga institucionet perkatese publike dhe nenkontraktoret jo-publike te projektit SSD.

Intervistuesit e perzgjedhur per grumbullimin e te dhenave ne terren ishin eksperte me te cilet QSHKE ka bashkepunuar edhe me pare ne veprimtari kerkimore te ngjashme. Trainimi i tyre perfshinte ofrimin e pervojave te njohura ne fushen e studimeve sociale: njohuri rreth teknikave te komunikimit; menyren e perdorimit te intervistave te thelluara, grupet e fokusuara, etj.

Me synim qe nepermjet vrojtimit te grumbullohej sa me shume informacion, GP/QSHKE pergatiti edhe nje udhezues per intervistuesit qe perfshinte edhe nje liste te dokumenteve baze (statute, plane pune, pasqyra mbi menyren e vleresimit te nevojave, etj) te nevojshme gjate procesit te vrojtimit.

Grumbullimi i te dhenave te vrojtimit ne terren u krye sipas parashikimeve te WP. Per kete qellim u ndoq nje radhe pune e tille: ne fillim vrojtimi i krye ne Tirane, duke synuar qe te krijohej edhe pervoja perkatese. Per shkak te afersise se njesive te vrojtimit (OJF), ishin te gjitha mundesite per gjetjen e zgjidhjeve te pershtatshme. Qysh ne fillim u bene disa rregullime procedurale qe vleresohet se ndikuan pozitivisht ne efikasitetin dhe cilesine e informacionit te grumbulluar. Keshtu, se pari, GP/QSHKE percaktoi qe intervistat e thelluara me drejtuesit vendore ne zonat perkatese duheshin bere perpara intervistave me drejtuesit, stafin kryesor te OJF ofruese te sherbimeve te projektit SSD dhe me perfituesit.

Se dyti, GP percaktoi qe intervistat me drejtuesit dhe stafin kryesor te OJF te kryeshin ne menyre te njekohshme dhe ne mjedise te vecanta. Kjo me synim qe te shmangej ndikimi i drejtuesve mbi stafin kryesor, si dhe ndikimin e degjimit te pergjigjeve (per shkak se nje numer pyetjesh ishin te njejta ose te peraferta).

Se treti, per shkak te veshtiresive ne mesatarizimin e pergjigjeve te perfituesve, u korigjua praktika e fillimit te intervistimit individual te tyre pa pranine e personave te trete, duke bere qe nje intervistes te bente pyetjet, ndersa nje i dyte te asistonte te parin, me qellim jo vetem te mos harrohej adresimi i ndonje pyetjeje, por edhe te mbaheshin shenimet perkatese gjate dhenies se pergjigjeve nga i intervistuari. Keto shenime u perdoren gjeresisht ne diskutimet ne QSHKE mbi perfundimet e seciles interviste individuale dhe ne evitimin e pasaktesive te ndryshme si psh ne klasifikimin e ftojeve te sherbimeve te ofruara, ndikimin e terthorte te sherbimeve perkatese, etj.

Se fundi, per shkak te kesaj pervoje te grumbulluar qysh ne fillim te mbledhjes se te dhenave ne terren, GP/QSHKE konkludoi se hartimi i raporteve ne nivel zone pilot mbetej mundesi relativisht e mire, per krahasueshmerine e ndikimit e projektit SSD te perfituesit, per analizimin e menyres se funksionimit dhe marredhenieve ndermjet pushteti vendor dhe ofruesve te sherbimeve (OJF), per identifikimin e vecorive ndermjet te zonave pilot, etj.

Mbledhja e te dhenave zgjati nga mesi i Tetorit deri ne fundin e Nentorit 2006. Gjate kesaj periudhe, ne perputhje me ToRs, stafi mbeshitetes i QSHKE punoi edhe per grumbullimin e te dhenave te pergjithshme ne institucionet qendore shtetore (MPÇSShB, INSTAT, NJKP, Policia e Shtetit, etj). Per kete qellimi ishin pergatitur edhe pasqyrat perkatese te sugjeruara nga ToRS dhe te dhenat e mundshme te perpunuara nga vrojtimi ne terren u perdoren gjeresisht per plotesimin e etyre.

## 5. Cilesia dhe analiza e te dhenave te grumbulluara

Me qellim ruatjen ne menyre te pershtatshme te informacionit te grumbulluar nepermjet vrojtimit ne terren dhe nga institucionet perkatese shteterore. GP/QSHKE vendosi qysh ne fillim qe raportet e hollesishme mbi secilen njesi vrojtimi te intervistuar te pergatiteshin, diskutoheshin dhe te depozitoheshin jo me vone se brenda 2 diteve pas kryerjes se intervistimit, ndersa hedhja ne kompjuter e te dhenave te kryhej paralelisht me kete proces. Per te garantuar cilesine e te dhenave, jo vetem te dhenat e grumbulluara ne terren u rishqyrtuan ne mbledhje te posacme, se bashku me raportin e vrojtimit, por u bene perpjekje qe aty ku ishte e mundur keto te dhena te siguroheshin ose/edhe te kryqezoheshin me te dhenat e siguruara nga NJKP dhe nga burime te tjera zyrtare te informacionit. Pergjithesisht, synimi ishte informacioni te merrej sa me afer burimit te krijimit te tij, por edhe te ishte informacioni i dokumentuar dhe formalisht i referueshem per burimin e tij.

Sidoqofte, duhet pranuar se te dhenat mbi baze deklarimi (intervistat) permbajne nje shkalle te kuptueshme pasaktesie dhe prirja subjektive e disa prej te intervistuarve ishte qe te prezantohej realiteti disi i permiresuar, ose/edhe te dilte ne dukje puna e kryer prej tyre. Nuk perjashtohet nga nje prirje e tille as informacioni zyrtar, madje ne rastet kur ky informacion lidhet me argumentimin e nevojës per mbeshtetje financiare nga qeveria qendrore, nga projekti SSD, nga ISSh, etj., prirja e theksimit te veshtiresive dhe problematikes sociale te zonave te ndryshme eshte edhe me evidente.

Sikurse u sqarua me siper, te dhenat e grumbulluara ne terren dhe nga statistika publike, publikimet e ndryshme, burime jo-zyrtare, etj., fillimisht u kontrolluan per saktesine logjike te tyre, per saktesine e perlllogaritjeve aritmetike, per saktesine e nocioneve te perdorura (per shkak te burimeve te ndryshme te referimit) dhe se fundi u regjistruan ne pasqyrat e pergatitura enkas per kete qellim. Me vone, gjate pergatitjes se Raportit te VNDP, keto te dhena u perdoren per te analizuar aspekte te ndryshme te ndikimit mbi perfituesit te projektit SSD, duke synuar edhe gjetjen e lidhjeve korelative eventuale ndermjet treguesve te analizuar. Duhet theksuar se ndryshe nga c'fare ishte menduar ne kohen e pergatitjes se projekt-propozimit te projektit nga GP/QSHKE, numri i kufizuar i njesive te vrojtimit (vetem 15 OJF gjithsej te mbeshtetura financiarisht nga projekti SSD ne pozicionin e ofruesit te drejtperdrejte te sherbimit deri ne momentin e kryerjes se intervistimit) nuk lejoi qe te perdorej metoda klasike statistikore e analizes se te dhenave ne SPSS per lidhjet korelative perkatese. Pas identifikimit te ketyre lidhjeve, GP/QSHKE u mjaftua ne perpunimin ne Excel te dhenave te grumbulluara, gje qe ishte parashikuar gjithashtu si nje mundesi edhe ne propozimin teknik te saj. Perpunimi masiv stastikor i te dhenave te grumbulluara nepermjet intervistimit ishte gjithashtu i papershtashem edhe ne rastin e perfituesve te drejtperdrejte, kryesisht per shkak te diversitetit te sherbimeve te ofruara nga projekti SSD, kohes se shkurter (jo me shume se nje vit nga fillimi i veprimtarise se shumices se njesive te vrojtimit) dhe pamundesise e sigurimit te informacionit te detajuar nga NJKP, madje edhe per vete indikatorët kryesore te projektit, te parashikuar qysh ne fillimin e zbatimit te tij.

Me synim saktesimin e informacionit te grumbulluar, nje numer OJF u vizituan me shume se nje here per t'u takuar me drejtuesin apo me anetare te stafit qe dispononte informacionin e kerkuar. Pjese e vizitave ishin edhe nje numer OJF (3 gjithsej) te cilat nuk kishin filluar ende veprimtarine e tyre, kryesisht per shkaqe te natyres administrative.

Sidoqofte, GP/QSHKE vlereson se lista emerore e perfituesve duhet hedhur sa me shpejt qe te jete e mundur ne nje database, me synim qe te perdoret pastaj si nje mundesi qe projekti SSD te krijoje mbi kete baze edhe database-in e vet per perfituesit, duke pasqyruar keshtu ne menyre sa me realiste permasat e verteta te ndikimit te projektit SSD ne fazen e dyte te zbatimit te tij.

## 6. Kufizimet Metodologjike

Vleresimi VNDP, edhe pse i mbështetur edhe nga një teresi e të dhënave zyrtare statistikore, vëc të dhënave të mbledhura me intervistim, mbetet një studim i perceptimit. Për këtë shkak edhe Raporti përket që po paraqesim ka anet e forta dhe dobësitë e veta. Të cilat nevojitet të merren në konsideratë në procesin e interpretimit të të dhënave të mbledhura. GP/QSHKE beson se Raporti VNDP në vijim siguron një kuptim të thelluar të perspektivës së ofruesve dhe përfituesve mbi efektivitetin dhe cilësinë e shërbimeve të mbështetura nga projekti SSD dhe disa rekomandime për fazën e dytë të zbatimit të tij.

Gjithashtu, duhen pranuar edhe disa kufizime thuhet se pashmangshme, se pari, përfundimet që jepen me tej në këtë Raport pasqyrojnë pikepamjet e drejtuesve dhe specialistëve të institucioneve qendrore dhe vendore, të drejtuesve dhe të stafit kryesor të OJF si dhe të një numri përfaqësuesish rastësore të grupeve të përfituesve. Edhe pse këto pikepamje mund të motivohen nga prirje të ndryshme të lidhura me vëprimtarinë e përditshme dhe interesat e drejtperdrejtë të të intervistuarve. GP/QSHKE ka bërë përpjekje maksimale për një pasqyrim sa më realist të problematikes dhe arrijeteve të derisotme të projektit SSD që jepet në Raportin në vijim.

Se dyti, edhe pse GP/QSHKE ka respektuar tekniken statistikore për një përzgjedhje sa më të rastësishme të përfituesve si grupi i vetëm ku mund të zbatohet kjo metodë përzgjedhjeje e shembullit të vrojtimit), duhet pranuar se përfaqësuesit e grupeve të intervistuar mund të mos përfaqësojnë me saktësi këto grupe. Sidoqoftë, GP/QSHKE vlerëson se përzgjedhja e bërë lejohet të krijohet një panoramë të përgjithshme e qartë mbi të cilën janë ngritur përfundimet dhe rekomandimet kryesore të Raportit të VNDP, gjë që shpresojmë se do të jetë e dobishme për kalimin në fazën e dytë të zbatimit të projektit SSD.

Pas trainimit, GP në bashkëpunim me NjKP hartoi planin e anketimit të përfituesve të drejtperdrejtë dhe indirekte, të drejtuesve dhe stafit kryesor të OJF, ofruesve të shërbimeve sociale të përzgjedhura nga projekti SSD<sup>13</sup>. Meqenëse midis fazave të ndryshme të projekt-propozimit, miratimit dhe kohës së zbatimit kanë kaluar vite (kjo i përket periudhës 2002-2005) konstatohen diferenca të theksuara në fakt për numrin e përfituesve direkt dhe indirekt<sup>14</sup>. Për pasojë u intervistua numri maksimal i mundshëm në momentin e vizitës tek OJF zbatuese e projektit.

Me poshtë jepet një pasqyre për përfituesit e projektuar, përfituesit që kanë marrë shërbim (përfituesit në fakt) deri në këtë periudhë si dhe numri i intervistave të realizuara nga GP/ACER me përfituesit, sipas qarqeve, kurse në mënyrë analitike këto të dhëna paraqiten në Pasqyrën #1 në vijim:

Pasqyra #1

Te dhëna mbi Përfituesit për Qarqet Pilot

N. nr	Njesia vendore	Sipas planit të projektit			Përfituesit Fakt <sup>15</sup>			Te intervistuar		
		Gjithse	Indirekt	Direkt	Gjithse	Indirekt	Direkt	Gjithse	Indirekt	Direkt
1	Qarku SH	6740	4890	1850	3891	2975	916	137	47	90
2	Qarku DR	710	450	260	400	300	100	19	6	13
3	Qarku TR	10450	7420	3030	1500	985	515	205	44	161
4	Qarku VL	5120	3560	1560	880	570	310	62	0	62
	Gjithsej	23020	16410	6610	6671	4830	1841	423	97	326

<sup>13</sup> Shih Aneks #4.2 Te dhëna për Popullsinë e Trajtuar nga SSDP, BIA e SSDP, ACER 2006

<sup>14</sup> Shih: Aneks #5. Te Dhëna mbi Numrin e Përgjithshëm të Përfituesve Sipas NjKP, BIA e SSDP, ACER 2006

<sup>15</sup> Te dhënat u referohen përfituesve në fakt progresive prej fillimit të veçprimtarisë deri në mesin e muajit Dhjetor 2006. Vazhdimi i projektit gjatë vitit 2007, do të përmirësojë arritjen e objektivave të tij.


Pamundesia e sigurimit nga ana e stafit te OJF te anekseve te intervistave ne momentin e vizites, beri te domosdoshme kontaktimin me shume se njehere me drejtuesit (menaxheret) e projektit.

Percaktimi i perfituesve indirekte eshte shume subjektiv nga ana e ofruesve te sherbimit si ne momentin e propozimit te projektit ashtu edhe ne ate te zbatimit te tij duke sjelle diferenca te medha ne konceptim dhe raportim. Ky problem mendojme se meriton nje vemendje dhen je perpunim te metejshem ne te ardhmen, gjc qe do te ndihmoje per percaktimin me te sakte te efektiviteti te projektit dhe rritjen e perfitueshmerise se grupeve ne nevoje.

Te dhenat e siguruara nga perfituesit e intervistuar, mund te mos pasqyrojne domosdoshmerisht kushtet e tyre social-demografike pasi jane regjistruar sipas perceptimit te tyre, por ato sigurojne ne nivel te kenaqshem mundesine e pergjithesimit per kategorine sociale. Ilojin e sherbimit etj.

Gjithashtu duke qene te konsiderueshem ne numer perfituesit direkt kategoria e te moshuarve (pensionisteve), larmia e karakteristikave eshte e kufizuar dhe nuk nuk ka vend per hapsira. Ndonese GP kishte percaktuar numrin e intervistimeve qe do te realizoheshin me kritere mbi bazen e numrit te perfituesve direkte dhe indirekte qe ishin parashikuar ne projekt-idene qe OJF-te kishin parashikuar ne momentin qe aplikuan, ne teren ky numer ishte jo real sepse numri i perfituesve ishte ende i vogel ne krahasim me ate te parashikuar per shkak te kohes se shkurter te venies ne funksionim te tyre (nga nje deri ne 5 muaj).

7. Stadi e Vleresimit (diagrame)



## Kapitulli II

### REZULTATET KRYESORE TE VLERESIMIT

#### I. Rezultatet kryesore të Vlerësimit Institucional

- Projekti i BB "Shperndarja e sherbimeve Sociale" ka mbeshtetur permiresimet e kuadrit ligjor dhe politikave te sherbimeve sociale, duke krijuar nje baze te plote dokumentash mbi politikat dhe kuadrin ligjor, gjate periudhes 2005-2006, ku si me te rendesishmet permendim Strategjine e Sherbimeve Sociale, Ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", te plotesuara me pothuajse te gjitha aktet nenligjore per zbatim e tyre.
- Projekti SSD ka mbeshtetur zhvillimin dhe institucionalizimin e nje sistemi bashkekohor te standarteve te sherbimeve sociale. Ne periudhen 2005-2006 jane miratuar nga Keshilli i Ministrave Standardet e Pergjithshme te Sherbimeve Sociale (SPShS), si dhe standardet per kategorite e vecanta si femijet, te moshuarit, grate, personat me aftesi te kufizuar (PAK) etj.
- Projekti SSD ka arritur te inkludoje ne kete kuader ligjor nje sere parimesh te rendesishme si decentralizimi dhe de-institucionalizimi i sherbimeve shoqerore, te prezantoje tipologji te reja sherbimesh, nje model qendrueshmerie dhe vazhdimesie te ketyre sherbimeve, partneritet midis shoqerise civile, komunitetit dhe aktoreve te tjere publike dhe private ne ofrimin e sherbimeve sociale.
- Kuadri i ri ligjor prezanton nje fryme liberale dhe decentralizuese te kompetencave dhe pergjegjesive ndermjet aktoreve te perfshire ne proces, si dhe percakton qarte kompetencat dhe rolet e MPCSSHB, SHSSH dhe organeve te qeverisjes vendore.
- Projekti SSD ka mbeshtetur permiresimet ne kuadrin institucional duke ofruar modele te reja njesish, termat e references per secilen prej tyre, te cilat jane finalizuar me krijimin e strukturave vleresuese e planifikuese, monitoruese, trajnuese, dhe informuese ne nivel qendror rajonal dhe lokal, te cilat do te bejne te mundur vleresimin e nevojave dhe ofrimin e sherbimeve sociale sa me prane komunitetit, cilesi sherbimesh nepermjet monitorimit te zbatimit te standarteve, permiresim te kapaciteteve per realizimin e tyre si dhe ndergjegjesim te komunitetit dhe pjesemarrje me aktive e tij.
- Ne funksion te procesit te decentralizimit vleresohet i rendesishem krijimi prane Keshillit te Qarkut te Komitetit te Vleresimit te Nevojave dhe Planifikimit te Sherbimeve te reja ne komunitet me perfaqesim te gjere, i cili do te percaktojte dhe vleresoje nevojat per sherbime sociale, ofruesit e mundshem te tyre si dhe projektet per ofrimin e sherbimeve te reja shoqerore me baze komunitare. Funksionimi i ketyre njesive sapo ka nisur, konsiderohet i vonuar ne raport me kohen e krijimit te tyre, dhe kjo e kondicionuar nga nje sere faktoresh, kryesisht nga pamjaftueshmeria e burimeve qofte financiare dhe humane.
- Ne kete stad, nje proces i rendesishem, eshte rekrutimi i stafit profesioniste dhe me pervoje prane Qarqeve/Bashkive/Komunave per te cilen akoma nuk eshte arritur nje standart duke perjashtuar ndikimet politike dhe nepotizmin.

Edhe pse te gjitha institucionet kane rregullore duke percaktuar kriteret per rekrutim te stafit, bazuar ne merite dhe profesionalizem, praktika e zbatimit te tyre eshte larg modelit qe dizenojne keto rregullore.

- Projekti SSD ka dhene **impakt pozitiv ne ngritjen e kapaciteteve humane te MPCSSHB, SHSSH, INSTAT, njesive te qeverisjes vendore dhe OJF-ve, qofte me asistencë teknike ashtu dhe me nje sere trajnimesh brenda dhe jashte vendit si dhe vizita studimore ne disa vende se Britanine e Madhe, Çeki, me qellim njohjen e eksperiencave te reja, e modeleve te ndryshme te ofrimit/sigurimit dhe financimit te sherbimeve sociale, zhvillimit te sherbimeve sociale lokale permes partneriteteve, krijimit te nje sistemi te monitorimit te indikatoreve sociale etj. Megjithate strukturat institucionale dhe kapacitetet e tyre vazhdojne te mbeten te ekspozuara ndaj ristrukturimeve institucionale apo shkurtimeve te kushtezuara nga zhvillimet politike, duke krijuar paqendrueshmeri te stafit, demotivim ne ushrimin e funksioneve te tyre, dhe ne rastin me te keq keto struktura humbasin kapacitete me njohuri e eksperience dhe te trajnuar ne fushen e sherbimeve sociale).**
- Lidhur me informimin e komunitetit, **Projekti SSD ka mbeshtetur dhe asistuar ne hartimin e nje dokumenti (strategjie) per informimin publik dhe rritjen e ndergjegjesimit te komunitetit per sherbimet sociale, megjithate mbetet ende per tu bere per implementimin e nje fushate ndergjegjesimi per informimin e publikut Informimi dhe ndergjegjesimi i komunitetit mbi problemet e perjashtimit social ende nuk eshte ne nivelin qe te siguroje pjesemarrjen aktive te tij. Kjo eshte evidentuar qofte nga intervistat me organet e qeverisjes vendore te cilat e njihnin shkallen e ndergjegjesimit te komunitetit ne juridiksionin e tyre, ashtu edhe nga intervistat me ofruesit e sherbimeve sociale por the perfituesit e tyre.**
- **Me mbeshtetjen e projektit SSD qofte financiarisht por edhe me asistencë teknike eshte realizuar Matja e Nivelit te Jeteses (LSMS) nga INSTAT, e cila krijon te dhenat per monitorimin e treguesve sociale kyç, që shprehin rritjen ekonomike dhe reduktimin e varfërisë ne vend. Megjithate, ende nuk eshte arritur te krijohet nje sistem i qendrueshem monitorimi i familjeve ne nevoje prane INSTAT, kjo e kondicionuar nga shume faktore, midis te cileve financiare. Per krijimin e nje sistemi te qendrueshem monitorimi, eshte e rëndesishme qe cdo 3 vjet te realizohet nje ankete e tille e matjes se nivelit te jeteses nga INSTAT, ne menyre qe te monitorohet ecuria e indikatoreve te reduktimit te varferise, por per kete mungojne mjetet financiare.**
- **Zbatimi i projektit SSD, po krijon modelin e bashke-financimit per te rritur qendrueshmerine e sherbimeve sociale ne komunitet, edhe pse ky financim eshte ne fazen e pare te tij. Keto jane hapat e pare drejt krijimit te nje sistemi financimi nga njesite e pushtetit vendor, te cilat me perfundimin e projektit SSD do te vazhdonin te siguronin programe sociale nepermjet blerjes se sherbimeve nga OJF-te dhe ofruesit e tjere te sherbimeve sociale<sup>16</sup>.**
- Lidhur me prokurimin e fondeve per sigurimin e sherbimeve sociale, parashikuar ne nenin 18 paragrafi II te Ligjit nr.9355, datë 10.3.2005 *“Per ndihmen dhe Sherbimet Shoqerore* , paketa e legjislacionit per prokurimin publik e cila do te

<sup>16</sup> Shih: Aneks #8 Te Dhena Mbi Investimet per Mjediset e Punes. Gjendjen Funktionale dhe Perballimin e Shpenzimeve Operative.

rregulloje edhe kete pjese eshte duke u diskutuar ne komisionet e Kuvendit dhe shume shpejt do te miratohet.

- **Procesi i decentralizimit, nepermjet transferimit te qendrave te sherbimeve sociale nga pushteti qendror tek pushteti vendor po ecen gradualisht.** Transferimi i qendrave te sherbimeve rezidenciale nga qeverisja qendrore ne varesi te njesive te qeverisjes vendore bashke me transferimin e fondeve, sherbimeve dhe kompetencave ende nuk ka perfunduar..
- **Qarku gradualisht eshte duke marre rolin dhe pergjegjesite qe derivojne nga procesi i decentralizimit te shperndarjes se sherbimeve sociale dhe bashke me te dhe te kompetencave.** Megjithate ka vonesa ne krijimin kapaciteteve institucionale dhe humane per vleresimin, programimin dhe administrimin e shperndarjes se sherbimeve sociale prane komunitetit. ne zbatim te VKM nr.563, date 12.08.2005 "Per percaktimin e pergjegjesive te Qarkut per shperndarjen e sherbimeve te perkujdesjes shoqerore".
- Edhe pse projekti SSD ka mbeshtetur krijimin e nje sistemi te vleresimit te nevojave sherbime sociale ne komunitet dhe planifikimit te tyre nepermjet kuadrit ligjor te miratuar se fundmi. deri me tani vleresimi nga njesite e qeverisjes vendore mbetet larg atij modeli qe synohet.
- **Zbatimi i projektit te BB, SSD ofroi nje model dhe vizion te ri partneriteti midis te gjitha aktoreve por kryesisht midis organeve te qeverisjes vendore dhe OJF-ve, te cilat tashme bashkepunonin ne vleresimin e nevojave.**

2

## 2. Karakteristikat e modelit. Rajonet e zbatimit të mini-projekteve

Karakteristike per te gjitha rajonet eshte ndryshimi i tipologji se sherbimeve te ofruara, ku vihet re nje ndryshim cilesor ne krahasim me ate te pershkruar ne VNICA. Konkretisht:

### 2.1 Tirana

Duke ndjekur zhvillimet e shpejta urbane te zones se kryeqytetit dhe per t'ju pergjigjur nevojave gjithmone e me te medha sociale te popullsis se Tiranes, ku ende zbarkojne nga gjithë Shqiperia, projekti ka bere investime te ndjeshme ne sistemin e sherbimeve sociale. Referuar ofruesve te sherbimeve sociale, Projekti SSD ka investuar ne krijimin e 3 qendrave te reja, krahas investimit ne 3 qendra ekzistuese. Ajo qe te bie ne sy eshte futja per here te pare e sherbimeve sociale ne zonat rurale 2 qendra te reja ne Vaqarr dhe Krrabe, dhe nje qender e re sherbimesh per te moshuarit ne qytetin e Tiranes. Nga qendrat ekzistuese jane mbeshtetur ato qe veprojne kryesisht ne zonat periferike, Kombinat dhe Kamez ku ka nje popullsi heterogjene. Ne zonen e Kamzes, Projekti BB ka mbeshtetur nje qender ditore per femije dhe gra qe veprojnë pikerisht ne zonen e Bathores, qe eshte me te shperngulurit nga zonat Veri-Lindore dhe qe e ka zanafillen e saj me krizen kosovare, 1999. E treta qender ekzistuese, eshte ajo multidimensionale Every Child, qe eshte mbeshtetur nga projekti SSD si me investimet kapitale per mjedisin e veprimtarise se qendres, ashtu dhe per rritjen e kapaciteteve te stafit profesional e saj. Mbeshtetja me investime kapitale ka synuar pothuajse te gjitha qendrat e Tiranes, por deri tani ajo eshte realizuar vetem ne disa prej tyre. Konkretisht ne muajin Tetor-

Nentor qe u realizuan vizitat ne terren, sapo ishin vendosur ne ambientet e reja, megjithë pajisjet perkates qendrat ne Vaqarr, Krrabe, pak me vone Every Child dhe qendra per te moshuarit dhe ende jane ne pritje dy qendrat e tjera ne zonat periferike te Kombinatit dhe Kamzes, te cilat pavaresisht kesaj vazhdojne te kryejne sherbimet ne ambientet e tyre te meparshme. Ky investim kapital synon te siguroje qendrueshmerine e sherbimeve sociale, te cilat deri tani rezulton te kene qene mbeshetur kryesisht nga donatore te huaj sipas prioriteteve te tyre dhe per here te pare OJF-te vendase mbesheten me investime kapitale qe ju krijojne nje lloj garancie per vazhdimesi.

Nje nga arrijtet e projekti SSD eshte nxitja per here te pare e pushtetit vendor per mbeshetjen e OJF-te qe kryejne sherbime sociale. Ne nje pjese te mire te tyre, mbesheteja konsistonte ne venien ne dispozicion te ambienteve prone e pushtetit vendor, te rikonstruara nga projekti SSD, ne kater qendra. Ndersa ne dy te tjerat, Kamez dhe Kombinat pushteti vendor ishte indiferent me mbeshetjen per shpenzimet operative dhe sigurimin e ambienteve.

Referuar nevojave sociale, sipas vleresimit VNICA rezulton qe jo vetem 5 grupet e medha ne risk, por edhe nengrupet e tyre kane nevoja te shumta. Nga kjo pikpamje projekti SSD ka mbeshetur krijimin e sherbimeve multidimensionale, ku ne Tirane tipike eshte qendra e Krrabes. Por edhe qendrat e tjera, ndonese te fokusuara ne ngrupe te caktuara realizonin sherbime edhe per grupet e tjera ne nevojë, sipas rastit. Konkretisht:

1. Every Child, qe ne fillim kishte ne fokus femijet, aktualisht ishte shnderruar ne nje qender qe ofronte keshillime, ndermjetesime per pune edhe per grate e te rinjte.
2. Qendra "Te qendrojme se bashku" ne Kombinat ishte e specializuar te ofronte sherbim per PAK, ndonese ndihmes se saj nuk i shpetonin nenat e femijeve me forma te ndryshme keshillimi, trajtime shendetsore, konsulence juridike, etj. Ende ishin ne pritje te ambienteve te reja per te zgjeruar veprimtarine e tyre.
3. Qendra ditore ne Krrabe, ofronte sherbime edukimi dhe integrimi per femijet, te rinjte, grate dhe sherbente si qender shlodhjeje edhe per te moshuarit e fshatit. Kjo kishte marre investimin me te plote, me ambiente dhe pajisje dhe kishte nje bashkepunim shume te mire me pushtetin vendor.
4. Qendra per grate dhe te rinjte ne Vaqarr, me investim te plote nga projekti SSD ne ambiente te bollshme dhe me pajisje per te zhvilluar veprimtari trajnimesh ne kompjuter, qender shlodhjeje dhe argetimi per grate te zones, ku kishte pajisje kuzhine qe ato mund te organizonin festa, ditelindje per femijet e tyre dhe pajisje per te kryer sherbime lehtesuese per grate si lavatrice, etj. Ndonese ne keto zona pajisje te tilla mund te kete neper disa familje, por tek shumica e popullsise mungojne.
5. Qendra ditore per femije dhe gra ne Kamez (Bathore) ku kalonin ditën si ne kopesht femijet e moshes parashkollore te zones si dhe nenat e tyre. Ende prisnin ambientet e reja qe te zhvillonin sherbime me te zgjeruara per grate dhe vajzat e reja te zones qe kishin nevoja te medha per integrim ne jeten e kryeqytetit.
6. Qendra ditore per te moshuarit e sapo hapur dy jave me pare ne qender te Tiranës.

## 2.2 Durrësi

Mbetet nje nga rajonet qe kerkon mbeshetje me te fuqishme, per shkak te treguesve sociale qe nxjerrin ne pah nevoja sociale te paplotesuara per te gjitha grupet ne nevojë. Ne gjithë rajonin ka vetem nje qender ditore sherbimesh per te moshuarit dhe te rinjte te mbeshetur nga projekti SSD ne bashkine Fushe Kruje. Ajo eshte e sapo krijuar nga projekti SSD, ende mjediset e ofruara nga bashkia ne qender te qytetit ishin te paperfunduara, ndonese investimi dukej i mire, si per vendodhjen ne qender, ashtu dhe

per mjediset e brendshme apo aborin jashte tij. Nje investim i tille i ndjeshem mund te sjelle sherbime model, por ka nevojte te menaxhohet mire. Sherbimi aktual per te moshuarit kishte filluar ne mjediset e bashkise dhe drejtohej nga nje OJF me qender ne Tirane, e cila kishte rekrutuar staf vendas, si mjeken e zones, dhe nje punonjes social, por qe me profesion ishte inxhinier, larg ketij profesioni. Ndoshta me venien ne funksionim te mjediseseve te reja, personeli qe do te rekrutohet duhet te permbushe disa kriteret profesionale, qe te rrishe cilesine e sherbimeve per te moshuarit dhe per te rinjte me probleme te zones. Pothuajse te gjithet te rinjte e konsideruar ne risk ne kete zone jane te papune, prandaj sherbimet ndaj tyre per integrimin ne komunitet konsiderohen me te drejte perparesi e pushtetit vendor.

### 2.3 Vlora

Projekti i Sherbimeve Sociale qe ka financuar BB, perfshin 2 bashki te ketij qarku, ate te Vlores (me 3 qendra sociale), dhe ate te Orikumit me nje qender sociale. Te gjitha qendrat ne qarkun e Vlores kishin perfunduar rikonstrukcionin e ambjenteteve me financim te projektit te BB dhe kishin terhequr paisjet e akorduara si dhe kishin filluar funksionimin, me perjashtim te njerese qender ne Vlore. Me konkretisht, ne qarkun e Vlores operonin:

- 1- Ne bashkine Orikum "Qendra e sherbimeve per te moshuarit dhe te rinjte", e cila net e vertet ofronte sherbime clodhje, argetim dhe kujdes mjekesor per te moshuarit e kesaj bashkie. Fakti qe menaxheri i projektit ishte vete Kryetari i Bashkise se Orikumit kishte ndihmuar ne realizimin e nje bashkepunimi mjaft te mire mes stafit te ojf-se dhe atij te bashkise.
- 2- Bashkia Vlore "Shoqata Femija ne Fokus" sapo kishte hyre ne ambjentet e reja te rikonstruktuar me fondet e Bankes Boterore dhe pritej brenda dy javeve te fillonte aktivitetin e saj.
- 3- Bashkia Vlore "Qendra multidisplinare per te moshuarit" kishte dy muaj qe kishin hyre ne ambjentet e reja te rikonstruktuar me fondet e BB, dhe ofronte sherbime per kujdes shendetesor, clodhje dhe rikreative per te moshuarit.
- 4- Bashkia Vlore, Qendra sociale per sherbime te integruara, kishte disa muaj qe kishte hyre ne ambjentet e reja te rikonstruktuar dhe ofronte sherbime per shendetin riprodhues, keshillim informim dh embrojtje ligjore.

### 2.4 Shkodra

Ne qarkun e Shkodres, nga projekti SSD operojne 5 projekte te sherbimeve sociale, 4 nga te cilet ne Shkoder (3 ne bashkine Shkoder dhe 1 ne Komunen Bushat) dhe 1 bashkine e Pukes. Po zbatohen normalisht te gjitha projektet duke kryer sherbimet sociale te percaktuara ne kontratat e tyre, edhe pse projekti i OJF "The Door" (Qender ditore e hapur) nuk ka filluar akoma ne ambientet e reja, pasi eshte nderprere rikonstrukcionin i pjesese se objektit qe do te vihet ne dispozicion te tyre. Ne qarkun e Shkodres operonin:

- a) Bashkia Shkoder Shoqata „Every Child“ Qender Sociale dhe mbeshtetje te femijes dhe familjet, kishte filluar veprimtarine e saj ne ambjentet e rikonstruktuar, ajo ofronte sherbime keshillimi, sherbime per kujdes shendetesor, edukim argetim dhe punesim per femijet, grate dhe familjet ne nevojte.
- b) Komuna Bushat – Qender Komunitare multidisplinare, e cila ofronte sherbime per femijet dhe grate ne Barbullush, kishte hyre ne ambjentet e rikonstruktuar.

- c) Shoqata „The door“ ofronte shërbimet e saj si: edukim, keshillim ndërmjetësim-informim për punësim, arëgëtim, etj., për femijet, të rinjtë dhe grata.
- d) Qendra „Dimensioni human“ ishte një qendër ditore për të moshuarit, e cila ofronte arëgëtim, shëlodhje.
- e) „Qendra komunitare për integrim dhe zhvillim“ – Puke ofronte keshillim ligjor, shërbim shëndetsor, shëlodhje, arëgëtim, etj., për femijet, të rinjtë, grata dhe të moshuarit. Në këtë bashki, GP konstatoi se për shkak të cilësive së dobët të rikonstruksionit të mjediseve, veprimtaria e projektit ushtrohej në një mjedesi tjetër.

### 3. Plotësimi i objektivave të projektit

Projekti SSD realizoi një nga objektivat e tij për krijimin e modelit të përfshirjes së aktoreve të ndryshëm sociale, që nga autoritetet shtetërore në të gjitha nivelet, deri tek OJF dhe përfituesit e shërbimeve sociale. Këto gjithëpërfshirje të aktoreve të komunitetit e gëjme që në hartimin e Legjislacionit bazë, Strategjive, Standardeve të shërbimeve sociale, i realizuar përmes një procesi të gjërë konsultimesh, deri tek pjesëmarrja e tyre në zbatimin e shërbimeve sociale në nivel vendor.

Projekti i dha nxitje zbatimit të proceseve të decentralizimit në administrimin e shërbimeve sociale, duke përcaktuar funksionet, përgjegjësitë dhe rolet e MÇSSHBB, SHSSII, qarkut, bashkisë/komunes deri tek administratori social, që ka kontaktin e drejtëpërdrejtë me personat në nevojë.

Realizimi i objektivit strategjik për de-institucionalizimin, që synon rritjen e mundësive të zgjedhjes, të shkallës së pavarësisë së përfituesve të shërbimeve sociale dhe të cilësive së jetës së tyre në përgjithësi. Kjo është arritur përmes nxitjes së një larmishmerie shërbimesh sociale, kryesisht qendra ditore edukimi, kujdesi shëndetsor, rehabilitimi të PAK, keshillimi psiko-social, ndërmjetësimi dhe informimi për punësim, si tipe të reja shërbimesh sociale alternative ndaj shërbimeve të ofruara nga sistemi publik.

Dhënie e një modeli të integritimit të përfitimeve nga programet sociale, konkretisht të programit të ndihmës ekonomike dhe atij të shërbimeve sociale.

### 4. MÇSSHBB

Në MÇSSHBB disa rezultate në zhvillimin e kapaciteteve për hartimin e Politikave janë:

- Zhvillimi i konceptit të gjithëpërfshirjes së aktoreve të ndryshëm krahas qeverisjes qendrore: pushtetit vendor, OJF-ve deri tek përfituesit. Realizimi i workshopeve, debateve të gjëra deri tek seminarët trajnuese ku ftohën të marrin pjesë të gjithë aktorët dhe të kenë rastin të parashtrajnë alternativat e tyre për trajtimin e problemeve sociale.
- Zhvillimi i politikave të orientuara nga nevojat sociale, duke ndryshuar tëhunë e orientimit nga poshtë lart. Përcaktimi i treguesve për vlerësimin sistematik të nevojave sociale në nivel vendor është një nder produktet e fundit (VKM Nr. 617, datë 7.09.2006) të projektit, që vlerësohet disi i vonuar edhe për realizimin e studimit të.
- Vendosja për herë të parë e standardeve për shërbimet sociale: standardeve të përgjithshme dhe standardeve specifike për grupe të caktuara si femijet, PAK, të moshuarit.

Ne kushtet e mbeshtetjes se nevojave sociale nga shume burime, krahas buxhetit te shtetit, me vend vleresohet ideja per krijimin e fondit social. Kjo ide nuk ka avancuar me tej, nderkohe qe edhe projekti i SSD nuk ka ofruar asistence ne kete drejtim. Edhe ofruesit e sherbimeve te intervistuar, kur jane pyetur sesi e mendojne sigurimin e qendrueshmerise se projekteve te tyre, ne kushtet e nderprerjes se financimeve nga donatoret e huaj, e kane te veshtire te gjejne nje pergjigje te sakte. Sidoqofte tashme eshte krijuar infrastruktura e nevojshem ligjore per kete fond dhe ne fillim te vitit 2008 parashikohet venia ne zbatim e tij.

### 5. Rezultatet ne aspektet Organizative

- Percaktimi i hierarkise se kompetencave midis MPCSShB dhe SHSSH, institucion ne nivel qendror ne varesi te saj, pergjegjes kryesisht per inspektimin dhe trajnimin e ofruesve te sherbimeve sociale.
- Vendosja e strukturave per monitorimin e varferise dhe te strategjive per grupet vulnerabel, ndonese ka ende nevojte per te saktuar funksionimin e tyre: qe nga shkembimet e informacionit, deri tek puna ne grupe midis seksionit te monitorimit te varferise dhe seksionit te sherbimeve sociale.
- Zhvillimi i nje strategjie per informimin publik, ndonese ka mbeture ne leter. Edhe zhvillimi i nje strategjie per trajnimet, pothuajse ka mbetur ne leter. Kjo per shkak te ristrukturimeve te vonuara ne organizimin e SHSSH. Shume pak eshte bere per perfshirjen e Fakultetit te Shkencave Sociale ne trajnimet e organizuara, ndonese kjo parashihet ne strategjine e trajnimeve. Ndikimi i projektit ne realizimin e bashkepunimeve midis MÇSSHB, (veçanerisht institucionëve nen autoritetin e saj si SHSSH, ISSH) dhe Fakultetit te Shkencave Sociale mund te ishte me i ndjeshem.
- Ngritja e strukturave per licensimin e ofruesve te sherbimeve, si parakusht per zhvillimin e nje sistemi te qendrueshem sherbimesh sociale. Percaktimi i dokumentacionit te nevojshem per kete qellim. Ndonese sektori i sherbimeve sociale deklaroi se ky proces ka nje fillim te mbare, vete projekti nuk dha nje shembull te mire per zbatimin e ketij komponenti, duke mbeshtetur OJF ende te palicensuara, madje qe sapo kane hyre ne zhvillimin e veprimtarive ne fushen e sherbimeve sociale. Veshtire te percaktohen qe ne kete faze ndikimet negative, por çertifkimi i ofruesve te sherbimeve nuk mund te anashkalohet dhe duhet te riparohet ne nje kohe sa me te shpejte.
- Zhvillimi i burimeve njerezore gjate procesit te zbatimit te programeve sociale. Trajnimet ne lidhje me njohuritë per nje sistem modern sherbimesh sociale, mbi tipologjine e sherbimeve, aspektet e vleresimit te nevojave, licensimin e ofruesve te sherbimeve sociale, monitorimin, inspektimin e ofruesve te sherbimeve sociale, deri tek metodat e vleresimit te impakteve te tyre ne drejtim te rritjes se efektivitetit dhe te eficiences se sherbimeve sociale.
- Me vendosjen e objektivave strategjike dhe pergatitjen e planeve te veprimit sipas sektoreve nga MÇSSHB eshte rritur niveli i menaxhimit te sherbimeve sociale, por ky menaxhim ka ende nevojte per koordinim si brenda ministrise ashtu edhe ne stukturat e tjera. Krijimi i grupeve te punes multidisiplinare per hartimin e programeve sociale me pjese marrjen edhe te aktoreve jashte MÇSSHB eshte pjese e veprimtarise se perdritshme te Ministrise duke reflektuar menaxhim me cilesor.

## 6. SHSSH

- U qartuesuan funksionet e tij si nje institucion per inspektimin e sherbimeve sociale, ne kushtet qe administrimi i sherbimeve po i delegohet autoriteteve vendore. Por kjo kerkon rritjen e metejshme te kapaciteteve per njohjen dhe zbatimin e metodologjive bashkekohore te inspektimit.
- Krahas drejtorise se Inspektimit, ne SHSSH eshte ngritur edhe njesia e trajnimit, me idene qe inspektimi te mos konsiderohet thjesht si kontroll, sikurse eshte realizuar deri tani, por si kontroll dhe mbeshtetje njekohesisht ne rritjen e kapaciteteve njerezore. Kjo kerkon investime ne kualifikimin e burimeve njerezore ( Inspektoreve ) per t'iu pershtatur sa me mire rolit qe duhet te kene ne kushtet aktuale. Sektori i marredhenieve publike nuk eshte mbeshtetur mjaftueshem per te sensibilizuar opinionin publik, permes fushatave ne media mbi nevojen e investimit ne trajtimin e probleme sociale te kohes.
- Persa u takon njesive rajonale te SHSSH, megjithe investimet e projektit, rezultatet jane jo dhe aq te mira. (Kjo edhe per faktin se) Ristrukturimi i tyre ka bere qe nje pjese e investimeve te meparshme vecanerisht ne kapitalin njerezor te jene larguar, prandaj ndihet nevoja e rritjes se kapaciteteve rajonale, per t'iu pershtatur pergjegjesive te Qarkut si nivel rajonal i qeverisjes vendore . Kooperimi i tyre me Qarkun dhe gjithe njesite e tjera te qeverisjes vendore apo me ofruesit e sherbimeve sociale ne nivel qarku, duhet te jete me i mire ne menyre te tille qe te gjithe aktoret e perfshire te jene te ndergjegjshem per rolin dhe pergjegjesite qe derivojne nga to.

## 7. Pushteti vendor/Ofruesit

- Arritja kryesore e Projektit SSD eshte vendosja e nje modeli te ri ne sistemin e sherbimeve sociale. (ka si arritjen kryesore vendosjen e nje modeli te ri ne sistemin e sherbimeve sociale ne vendin tone). Me ane te tij synohet qe sherbimet sociale nga funksion i deleguar te kthehet ne funksion te drejteperdrejte te njesiseve te pushtetit vendore duke rritur njekohesisht nevojen per kontributin e OJF-ve por edhe te komunitetit ne mbarevajtjen e sherbimeve sociale. Nga vrojtimi yne rezulton se ky model eshte ne krijim e siper dhe vleresohet se do te behet i mundur deri ne perfundim te kesaj faze te projektit SSD.
- Ky model do te nxise konkurrencen mes ofruesve publike e private, per te siguruar mbeshtetjen e tyre nga pushteti vendor duke rritur cilesine e sherbimeve te ofruara. Gjithashtu kjo do te beje te mundur qe ofruesit te mos sigurojne sherbimet qe ata i menaxhojne me lehte pavaresisht nga nevojat komunitare, por sipas nevojave te porositesit i cili ben vleresime te vazhdueshme te nevojave sociale te komunitetit.
- Krijimi i marredhenieve te reciprocitetit, ndonese ne fillimet e veta synon mbeshtetjen e ndersjellte midis pushtetit vendor dhe ofruesve te sherbimeve sociale lehteson permbushjen e funksioneve sociale nga te dy keta aktore te rendesishem. Nese deri dje, OJF as nuk e njihnin pushtetin vendor, sepse ato vepronin jashte orbites se tij, tani jane ato vete qe kerkojne partnershipin me aktoret ne nivel vendor, per te siguruar qendrueshmerine e sherbimeve sociale.

- Marredheniet e partneritetit kerkojne qe autoritetet vendore te sigurojne financimet per ofruesit e sherbimeve me te mira ndaj grupeve ne nevoje. Keto marredhenie te reja do te shtojne shkembimin e informacionit midis paleve, qe sapo ka filluar te duket ne horizont. Megjithate, ka ende nevoje te qartesohen marredheniet midis paleve nepermjet akteve nenligjore.
- GP/QShKE vlereson se nje perfshirje me e gjere e komunitetit do te vije gradualisht. Para se gjithashketu eshte fjala per perfshirjen e shkolles ne veprimtarite e qendres se sherbimeve sociale. Kjo nuk lidhet vetem me rastet kur qendrat kryejne sherbime per femijet, por edhe per grupet e tjera ne nevoje. Pak shembuj ka per nxitjen e veprimtarive te perbashketa mes qendres dhe shkolles (edukatoreve dhe nxenesve te shkolles), me perjashtim te rasteve kur ne fillimet e tyre, per mungesa ambientesh, qendrat i zhvillonin veprimtarite ne ambientet e shkollave (Vaqarr, Krrabe) apo kur nepermjet njoftimeve te thjesht, fletpalosjeve, qendrat perpiqen te shperndajne informacionin per programet e tyre duke perdorur nxenesit e shkollave. (Rasti i Every Child ne Shkoder qe per te terhequr target grupet e saj shperndan informacionin ne shkolla, qe nepermjet nxenesve te marrin informacion edhe familjaret e tyre).
- Ofrimi i sherbimit te kujdesit shendetesor si pjese e sherbimeve sociale perben nje trend pozitiv. Kjo eshte evidente ne Fushe Kruje, Krrabe, Kamez, Shkoder e Vlore ku mjeket e zones perfishihen me kohe te pjesshme apo te plote ne qendren e sherbimit social qe vepron ne keto zona.
- Informimi dhe sensibilizimi i komunitetit si nga ana OJF-ve ashtu dhe e autoriteteve vendore eshte ende ne nivele te pamjeftueshme. Pak promocion u behet atyre, vecanerisht nga NjKP ne shkalle vendi. Edhe institucionet e pushtetit vendor nuk kane permbushur rolin e tyre per promovimin e modeleve te perparuara te sherbimeve sociale ne zonen ku ato ushtrojne autoritetin e tyre, me perjashtim te Bashkise Vlore. Ndonese nevojat ne kete fushe njihen, ne me te shumten e rasteve OJF nuk mund te ndryshojne destinacionin e sherbimeve qe ofrojne, sepse kjo ka nje kosto te paperballueshme per to.
- Roli i administratoreve sociale te njesive te qeverisjes vendore, ndonese eshte rritur, varion nga njera njesi tek tjetra. I ndjeshem eshte ky bashkepunim, midis njesive vendore dhe qendrave te sherbimeve sociale ne Krrabe, Vaqarr, Fushe-Kruje. Orikuem e Puke ndersa ne njesi te tjera, megjithe insistimin e OJF-ve, ky bashkepunim eshte me pak i prekshem. Keshilli komunal Bushat gjate vitit 2006 kishte marre dy here ne analize ecurine e qendres sociale qe ushtronte veprimtarine e vet ne kete komune. Ndersa ne Shkoder ky interesim ishte vetem ne nivelin e administratoreve te drejtorive te ndihmes ekonomike, vecanerisht ne monitorimin e veprimtarise se qendrave te sherbimeve sociale.

## 8. Raportimi dhe monitorimi

- OJF-te raportojne prane Njesise se Koordinimit te Projektit cdo dy muaj. Keto raportime pasqyronin me teper situata pershkruese, sesa vleresime te sherbimeve sociale te ofruara dhe problemeve qe hasnin ato ne praktike, si ne marredheniet me pushtetin vendor, me perfituesit e tyre apo me komunitetin ne teresi. Ndaj lind si nevoje krijimi i nje modeli raportimi duke patur parasysh indikatorret qe u jane kerkuar OJF-ve ne projekt propozimet e tyre.

- Zyrtat rajonale te SHSSH ende nuk kane ushtruar funksionin e tyre te inspektimit te sherbimeve sociale. Besojme se ne zbatimin e VKM nr. 617 date 07.09.2006, ku percaktohen edhe keto detyrime Zyrtat Rajonale do te angazhohen ne menyre sistematike ne monitorimin, kontrollin, raportimin dhe zbatimin e legjislacionit te standarteve te sherbimeve sociale. Per pushtetin vendor ende jemi larg permbushjes se ketyre funksioneve, prandaj ata nuk shfaqin interes as t'i kontrollojne e as t'u kerkojne raportime OJF, ne vijimesi te indiferences per t'i mbeshtetur.
- Krijimi nje database me te dhenat per grupet ne nevoje, mbetet nje domosdoshmeri per monitorimin dhe vleresimin e veprimtarise te ofruesve te sherbimeve. Kjo veshtiresoi punen per vleresimin e efektivitetit te sherbimeve sociale te ofruara nga OJF-te. Ky database, mbas hyrjes ne fuqi te Vendimit te Keshillit te Ministrave, qe pritet te dale ne janar te 2007, do te kerkoje edhe angazhimin e administratoreve sociale ne komuna e bashki te cilet kane informacione me te plota per grupet ne nevoje dhe kerkesat respektive te tyre per sherbime sociale.
- Mbi kete baze plotesimi i database do te kerkonte nje trajnim te plote te administratoreve sociale si nga pikpamja e metodologjise se vleresimit te nevojave sociale, ashtu dhe te reflektimit per permbushjen e tyre, sepse aktualisht ata disponojne nje formular te vetem me disa tregues sasior per pese grupet ne nevoje. Synimi te jete per vleresime individuale te nevojshme per te zhvilluar nje sistem sherbimesh sociale te pershtatshme sipas nevojave te komunitetit.

## 9. Pershtatshmeria e sherbimeve sociale ndaj nevojave vendore

Projekti SSD realizon nje nderhyrje per t'ju pergjigjur vleresimit te nevojave sociale ne favor te grupeve sociale te pershkruara ne raportin VNICA, ku jo vetem grupe te ndryshme qe kishin nje larmi nevojash, por edhe klasifikimet e ngushta brenda nje grupi ne nevoje si grate/ grate e papuna/ e divorcuara, e dhunuara, e trafikuar, kryefamiljare/ apo femijet/jetime/ qe lene shkollen/ lypesit/ e trafikuar/ e dhunuar/, apo te rinjte/perdorues te droges, alkoolit/ e papune/ me rekorde kriminale/ jetime, pra secili nengrup kishte te evidentuara nje shumllojshmeri nevojash sociale. Pasqyra mbi tipologjine e sherbimeve e tregon qarte kete arritje, ku veme re sherbime te reja sociale per grupet ne risk, qe nga keshillimet psiko-sociale, rehabilitimet e PAK, qendrat ditore per te moshuar deri tek keshillimet ligjore per grupet ne nevoje. Sherbimet per grate dhe te rinjte qe kane pas munguar ne tipologjine e meparshme sipas VNICA, tashme jane nder target grupet e trajtuara nga shumica e ofruesve te sherbimeve sociale.

Projekti i SSD-se ka synuar te jape mbeshtetje sipas nevojave te rajoneve perkatese si dhe ne varesi te disponibilitetit te pushtetit vendor, si kontraktues i sherbimeve ne zonen e tij, por jo kudo ka arritur efektivitet maksimal. Ne zonat e Kavajes dhe Paskuqanit, te rajonit te Tiranes, keto projekte jane ende te pakonsumuara per shkak te mosangazhimit te pushtetit vendor te ketyre zonave vecanerisht per sigurimin ne kohe te ambjenteve te nevojshme. Nga ana tjeter mendojme se kerkohet nje rimodelim i sherbimeve te ofruara ne menyre te tille qe te plotesohen e nevojat e komunitetit qe i sherbejne.

## 10. Pjesemarrja e perfituesve ne programet e sherbimeve sociale

Nje arritje e menyres se konceptimit te sherbimeve te mbeshtetura nga projekti SSD eshte se ne qender te tyre ieshte klienti me nevojat e tij. Programet e sherbimeve

hartohen ne bashkepunim me ta, dhe me familjaret. Stimulimi dhe zhvillimi i marredhenieve familjare, sigurisht perben nje nga efektet e dukshme te sherbimeve te ofruara. Kjo ishte evidente ne qendren " te qendrojme se Bashku", Kombinat, Every Child Tirane e Shkoder. Qendrat per te moshuar Vlore e Shkoder. Ne te perfituesit e drejperdrejte dhe familjaret e tyre, jane teper aktive jo vetem ne hartimin e programeve te sherbimeve, por edhe ne zbatimin e tyre. Madje me kerkesat, sugjerimet e tyre, mund te thuhet se ata japin vleresime per elemente te ndryshem te sherbimeve te ofruara. Gjithsesi pak elemente ka qe tregojne per nje vleresim te vazhdueshem dhe sistematik te programeve sociale edhe nga vete ofruesit e tyre, pa folur per vleresime nga jashte, sikurse eshte ky model qe po ofrohet, vleresim mbi bazen e studimit te te gjitha efekteve te sherbimeve nga nje qender e specializuar ne fushen e kerkimeve ekonomike dhe sociale (research).

Ka nje prirje rritjeje te kapaciteteve te ofruesve, te zhvillimit te strukturave te reja, detajimit te roleve sociale, nivelit profesional te tyre, procedurave te inspektimit, percaktimit te treguesve per vleresimin e nevojave sociale ne nivel vendor si dhe te treguesve te efektivitetit dhe eficiences se sherbimeve sociale. Nevojat e paplotesuara i kane cuar ofruesit e sherbimeve ne tendencat e krijimit te rrjeteve te bashkepunimit ne nivel vendor, rajonal e me gjere, per rritjen e efektivitetit te sherbimeve sociale.

Procesi i hartimit, zbatimit dhe vleresimit te sherbimeve sociale ka perfshire te gjitha aktoret sociale, ndonese ndjehet nevoja per nje angazhim me te madh te pushtetit vendor, nga komunat, bashkite e vacanerisht qarkut per zhvillimin e planeve komunitare per sherbime sociale.

## 11. Zhvillimi i kapaciteteve

Zbatimi i strategjive te hartuara dhe permiresimi i modeleve te krijuara sipas te realiteteve sociale kerkon zhvillim te vazhdueshem kapacitetesh. Te hartosh politika bashkekohore nuk eshte e lehte, por qe ti zbatosh ato eshte edhe me e veshtire ne kushtet e vendit tone.

Krijimi i Fondit social perben garancine financiare te zhvillimit te nje sistemi te qendrueshem sherbimesh sociale. Asistenca ne kete drejtim eshte e rendesishme, ne kushtet qe ky eshte nje institucion krejtesisht i ri ne politiken e perkujdesit social, shprehje e partneritetit social.

Ndonese projekti dha nje kontribut te cmuar ne zhvillimin e kapaciteteve ne te gjitha aktoret sociale, ky eshte vetem investimi i pare qe ka nevojte te pasohet nga te tjere. Zhvillimi i kapaciteteve do te realizohet ne pune e siper per zhvillimin e nje sistemi te qendrueshem sherbimesh. Ai lidhet kryesisht me:

- a) Projekti SSD ka sjelle rritjen e aftesive per te realizuar analiza shumeplanesh te probleme sociale te grupeve vulnerable. Ndonese ka arritje ne kete drejtim, zhvillimi i kapaciteteve te tilla mbetet nje nga prioritetet e se ardhmes. Percaktimi i treguesve te matjes dhe vleresimit te nevojave sociale ne nivel vendor, kerkon te shoqerohet me investimin ne profesionistet qe do t'i analizojne keta tregues dhe do te formulojne rekomandimet per hartuesit e politikave publike.
- b) (Percaktimi i funksioneve inspektuese te SHSSH kerkon te zhvillohet nje mendim strategjik ne kete drejtim i te gjitha njesive te SHSSH. Njesite e reja te ristrukturuara brenda SHSSH, kane nevojte te mbeshteten ne kryerjen e pergjegjesive, ne percaktimin e veprimtarive te inspektimit.
- c) Realizimi i parimeve te gjithepershirjes apo te orientimit pro-klient kerkon investime ne kapitalin njerezor. Rritja e numrit te profesionistev te fushes sociale te rekrutuar ne te gjitha strukturat e SHSSH perben nje domosdoshmeri, pasi nevojat sociale po behen gjithnje e me komplekse, qe reflektohet edhe ne sherbimet sociale komplekse.

- Qe te arrish te inspektosh nje sherbim kompleks, duhen jo vetem njohuri te gjithanshme te nevojave te grupeve vulnerable, por edhe te formave te nderhyrjes ndaj tyre me sherbime sociale, qe duhet t'i kene inspektoret, krahas aftesive te tyre per shqyrtimin e treguesve te percaktuar ne standardet e sherbimeve sociale.
- d) Per te zbatuar strategjine e hartuar nga projekti SSD per trajnimet, sektori perkates i krijuar ne SHSSH duhet te hartoje nje plan veprimesh per kete qellim.
  - e) Publikimet jane ende nje pike e dobet e administrates publike. Ndonese projekti dhe nje stimul me publikimet e strategjise, standardeve te sherbimeve sociale, ende ka nevojte per publikime te tjere, me qellim qe ofruesit te njihem me te gjitha kuadrin ligjor ne fushen e sherbimeve sociale.
  - f) Kostot e sherbimeve nuk jepen te qarta ne statistikat e ShSSH, per te ndare kostot administrative nga ato te perfitimit te klientit. Pak informacion jepet mbi kontribuesit e tjere, veç buxhetit te shtetit, per te gjykuar ne ndikimin e tyre.
  - g) Delegimi i pergjegjesive ne nivel rajonal kerkon rritjen e kapaciteteve, jo reduktimin e strukturave dhe burimeve njerczore ne nivel rajonal, njesite e SHSSH.
  - h) Delegimi i funksioneve te menaxhimit te sherbimeve sociale ne nivel vendor, kerkon pergatitjen e manualeve mbi format e kontraktimit te ofruesve te sherbimeve sociale. Sipas fakteve te zbuluara nga vezhgimi rezulton qe ndonese ofruesit jane korrekt me respektimin e marreveshjeve, pushteti vendor duhet te ndergjegjesohet me teper per zbatimin e tyre.

### Kapitulli III.

## REZULTATET E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT TEK PËRFITUESIT

### I. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

Ne zbatim të objektivave të Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin Ekonomik dhe Social (SKZHES), Qeveria shqiptare inicioi projektin e mbështetur nga BB "Shpërndarja e shërbimeve Sociale" në fund të vitit 2001, i cili kishte si synim krijimin i një sistemi cilesor dhe të qëndrueshëm të ofrimit dhe shpërndarjes së shërbimeve sociale për grupet dhe individët në nevojë me synim reduktimin e varfërisë në vend. Në funksion të arritjes së këtij synimi, një ndër objektivat kryesore të projektit të BB ishte pikërisht: "Forcimi i kapaciteteve institucionale për zhvillimin, monitorimin dhe vlerësimin me efektivitet të politikave sociale, si dhe përmirësimi i kapaciteteve për të planifikuar administruar dhe shpërndarë shërbimet e perkujdesjes shoqërore me baze komunitare"<sup>17</sup>. Projekti prezantonte një vizion të ri për decentralizimin dhe deinstitutionalizimin e shërbimeve shoqërore me synim afrimin e tyre sa më pranë komunitetit. Një numër institucioneve të qeverisë qendrore dhe vendore ishin përfitues institucional të projektit të BB "Shpërndarja e Shërbimeve Sociale".

Siç dihet, në fushën e ndihmës dhe perkrahjes shoqërore, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (MPÇSSHB) është autoriteti qendror i ngarkuar me hartimin e politikave, legjisllacionit, programimin e fondeve të ndihmës ekonomike për familjet, personat me aftësi të kufizuar dhe shërbimet shoqërore, miratimin e standardeve të shërbimeve, licensimin e personave juridikë privatë që do të ofrojnë shërbime shoqërore etj.

Ky rol i rëndësishëm e shumëdimensional që i është atribuar kësaj pjese të ekzekutivit shqiptar, derivon nga një sërë dokumentesh të rëndësishëm politik e juridik njëkohësisht, si Strategjia Kombëtare e Zhvillimit Ekonomik dhe Social, Strategjia e Shërbimeve Sociale<sup>18</sup>, Ligji Nr. 9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore" dhe aktet nenligjore të miratuar në zbatim të tij.

Projekti i BB "Shpërndarja e Shërbimeve Sociale", nëpërmjet një sërë objektivash të ndara në komponente të caktuar, në mënyrë specifike në nenkomponentin 2 të tij, parashikon si objektiv të tij mbështetjen e MPÇSSHB për:

- a) Forcimin e kapaciteteve lidhur me formulimin e politikave të shërbimeve të perkujdesjes sociale
- b) Zhvillimin e kuadrit ligjor dhe institucional për shërbimet sociale
- c) Ngritjen e kapaciteteve për monitorimin dhe vlerësimin e politikave dhe përmirësimin e programeve të shërbimeve sociale
- d) Percaktimin dhe zbatimin e një fushate kombëtare ndergjegjesimi lidhur me perjashtimin social
- e) Percaktimin dhe zbatimin e një sistemi të pershtatshëm për financimin e shërbimeve sociale, me pjesëmarrjen e të gjithë aktoreve kryesore përfshirë dhe donatorët

Për përmbushjen e qëllimeve të mesiperme, projekti parashikon një numër rezultatesh (output-esh), ndër të cilat përmendim:

- i) Percaktim i mirepercaktuar i rolit dhe përgjegjesive të organeve të qeverisë qendrore (MPÇSSHB, SHSSH);
- ii) Ngritje e kapaciteteve njerezore dhe organizative për të hartuar politikën e shërbimeve sociale brenda standardeve;
- iii) Përmirësim i kuadrit ligjor dhe institucional për menaxhimin dhe shpërndarjen e shërbimeve sociale;

<sup>17</sup> Shih: Aneks #11 Liste e Akteve Ligjore dhe Nenligjore për Ndihmën dhe Shërbimet Sociale

<sup>18</sup> Po aty

- iv) krijimi i nje sistemi standardesh dhe monitorimi;
- v) nje komunitet me i informuar lidhur me problemet e perjashtimit social te grupeve te caktuara dhe mbi dobishmerine e sherbimeve sociale;
- vi) Krijimi i nje sistemi te qendrueshem per financimin e sherbimeve sociale me lehtesira per te favorizuar me perparesi sherbimet sociale ne baze komunitare ndaj atyre institucionale.

Ne zbatim te VNDP te projektit SSD, GP/QSHKE, analizoi shkallen e plotesimit te objektivave te mesiperme. Disa nga perfundimet apo gjetjet kryesore te kesaj analize jepen ne vijim.

## 2. Ngritja e kapaciteteve njerezore dhe organizative per hartimin e politikave te sherbimeve sociale<sup>19</sup>

Ne MPCSSHB funksionon Drejtoria e Politikave te Sherbimeve Sociale (DPSHS) e perbere nga nje nje staf prej 5 vetesh, misioni i se ciles eshte hartimi i politikave, legjislacionit, standarteve te sherbimeve sociale dhe monitorimi i zbatimit te tyre. E drejtuar nga nje menaxher me aftesi teknike, organizative dhe drejtuese dhe nje staf me eksperience ne kete fushe, ne bashkepunim me strukturat e tjera te Ministrise por dhe me aktoret e tjere, kjo drejtori ka realizuar nje vellim pune te konsiderueshem ne hartimin e politikave dhe te legjislacionit si dhe ka siguruar marredhenie bashkepunimi dhe partneriteti me institucionet e qeverisjes vendore, perfaqesuesit e shoqerise civile, OJF –te qe ushtrojne veprimtarine e tyre ne fushen sociale, etj.

I gjithë procesi i hartimit të politikave dhe ai legjislativ në MPCSSHB është asistuar nga Ekipi i Keshillit Britanik, mbështetja e të cilit ka qenë “mjafë e dobishme për të gjitha strategjitë, aktet ligjore dhe nënligjore të përgatitura deri më tani. Staf i MPCSSHB ka bashkëpunuar ngushtë me ekipin e British Council (BC) i cili ka ofruar modele të reja dhe koncepte të reja. BC ka mbështetur ngritjen e kapaciteteve në MPCSSHB qoftë me asistencë teknike ashtu dhe me një sërë trajnimesh brenda dhe jashtë vendit si dhe vizita studimore në Britaninë e Madhe”.

Në procesin e grumbullimit të informacionit dhe gjatë kryerjes së intervistimeve, staf i Drejtorisë së Politikave Sociale i konfirmoi grupit të eksperteve të QSHKE se me mbështetjen e projektit SSD janë realizuar një sërë vizitash studimore, të cilat kanë synuar njohjen nga aferë të përvojave të vendeve të tjera, të modeleve të ndryshme të ofrimit dhe të sigurimit të sherbimeve sociale, të praktikave dhe dokumentacionit perkatese të monitorimit të tyre, etj. Megjithatë GP/QSHKE vlereson se ngritja e nivelit të kapaciteteve në strukturat e MPCSSHB mbetet një detyrë konstante, sidomos duke marrë në konsideratë edhe ndikimin e ndryshimeve të shpeshta në drejtimin e institucionit në njësitet perberese të tij.

## 3. Permiresimi i kuadrit ligjor dhe institucional per menaxhimin dhe shperndarjen e sherbimeve sociale

Mbështetja e permiresimeve të kuadrit ligjor për ndihmen dhe sherbimet sociale perben një komponent të rëndësishëm të projektit SSD. Në priudhën 2005–2006 është shënuar edhe finalizimi i permiresimeve në kuadrin ligjor për ndihmen dhe sherbimet sociale. Hapi më i rëndësishëm në këtë drejtim ka qenë hartimi dhe miratimi Ligjit Nr. 9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” dhe i Strategjisë së Sherbimeve Sociale, miratuar me VKM Nr.265, date 28.4.2005. Ky ligj i zgjeron kufijtë e

<sup>19</sup> Shih: Aneks #1, Lista e Personave të Intervistuar, Op. Cit.,

përfitimt për të gjithë grupet ne nevojë, krijon hapësirat e nevojshme për decentralizimin dhe rritjen e kompetencave të qeverisjes vendore si dhe për pjesëmarrjen e shoqërisë civile në ofrimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror. Me kokretisht, në kuadrin e këtyre dokumenteve behet e mundur:

- a) Identifikimi sasior e cilesor te familjeve dhe grupeve sociale ne nevoje;
  - b) Percaktimi e llojeve te sherbimeve dhe kritereve te perfitimit;
  - c) Vendosja e standarteve per nivelin, cilesine e sherbimit dhe transparencen;
  - d) Decentralizimi i sherbimeve, kompetencave dhe fondeve ne Bashki e Komuna;
  - e) Fuqizimi i rolit te Qarkut;
  - f) Zgjerimi i pjesemarrjes se shoqerise civile ne ofrimin e sherbimeve dhe fuqizimin e kapaciteteve institucionale
- a) Gjithashtu, jane miratuar pothuajse te gjitha aktet nenligjore (VKM<sup>20</sup>), te cilat ishin parashikuar ne dispozita te vecanta te ligjit, per te mundesuar implementimin e tij, pervec VKM per ngritjen e Fondit Social, e cila eshte parashikuar per tu draftuar ne fund te vitit 2007.

Per pjesen me te madhe te VKM jane hartuar dhe miratuar edhe udhezimet perkatese te MPÇSSHB ose udhezimet e perbashketa me ministrite e linjes.

Megjithate, nga studimi rezulton se ne disa raste ka vonesa deri edhe mbi 1 vit ne nxjerrjen e akteve nenligjore (udhezimeve te MPÇSSHB, etj.) per te bere te mundur zbatimin e VKM. (psh Udhezimi i perbashket midis dy ministrave, perkatesisht Ministrit te MPÇSSHB dhe Ministrit te Brendshem (MB) ne zbatim te VKM Nr.563, date 12 .8 2005 "Per percaktimin e pergjegjesive te qarkut per shperndarjen e sherbimeve te perkujdesjes shoqerore" ende eshte ne fazen e draftimit edhe pse ka mbi nje vit qe ky VKM detyron pergatitjen e tij.)

Gjithashtu nga intervistat me drejtuesit e pushtetit vendor dhe me perfaqesues te shoqerise civile rezulton se pjesemarrja e tyre ne procesin e hartimit te kuadrit ligjor ka qene modeste, gje qe reflektohet edhe ne veshtiresite e zbatimit te tij.

**Ligji Nr. 9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore"** dhe aktet nenligjore ne zbatim te tij pervec roleve e kompetencave te aktoreve kryesore institucionale, parashikon dhe permiresime institucionale nepermjet ngritjes se strukturave monitoruese, inspektuese te sherbimeve sociale por edhe trajnuesc, informuese etj. Megjithate te gjitha keto struktura kane fare pak kohe qe jane ngritur, me miratimin e struktures se re te SHSSH, edhe pse ligji parashikon te ngritjen e tyre qe ne vitin 2005.

Keshtu eshte krijuar Inspektorati i Ndihmës Ekonomike, Pagesës për Personat me Aftësi të Kufizuar dhe Shërbimeve Shoqërore (INEPPAKSS). Inspektorati eshte ngritur ne nivelin e dy Drejtorive prane SHSSH: Drejtoria e Inspektimit te Pagesave ne Cash (13 punonjes gjithsej ne dy sektore) dhe Drejtoria e Inspektimit te Sherbimeve Sociale (15 punonjes gjithsej ne 3 sektore). Prane SHSSH eshte ngritur Sektori i Trajnimit, Kordinimit te Projekteve dhe Marredhenieve me Publikun (i perbere nga 3 punonjes). Ne zbatim te objektive te Strategjise se Sherbimeve Sociale roli i ketij serktori eshte te identifikojc, programoje, kordinoje dhe menaxhoje procesin e trainimit, ritrainimit dhe kualifikimit profesional te stafeve te strukturave zbatuese te sherbimeve sociale te kordinoje projektet/programet me donatoret strategjike si dhe te informoje publikun nepermjet fushatave ndergjegjesuese mbi politikat, legjislacionin, standartet dhe nevojat e grupeve vulnerabel te shoqerise.

Mbeshtetur ne Strategjite nensektoriale, prane MPÇSSHB dhe SHSSH jane ngritur nje sere strukturash per monitorimin e progresit te objektive te percaktuara ne keto strategji. Keshtu jane krijuar Sektori i Monitorimit te Strategjise per Femijet (SMSF)

<sup>20</sup> Per me shume hollësi, Shih: Aneks #11 Lista e Akteve Ligjore dhe Nenligjore per Ndihmën dhe Sherbimet Sociale, Op. cit.

prane Drejtorise se Sherbimeve Sociale (DSHS) ne Ministri, Sektori i Monitorimit te Strategjise se Komunitetit Rom (SMSKR), prane Drejtorise se Trajnimit, Kordinimit te Projekteve dhe Marredhenieve me Publikun ne SHSSH.

**VKM Nr.563, date 12.08. 2005 "Per percaktimin e pergjegjesive te qarkut per shperndarjen e sherbimeve te perkujdesjes shoqerore"** nxjerre ne zbatim te nenit 30 te Ligjit rriti rolin dhe kompetencat e Qarkut ne vleresimin, planifikimin, koordinimin dhe shperndarjen e sherbimeve Sociale. Sipas ketij VKM prane çdo keshilli qarku ngrihet dhe funksionon Komiteti i Vleresimit te Nevojave dhe Planifikimit te Sherbimeve te Reja ne Komunitet (KVNPSRK), me perfaqesues, ne nivel kryetari, drejtori a pergjegjes sektori, te bashkive/komunave te qarkut, te zyres rajonale te SHSSH, te OJF-ve, qe ofrojne sherbime te kesaj natyre, te organizatave te perfituesve, qe veprojne prane keshillave te qarqeve, perfaqesues nga drejtorite e arsimit, te shendetesise dhe te rendit. Ky komitet percakton dhe vlereson nevojat per sherbime sociale, ofruesit e mundshem te tyre si dhe ben nje vleresim te projekteve per ofrimin e sherbimeve te reja me baze komunitare te propozuara nga institucione, donatore te ndryshem, OJF-te dhe sipermarrije private. Komitetet e Planifikimit kanë një përvojë modeste ne veprimtarine e tyre. Ato janë ngritur ne 4 rajonet pilot te projektit SSD: Tirane, Durres, Shkoder, Vlore dhe ne 2007 e me pas do te ngrihen edhe ne qarqet e tjera

Gjithashtu, ky VKM ligjeroi dhe institucionalizoi krijimin e strukturave te ndihmes dhe perkujdesjes shoqerore prane çdo keshilli qarku, te cilat do te bashkerendojne punen ndermjet njesive te qeverisjes vendore si dhe do te mbeshtesin dhe nxitin bashkepunimin ndermjet organeve drejtuese te njesive te qeverisjes vendore dhe OJF-ve te ndryshme qe zhvillojne veprimtarine ne nivel rajonal.

Edhe pse jane miratuar nje sere permiresimesh te tjera institucionale, shumica e tyre ende nuk kane filluar te funksionojne, mbetet per t'u pershendetur ky hap i pare ne krijimin e tyre dhe me pas te shihet performanca e tyre gjate ushtrimit dhe permpushjes se detyrave funksionale.

#### 4. Sistemi i standardeve dhe monitorimi i sherbimeve sociale

Nga studimi rezulton se pergjithesisht ky komponent ka patur nje ecuri te kenaqshme zhvillimi dhe zbatimi. Keshtu, MPCSSHB, ne zbatim te Ligjit "Per ndihmen dhe sherbimet sociale", dhe me mbeshtetjen e projektit SSD ka zhvilluar dhe dhe institucionalizuar nje sistem bashkohor te standarteve te sherbimeve sociale. Per kete qellim, ne periudhen 2005-2006 jane miratuar nga Qeveria Standartet e Pergjithshme te Sherbimeve Sociale (SPShS), si dhe standartet per kategorite e vecanta si femijet, te moshuarit, personat me aftesi te kufizuar (PAK). Kjo arritje dhe procedura e ndjekur per kete qellim konfirmohet edhe nga intervistimi i drejtuesve te MPCSSHB se "*Standartet janë hartuar nepermjet nje procesi bashkepunimi me aktorë të ndryshëm: me përfaqësues nga ofruesit dhe përfituesit e shërbimeve shoqërore, përfaqësues të autoriteteve vendore dhe qendrore, përfaqësues nga Shërbimi Social Shtetëror në nivel qendror apo rajonal, si dhe profesionistë të tillë, si punonjës socialë, edukatorë, studiues, akademikë por gjithashtu edhe përfitues të shërbimeve*"<sup>21</sup>.

Dobia e bashkepunimit ndermjet paleve te interesuara ne procesin e hartimit dhe zbatimit te kuadrit rregullator u evidentua qarte edhe permes intervistave te realizuara me perfaqesues te qeverisjes vendore, (bashkite dhe komunat e zonave pilot) sherbimit social ne nivel qendror dhe rajonal, etj. Me ta ishin kryer nje sere diskutimesh për vlerësimin e kapaciteteve ekzistuese të shërbimeve shoqërore në plotësimin e nevojave në rritje të

<sup>21</sup> Shih: Nga intervista me Prof. N. Dumani, Drejtor i Drejtorise se Politikave Sociale ne MPCSSHB, BIA e Projektit SSD, ET/QSHKE, Tirane 2006

grupeve të ndryshme në nevojë, me plotësimin e nevojave shoqërore në komunitetin, ku ata ushtrojnë autoritetin e tyre

Ky proces i mbështetur në një pjesëmarrje të gjere dhe gjithëpërfshires shënon një hap të rëndësishëm në konsultimin, pjesëmarrjen dhe aksesin e të gjithë aktoreve të interesuar në vendimarrje, duke qenë pjesë e parë dhe me të rëndësishme e krijimit të këtij sistemi të synuar. Një model i ri gjithëpërfshirjeje krijohet, i mbështetur në parimet bashkëpunimit, pjesëmarrjes, transparencës, roli dhe mbështetja e Projektit SSD në këtë drejtim vlerësohet si shumë e rëndësishme.

Ndërkaq, duhet theksuar se krijimi i bazës ligjore është njëra anë, dhe po kështu në mos me rëndësishme mbetet ana tjetër dmth implementimi i tyre. GP/QSHKE vlerëson se ky proces duhet të përbejë edhe një nga përparësitë e fazës së dytë të zbatimit të projektit SSD, gjë që është e mundur nëpërmjet disa elementeve baze.

Se pari, njohjes së tyre nga të gjithë aktoret. Për këtë MPÇSSHBB duhet të përgatise udhëzues praktikë, komentare për të qartësuar kuptimin e tyre, të përcaktojë procedurat e nevojshme për lehtësimin e punës për zbatimin e standardeve etj. Deri tani janë realizuar 8 workshope dhe do të vazhdojë realizimi i pjesës tjetër. Por që të fillojë zbatimi i këtyre standardeve duhet që ky kuader rregullash udhëzuese të marrë formën e tij plotë dhe të shpërndahet në të gjitha nivelet. Paralel me krijimin e bazës shpjeguese, GP/QSHKE vlerëson se duhet të vazhdojë të zhvillohen fushata sensibiluese, seminare trajnues, punë në grupe të vogla profesionistësh, deri të trainimet për një kuptim dhe zbatim sa më të mirë të tyre. Nga intervistimet e kryera me palë të interesuara në nivel qendror e vendor si dhe me OJF ofruesë të shërbimeve të projektit SSD rezulton se deri me tani ky proces ka ecur mirë dhe se trainimet e kryera kanë qenë mjaft të dobishme për pjesëmarrësit.

Se dyti, krijimi i një sistemi monitorimi dhe inspektimi për zbatimin e tyre. Në legjislacionin në fuqi përcaktohet qartë përgjegjësi e MPÇSSHBB për kontrollin monitorimin e zbatimit të standardeve. Ky institucion ka ndërtuar një sistem të tillë monitorues, duke përgatitur kuadrin ligjor të nevojshëm dhe ngritjen e strukturave institucionale, edhe pse venia në funksionim të sistemit është pak e vonuar. Edhe Komisioni i licensimit i krijuar pranë MPÇSSHBB në zbatim të VKM nr.564, datë 16.08.2005 shërben si një instrument monitorues për zbatimin e standardeve të shërbimeve sociale.

MPÇSSHBB ka krijuar një sistem vlerësimi dhe monitorimi të programeve të ndihmës ekonomike, të pagesës për personat me aftësi të kufizuara dhe të shërbimeve shoqërore, duke përcaktuar treguesit e tyre me vkm nr. 617, datë 7.9.2006, si dhe udhëzimin që po përgatitet për zbatimin e saj<sup>22</sup>, në këtë mënyrë, nëpërmjet këtij sistemi të vlerësimit dhe të monitorimit, mpçsshb grumbullon dhe përpunon të dhëna statistikore, si dhe harton raporte në fushën e ndihmës e të shërbimeve shoqërore.

Në planin institucional, INEPPAKSS, (i cili ka filluar veprimtarinë e vet kohët e fundit) ka si një ndër objektivat e rëndësishme të veprimtarisë së vet edhe mbikqyrjen dhe kontrollin e zbatimit të standardeve të shërbimeve sociale. Me këtë proces ka qenë përqendruar kryesisht në inspektimin për çështjet administrative të shërbimeve shoqërore. Përkundrazi për të orientuar kontrollin, krahas standardeve janë përcaktuar dhe treguesit e cilësive, për të lehtësuar veprimtarinë e Inspektoriatit. BC ka ofruar një sërë modelesh dhe përvajsh inspektimi, duke përfshirë edhe „trainimin e trainereve“ (inspektoreve të ShSSH) dhe përgatitjen e një manuali të inspektimit në funksion të lehtësimi të punës të Inspektoreve.

<sup>22</sup> Ky dhe disa akte të tjera në lidhje me monitorimin e dhe vlerësimin e shërbimeve sociale janë nxjerre nga qeveria dhe MPÇSSHBB në periudhën gjatë së cilës kryhej BIA i SSD.

## 5. Informimi i komunitetit

(Nje nga objektivat e projektit SSD ka qene zbatimi i nje fushate ndergjegjesimi te opinionit publik lidhur me dobishmerine e sherbimeve sociale dhe problemet e perjashtimit social te grupeve te caktuara, e cila deri me sot nuk ka arritur te zbatohet ne menyre te plote.

Nga informacioni i grumbulluar rezulton se jane kryer nje sere seminaresh lidhur me konturimin e fushates se informimit publik, mbi teknikat e hartimit, planifikimit e zbatimit te kesaj fushate, me pjesemarrjen e te gjithe aktoreve te interesuar. Ky komponent mbetet i nje rendesie te vecante edhe per te ardhmen, gjc qe konfirmohet edhe nga intervistimi i drejtuesve kryesore te MPCSSHIB te perfshire ne zbatimin e projektit se *"Me mbeshitetjen e Projektit SSD, ne muajt qe vijne do te ndermeret nje proces i rendesishem, qe lidhet me publikimin e te gjithe kuadrit ligjor dhe strategjive, ne nje dokument permbledhes duke u shperndare me qellim njohjen nga te gjithe aktoret e involvuar ne sherbimet social"*<sup>23</sup>.

Gjithashtu prane Sherbimit Social Shteteror eshte krijuar Sektori i Informimit te Publikut (SIB) i cili do te mundesoje informimin dhe programimin e fushatave ndergjegjesuese si dhe kordinimin e strategjive te ketij procesi me te gjithe aktoret e perfshire ne ofrimin dhe sigurimin e sherbimeve sociale. Ky sektor eshte miratuar me strukturen e re te SHSSH (Nentor 2006), ndonese duhej te ishte krijuar me pare.

GP/QSHKE vlereson se fushatat ndergjegjesuese te perfituesve duhet te jene me te organizuara, jo sporadike dhe te marrin me shume ne konsiderate nivelin dhe problematiken e vete grupeve shoqerore te interesuara. Pergjithesisht ky konkluzion ka rezultuar edhe nga intervistat e kryera ne terren me drejtues e zyrtare vendore, ashtu edhe me ofruesit e sherbimeve sociale.

## 6. Krijimi i nje sistemi te qendrushem per financimin e sherbimeve sociale

Zbatimi i projektit SSD, ka krijuar modelin financimit per te rritur qendrushmerine e sherbimeve sociale ne komunitet, si hap i pare drejt krijimit te nje sistemi te qendrushem. Keshtu ne zbatim te projektit SSD, te gjitha njesite e pushtetit vendor qe i perkisnin rajoneve pilot ku po implementohej projekti, perkatesisht Tirane, Durres, Shkoder dhe Vlore ishin bere partner ne zhvillimin e nenprojekteve, duke qene pale ne kontratat e lidhura midis tyre, ofruesve te sherbimeve dhe njesise se projektit. Pjesa me e madhe e tyre kane ofruar fillimisht godinat prona te Bashkive/Komunave ne dobi te zhvillimit te projektit, dhe me pas edhe financimin e sherbimeve si uje, energji, sherbim roje etj.

Keto jane hapat e pare drejt krijimit te nje sistemi financimi nga njesite e pushtetit vendor per te zhvilluar sherbimet sociale me baze komunitare, pasi me perfundimin e projektit SSD, njesite e pushtetit vendor do te vazhdojne te sigurojne programet dhe sherbimet sociale te ideuara nga projekti, me kapacitetet e tyre, apo nepermjet blerjes se sherbimeve nga OJF-te dhe ofruesit e tjere te sherbimeve sociale.

Per krijimin e nje sistemi te qendrushem per financimin e sherbimeve sociale, ne Ligjin nr.9355, datë 10.3.2005 *"Per ndihmen dhe Sherbimet Shoqerore"* eshte parashikuar krijimi i Fondit Social, i cili do të ndihmojë ne mbeshitetjen e shërbimeve te reja dhe zhvillimin e politikave shoqerore. Ky fond krijohet me fondet e buxhetit qendror, donacione të ndryshme, me qellim qe të realizohen politika për shtrirjen e shërbimeve të reja shoqerore dhe kryesisht me qellim mbeshitetjen e njësive te qeverisjes vendore që kanë të ardhura të pakta. Fondi Social do te krijohet ne fund te vitit 2007

<sup>23</sup> Shih: Nga intervista me Prof. N. Dumani, Drejtor i Drejtorise se Politikave Sociale ne MPCSSHIB, BIA e Projektit SSD, GP/QSHKE, Tirane 2006, Op. Cit..

Gjithashtu ligji nr.9355, datë 10.3.2005 "Per ndihmen dhe Shërbimet Shoqërore ne nenin 18 parashikon rastet kur qarku/bashkia/komuna nuk mund të kene mundesi dhe kapacitete njerëzore për të ngritur te gjitha llojet e shërbimeve që kërkon komuniteti, ato mund t'i blejnë këto shërbime nga OJF apo ofrues privatë, në përputhje me ligjin "Për prokurimin e fondeve publike". Qarqet/bashkitë/komunat mund të kooperojnë edhe me njëra-tjerën për të ndërtuar shërbime shoqërore të përbashkëta.

Duke qene ne fillimet veta zhvillimi i shërbimeve të reja shoqërore në njësitë e qeverisjes vendore me të ardhura te pakta, do të kete nevojë për mbështetje nga buxheti qendror. Kalimi i institucioneve të shërbimeve shoqërore rezidenciale në varësi të qeverisjes vendore, i cili deri me tani eshte realizuar si kalim objektesh, do të shoqërohet edhe me transferimin e fondeve të nevojshme, që në fillim të vitit për çdo institucion. Njësitë e qeverisjes vendore do të marrin të gjitha përgjegjësitë për financimin e shërbimeve te reja shoqërore që do të ngrihen nga projekti.

Burimet e financimit për shërbimet e përkujdesit shoqëror do të përbëhen nga fondet e kushtëzuara të buxhetit të shtetit; nga të ardhurat vendore, nga fondet e projekteve të përbashkëta të qeverisë dhe donatorëve, kontributet e përfituesve, dhurimet, sponsorizimet dhe financime të tjera nga organizata, persona fizike/ juridikë etj. Ndersa fondet nga buxheti i shtetit do te delegohen si grande të kushtëzuara në njësitë e qeverisjes vendore që në fillim të vitit. Kjo do të ndihmojë në planifikimin e shërbimeve komunitare që do të bëjë çdo bashki/komunë.

Këto jane disa mekanizma të financimit të shërbimit qe do te nxisin vazhdimesine dhe qëndrueshmërinë e shërbimeve shoqërore ekzistuese.

## 7. Njesia e Monitorimit te Varferise

Njesia e Monitorimit te Varferise (NMV) e krijuar ne kuadrin e monitorimit te zbatimit te Strategjise Kombetare te Zhvillimit Ekonomik dhe Social (SKZHES), aktualisht mban emertimin: Sektori i Monitorimit. Analizes dhe Programimit (SMAP) prane MPÇSSHB, ne funksionet e te cilit midis te tjerash, perfshihen:

- Percaktimi i indikatoreve mates te reduktimit te varferise sipas objektivave te percaktuara ne SKZHES;
- Kryerja e analizave sasore dhe cilesore dhe berja e monitorimit te prirjeve te standartit te jeteses dhe te varferise ne Shqipëri;
- Ndjekja e Ndikimit te politikave sociale per reduktimin e varferise si dhe hartimi i rekomandimeve per politikat sociale;

Projekti SSD, ne nenkomponentin 1 te tij ka percaktuar si objektiv mbeshtetjen per funksionimin me efikasitet te Njesise se Monitorimit te Varferise, prane MPÇSSHB e cila do te mundesoje mbledhjen, shkembimin, analizen dhe vleresimin e te dhenave statistikore per monitorimin dhe vleresimin e programeve sociale.

Aktualisht ky sektor bashkepunon apo shkemben informacion ne kuadrin e veprimtarise se tij me strukturat e MPÇSSHB, INSTAT dhe ne disa raste me OJF--te qe kryejne studime ne kete fushe te veprimtarise.)

Veprimtaria kryesore e deritanishme e kesaj strukture ka konsistuar ne shkembimin e te dhenave, hartimin e raporteve dhe matricave te ndryshme. Ne vitin 2005, me mbeshtetjen e DFID, SMAP ka realizuar studimin me titull "Analize e Ndikimit te politikës" lidhur me shperndarjen e bllok-granteve te ndihmes ekonomike ne bashkite dhe komunat e vendit. Ky studim u realizua duke u bazuar ne te dhenat e Rregjistrimit te Popullsisë dhe Anketes se Matjes se Nivelit te Jeteses nga INSTAT dhe ka evidentuar nje sere konkluzionesh per implikimin e politikës si dhe propozime per permiresimin e politikave ekzistuese.

Aktualisht, SMAP eshte duke konturuar rolin e tij si analizues dhe vleresues i zbatimit te politikave qe hartohen nga MPÇSSHB dhe programet sociale te lancuara, gje qe pritet

te ndihmoje ne zbatimin e fazes se dyte te projektit SSD. Nga studimi i informacioneve te grumbulluara nga GP/QSHKE, rezulton se mbetet ende shume pune per te bere lidhur me zhvillimin e analizave statistikore, monitorimin e standarteve te jeteses dhe reduktimit te varferise. Staf i kufizuar (3 vete gjithsej) dhe mungesa e kapaciteteve te mjaftueshme ben qe kryerja e studimeve periodike nga ky sektor per vleresimin e politikave te jete e veshtire. Pervec kesaj SMAP i eshte nenshtuar edhe ndryshimeve strukturore. Me qellim qe ky sektore te permbushi funksionet dhe te rritet efektiviteti i punes se tij ka nevoje per rritjen e kapaciteteve.

## 8. Instituti i Statistikes (INSTAT)

Një nga objektivat më të rëndësishem të INSTAT ne drejtim të treguesve sociale dhe statistikave sociale është të ofrojë instrumente në mbështetje të politikave, duke perdorur per kete qellim gjithnjë e më shumë sisteme të integruar të informacionit. Këto instrumente bëjnë të mundur marrjen e një pamjeje tërësisht të njohur mbi çështje thelbësore, duke integruar informacion nga burime të ndryshme dhe të mbledhur me metoda të ndryshme. Ne funksion të këtij qellimi, projekti SSD ne fazen pilot të zbatimit të tij, ka patur si objektiv të krijojë një sistem të qendrueshem të monitorimit të treguesve sociale, duke dhene keto rezultate kryesore:

- Krijimin e nje sistemi permanent dhe periodik monitorimi te familjeve nga INSTAT, dhe
- Realizimin e matjes se nivelit te jeteses LSMS duke filluar nga viti 2002.

Me mbeshtetjen e projektit SSD qofte financiarisht por edhe me asistence teknike eshte realizuar Matja e Nivelit te Jeteses (LSMS), e cila ka filluar ne vitin 2002 nepermjet nje vrojtimi me kampion 3.600 familje ne nivel kombetar, ka vazhduar ne periudhen 2003-2004 me gjysmen e ketij kampioni, dhe me pas ne vitin 2005 me 3840 familje. Ky vrojtim, bëri të mundur mbledhjen e nje informacioni të gjerë mbi gjendjen e familjeve shqiptare, situatën e tyre demografike, ecurine gjatë viteve të tranzicionit dhe shkaqet perkatese, kushtet dhe cilesia e jeteses, përbërjen e buxhetit te tyre, etj. Informacioni i mbledhur bën të mundur realizimin e një sintheze të kushteve ekonomike dhe sociale të familjeve ne kuader te monitorimit te treguesve kyç që shprehin rritjen ekonomike dhe reduktimin e varfërisë. Rezultatet e kesaj ankete kane sherbyer si baze per adresimin e politikave dhe strategjive ne fusha te ndryshme. Ne vitin e ardhshem, perseri me mbeshtetjen e projektit SSD do te zhvillohet vrojtimi per matjen e buxhetit te familjes.

Nga informacioni i grumbulluar dhe intervistat e kryera, rezulton se ende nuk eshte arritur te krijohet nje sistem i qendrueshem i monitorimit te familjeve ne nevoje prane INSTAT, kjo e kondicionuar nga shume faktore, midis te cileve edhe niveli i pamjaftueshem i mbeshtetjes financiare "*Eshte e rëndësishme qe te pakten ne çdo 3 vjet te realizohet nje ankete e tille e matjes se nivelit te jeteses nga INSTAT, ne menyre qe te monitorohet ecuria e indikatorëve te reduktimit te varferise, por per kete mungojne mjetet financiare*" - shprehen drejtues te INSTAT<sup>24</sup>.

Gjithashtu, vlen te theksohet se projekti SSD ka dhene nje ndikim te rëndësishem ne ngritjen e kapaciteteve njerezore, ne trajnimin e punonjesve te sektorit te nivelit te jeteses prane INSTAT, duke u ofruar atyre nje sere modelesh dhe konceptesh bashkohore ne kete fushë. "*Stafi yne ka punuar ngushtesisht me ekspertet nderkombetare te siguruar nga projekti, duke u asistuar teknikisht nga keta te fundit dhe duke perfituar shume prej tyre*"<sup>25</sup>.

<sup>24</sup> Shih: Nga intervista me znj. L. Thomo, Pergjegjese e Sektorit te Nivelit te Jeteses ne INSTAT, BIA e Projektit SSD, ET/QSHKE, Tirane 2006.

<sup>25</sup> Po aty

Me ndryshimin e kabinetit qeveritar nje vit e gjysem me pare, ne INSTAT jane ndryshuar edhe Keshilli Drejtues (Bordi) dhe Drejtori i Pergjithshem, pervec disa pozicioneve kyc ne strukturen organizative te ketij institucioni.

### 9. Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSh)

Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSh) është institucion që realizon të drejtën e shtetasve për mbrojtje shoqërore në Republikën e Shqipërisë. ISSH, si institucion publik, shtetëror i pavarur, për drejtimin dhe administrimin e sistemit të sigurimeve shoqërore, i përket sistemit të institucioneve që realizojnë komponentë të veçantë të politikave sociale.

Projekti i BB SSD, ka patur si objektiv te forcoje kapacitetet e ISSH per hartimin dhe zbatimin e politikave lidhur me pensionet, nepermjet mbeshtetjes me asistence teknike. Theksojme qe ky komponent i projektit te BB nuk ka filluar te realizohet, pasi drejtuesit e institucionit kane ndryshuar qellimin dhe destinacionin e tij. Nga intervistat me drejtuesit e ketij institucioni rezulton se ata kane kerkuar ndryshimin e qellimit dhe destinacionit te projektit.

### 10. Sherbimi Social Shteteror

Objektivi i projektit SSD, ne zbatim te komponentit 2 te tij, ka qene: “Te siguroje nje administrim dhe monitorim efektiv te sherbimeve te perkujdesjes shoqerore, ne nivel kombetar dhe vendor duke forcuar kapacitetet vleresuese dhe monitoruese te SHSSH (ne nivel qendror dhe rajonal)”. Edhe pse ka ende vend per permiresime, duhet thene qe kuadri ligjor i krijuar, ka ndihmuar ne percaktimin e rolit te aktoreve kryesore, midis te cileve dhe SHSSH, i cili luan edhe nje rol ndermjete qe mban lidhjet midis pushtetit qendror dhe qeverisjes vendore.

Me mbeshtetjen e projektit SSD, ne SHSSH, ne zbatim te urdhrat te Kryeministrit nr. 252 date 01.11.2006 “ Mbi strukturen e re te Sherbimit Social Shteteror”, eshte pershtatur plotesisht struktura dhe detyrat funksionale me qellim permiresimin e kapaciteteve dhe rritjen e nivelit te ekspertizes qe ofron.

Nga intervistat me stafin e SHSSH u evidentua qe nje sere trainimesh te mbeshtetura nga Projekti SSD kane qene mjaft te dobishme. Kjo sidomos trainimet per inspektorët e ndihmës ekonomike, pagesës për personat me aftësi të kufizuar dhe shërbimeve shoqërore, por edhe me trainuesit te cilet do te trainojne me pas punonjes ne nivele te tjera, duke perfshire edhe stafet e ofruesve publike dhe private te sherbimeve sociale.

Sidoqofte, GP/QSHKE vleresojne se permiresimi i kapaciteteve humane te SHSSH mbetet nje nevojë e dorës së parë edhe për fazën tjetër të projektit SSD, për të qenë në gjendje të marrë përsiper funksione dhe të ushtruar përgjegjësi në procesin e shpërndarjes së shërbimeve sociale. Ndryshimi i shpeshtë i drejtuesve të ketij institucioni, që në rastet me të shumta vijne për shkaqe jo-institucionale, si dhe ndryshimi i shpeshtë i strukturave përberëse të SHSSH, krijon pasiguri në punën e stafit por edhe efikasitet të pamjftueshëm në veprimtarinë e tyre dhe të institucionit në teresi.

### 11.Strukturat rajonale te SHSSH

Projekti i SSD ka kontibuar ne ristrukturimin edhe te Zyrave Rajonale te Sherbimit Social Shteteror duke mbeshtetur permiresimin e kuadrit ligjor mbi bazen e te cilit ato funksinojne.

Konkretisht, mbështetur në Statutin e SHSSH miratuar me VKM nr.542, datë 27.07.2005 si dhe urdhrin e Kryeministrit nr. 252 datë 01.11.2006, strukturat rajonale të SHSSH organizohen në 12 Zyrrat Rajonale të ngritura në nivel qarku, me dy sektore baze :

- a. Sektori i Inspektimit të pagesave në cash (ndihma ekonomike dhe pagesa për personat me aftësi të kufizuara).
  - b. Sektori i Inspektimit të Standarteve të shërbimeve sociale.
- Keto struktura kanë keto funksione kryesore:
- a) Operojnë si institucione ndërmjetës, bashkëpunues dhe mbështetës për të realizuar koordinimin ndërmjet qeverisjes qendrore dhe vendore;
  - b) Koordinojnë veprimtarinë e sektorëve të ndryshëm që lidhen me shërbimet shoqërore në nivelin rajonal;
  - c) Realizojnë koordinimin dhe planifikimin e nevojave në nivel rajonal;
  - d) Grumbullojnë informacionet dhe të dhënat në nivel rajonal për monitorimin dhe vlerësimin e Ndikimit të politikave;
  - e) Kontrollon zbatimin e legjislacionit për NE, PAK dhe standardet e shërbimeve)

Për forcimin e kapaciteteve të punonjësve të drejtorive rajonale janë kryer në mënyrë të herëpashershme trainime të përgjithshme dhe specifike për programet e ndryshme të mbrojtjes shoqërore. Megjithatë mbetet sfida përmirësimi i metejshëm i kapaciteteve në keto struktura, pasi janë evidente ndërrimet e shpeshta të drejtuesve të Drejtorive rajonale të SHSSH, si dhe të stafit të tyre. Psh. Në Drejtorinë Rajonale të Tiranës, numri i punonjësve është reduktuar nga 20 në 12 vete, duke shkurtuar edhe profesionistët me eksperiencë në pozicionin e punës; që kanë marrë pjesë në procesin e hartimit të kuadrit ligjor, etj. Po kështu, plotësimi i infrastruktuars materiale të zyrave dhe kompletimi i pajisjeve të tyre është një tjetër çështje problematike që kërkon zgjidhje të shpejta.

## 12. Njesite e Qeverisjes Vendore<sup>26</sup>

Ligji nr.9355, datë 10.3.2005 “*Per ndihmen dhe Shërbimet Shoqërore*” përcakton rolin e ri të njesive të Qeverisjes vendore të cilat marrin përgjegjësi për menaxhimin, financimin dhe sigurimin e qëndrueshmërisë së shërbimeve sociale të kërkuara nga qytetarët në juridiksionin e territorit të tyre. Ky ligj parashikon që njesite e qeverisjes vendore në nivel bashkie/komune kanë keto kompetenca:

- a) Identifikojnë familjet dhe individët në nevojë për Ndihmë Ekonomike (NE), PAK shërbime shoqërore dhe hartojnë kërkesën për fonde;
- b) Formulohen dhe shpërndajin pagesat e NE dhe PAK;
- c) Formulohen dhe dergojnë statistikën në strukturat qendrore;
- d) Vlerësojnë nevojat e komunitetit dhe ngrejnë lloje të reja shërbimesh sociale në përputhje me nevojat e tij;
- e) Administrojnë institucionet rezidenciale të shërbimeve, dhe ndjekin cilësinë e shërbimeve në qendrat ditore dhe në komunitet;
- f) Perzgjedhin sipas rregullave të prokurimit publik, OJF, ofruesit private të licensuar për ofrimin e shërbimeve sociale.

Për këto arsye, një nga objektivat e rëndësishëm të projektit SSD ka qenë: “*Ngritja dhe përmirësimi i kapaciteteve të qeverisjes vendore në monitorimin, vlerësimin, publikimin si dhe rritjen e rolit të tyre në administrimin e shpërndarjes së shërbimeve sociale si dhe zbatimin e projekteve të shërbimeve sociale me baze komunitare*”. Për vlerësimin e këtij komponenti, GP/QSHKE realizoi intervista në

<sup>26</sup> Shih: Aneks #1, Lista e Personave të Intervistuar, Op. Cit.,

thellesi ne 13 njesi te qeverisjes vendore te perfshira ne 4 rajonet pilot ku po zbatohet projekti SSD. Kryesisht jane intervistuar drejtuesit e institucioneve te qeverisjes vendore si dhe stafi i njesive te ndihmes dhe te perkrahjes sociale prane ketyre institucioneve<sup>27</sup>.

Nga inervistimi rezultoi se kishte edhe nga ato njesi te qeverisjes vendore qe per shkak te mosmarreshjeve ne lidhje me termat e kontrates, kishin refuzuar mbeshtetjen e projektit si Bashkia e Kavajes dhe Komuna e Paskuqanit (Qarku Tiranes).

### 13. Decentralizimi i sherbimeve sociale dhe ndikimi i projektit

Nga pergjigjet e e drejtuesve dhe stafit te pushtetit vendor te intervistuar ne lidhje me mbeshtetjen e projektit per decentralizimin e sherbimeve sociale dhe afrimit te tyre sa me prane komunitetit vihet re nje vullnet dhe angazhim i tyre qe ky proces te ndodhe sa me shpejt. Keto pergjigje ishin teper pozitive, dhe konstatohet se ndikimi i dobishem i zbatimit te projektit ne kete drejtim kishte filluar te ndihej edhe pse procesi vleresohet se po ecen ngadale.

Modelet e reja te financimit, te prokurimit e te kontraktimit ku njesite e pushtetit vendor ishin pale; modelet e vleresimit, bashkepunimit, mbeshtetjes (ofrimi i godinave nga pothuajse te gjitha njesite e pushtetit vendor); modelet e financimit (pervec Bashkise Shkoder, te gjitha njesite e qeverisjes vendore te intervistuar mbulonin/do te mbulonin shpenzimet operative te Qendrave qe ishin ne rikonstruksion apo e kishin perfunduar ate), ishin shtyllat kryesore te zhvillimit te metejshem te procesit te decentralizimit te sherbimeve sociale. Per shembull, stafi i Qarkut te Tiranes vleresonte kete impakt te projektit SSD ne vijim te zhvillimit te kesaj sfide, me synimin final plotesimin e nevojave dhe zbutjen e varferise se komunitetit, por gjithmone duke i dhene qeverisjes vendore kompetencat e nevojshme. Nga intervistat ne kete qark, rezulton edhe shqetesimi lidhur me ndikimin qe do te kishte ne te ardhmen ne komunitet, zbatimi i nenprojekteve te reja ne kuader te projektit SSD, qe nga momenti qe keto nenprojekte nuk miratoheshin me, nga Komiteti Rajonal i Aprovimit te Nenprojekteve mbi shperndarjen e sherbimeve sociale, i cili ishte me prane komunitetit dhe nevojave te tij, duke adresuar nevojat me imediate dhe ne varesi te tyre te percaktonte programet e duhura.

Megjithate roli i Qarkut ne percaktimin dhe ne vleresimin e nevojave te komunitetit per sherbime sociale dhe sigurimit te tyre nepermjet projekteve eshte forcuar dhe institucionalizuar me ngritjen prane Qarkut te Komitetit te Vleresimit te Nevojave dhe Planifikimit te Sherbimeve te reja, i cili kryesohet nga Kryetari i Keshillit te Qarkut. (krijuar me VKM nr.563, date 12.08.2005 "Per percaktimin e pergjegjesive te Qarkut per shperndarjen e sherbimeve te perkujdesjes shoqerore").

Nga intervistat me stafin e sherbimeve sociale te Bashkise se Tiranes, u theksua fakti qe procesi i transferimit te qendrave te sherbimeve sociale nga pushteti qendror tek pushteti vendor po ecen teper ngadale. Transferimi i qendrave te sherbimeve rezidenciale nga qeverisja qendrore ne varesi te njesive te qeverisjes vendore eshte bere "de-jure" per nje pjese te tyre, por per kalimin "de-facto" te tyre kerkohet edhe transferimi i fondeve, sherbimeve dhe kompetencave<sup>28</sup>.

### 14. Permirsimi i kapaciteteve institucionale dhe njerezore te qeverisjes vendore

Duke analizuar pergjigjet e institucioneve te qeverisjes vendore lidhur me ndikimin qe kishte dhene projekti SSD me permiresimin e kapaciteteve institucionale

<sup>27</sup> Shih: Lista e Drejtuesve dhe Nepunesve te Intervistuar te Njesive Vendore, BIA e SSDP, QSHKE 2006.

<sup>28</sup> Shih: Dosja e Intervistimit ne Terren/Dosja e Bashkise Tirane, BIA e SSDP, QSHKE 2006.

mund te themi qe ky ndikim ishte i ndjeshem qofte nepermjet asistences dhe konsulences ne hartimin e kuadrit ligjor i cili sanksionoi ngritjen e tyre por edhe mbeshtetjes dhe modeleve per venien ne funksionim te tyre. Megjithate, procesi i funksionimit te strukturave te nevojshme dhe plotesimit te tyre me kapacitetet e duhura njerezore po ecen me ngadale nga c' ishte parashikuar ishin te favorshme, por jo ne masen e duhur. Edhe pse nje nga komponentet e ketij projektit, i konkretizuar ne Strategjine e Sherbimeve Sociale (SShS) ne mbeshtetje te objektivave te rendesishem te decentralizimit dhe deinstitutionalizimit te sherbimeve sociale eshte te asistojte dhe ngarkoje institucionet e qeverisjes vendore (qarqet, bashkitë ose komunat) ne krijimin dhe plotesimin e strukturave për administrimin e skemës së ndihmës ekonomike, pagesës për aftësinë e kufizuar dhe të shërbimeve shoqërore, sipas nevojave, brenda vitit 2006, ende Qarku i Tiranës nuk e kishte ngritur nje strukture te tille dhe aq me pak plotesimin e saj me kapacitetet e duhura humane.

GP/QSHKE konstatoi se prane Qarkut te Tiranës funksionon Drejtoria e Projekteve Sociale, Arsimit dhe Agrobiznesit, duke angazhuar vetem nje person (6 muaj ne kete detyre), i cili ndjek nga afer ecurine e projekteve ne fushen sociale. Keshtu, vihet re qe megjithese ka mbi nje vit qe nje sere dokumentesh te rendesishem ligjore sanksionojne ngritjen e strukturave te sherbimeve sociale ne nivel qarku, duke rekrutuar kapacitetet e nevojshme humane. ato kane mbetur te pazbatuara. Funksionet e Sektorit te sherbimeve sociale prane Qarkut jane te mirepercaktuara ne VKM nr.563, date 12.08.2005 "*Per percaktimin e pergjegjesive te Qarkut per shperndarjen e sherbimeve te perkujdesjes shoqerore*", dhe lidhen kryesisht me krijimin e nje sistem vleresimi e monitorimi te nivelit te varferise ne nivel qarku, krijimin e database per grupet ne nevojte, familjet e varfera dhe individet qe kane nevojte per sherbime shoqerore, llojin e sherbimeve shoqerore qe ofrohen nga personat juridike publike dhe private si dhe OJF qe veprojne ne nivel qarku, duke bere vleresimin e nevojave dhe me pas ne varesi te tyre ngritjen e sherbimeve te reja ne perputhje me mundesite dhe burimet.

Ndonese projekti SSD ka ofruar nje sere trajnimesh lidhur me zbatimin e legjislacionit dhe shperndarjen e sherbimeve sociale ne komunitet ne te cilet ka marre pjese edhe stafi i qarkut, ende nuk eshte ngritur nje strukture e specializuar ne funksionet e saj, gje qe rrezikon te ule efektivitetin e veprimtarise se Qarkut ne trajtimin e problemeve sociale. Gjithashtu stafi i Qarkut evidentoi faktin qe do te ishte me efektive sikur ky institucion te ishte perfshire ne pjesmarrjen ne vizitat studimore per njohjen e pervojeve te huaja te organizuara me mbeshtetjen e projektit SSD, duke argumentuar se predominimi i stafeve te niveleve qendrore, kishte krijuar nje vakum ne partneritetin me qeverisjen vendore.

Ne perfundim te intervistave me drejtuesit dhe stafet sociale te pushtetit vendor, mund te konkludojme se Bashkia e Tiranës paraqet nje model te mire ne krijimin e strukturave perkatese te sherbimeve sociale. Prane saj funksion Sektorit i Sherbimeve Sociale i perbere nga nje staf prej 6 punonjesish me edukimin perkates dhe pervoje te mjaftueshme ne kete fushe. Secili prej tyre punon me kategorite e vecanta, vleresimin e tyre, programet per ta, si per grate, te moshuarit, ndihmen ekonomike, kujdestarine, romet. Por keto struktura nuk jane kristalizuar ende ne Bashkite e Qarqeve te tjera pilot, te cilet kryesisht kane drejtor/tektor te ndihmes ekonomike, dhe nje person i cili merret me sherbimet sociale, kryesisht kapacitete te reja te cilet shpesh vijne edhe nga auditoret apo dhe nga radhet e shoqerise civile, dhe qe kane nevojte per trajnim te vazhdueshem.

Ndoshta edhe per shkak te vend-ndodhjes ne kryeqytet, pothuajse i gjithë stafi i Bashkise se Tiranës kishte marre pjese ne nje sere trainimesh te nevojshme mbeshtetur organizuar nga MPÇSSHB dhe SHSSH me mbeshtetjen e projektit SSD, megjithese sipas vleresimit te tyre nje pjese e trainimeve perseriteshin duke bere qe ne ndonje rast, i njeiti nepunes t'i nenshtrohej me shume se nje here te njejtit trajnim. Nga intervistat me ta u theksua fakti qe duhet synuar nje pershtatje e tematikes dhe nivelit te ketyre

trainimeve me aftesite e personave pjesemarres si dhe duke vene theksin me teper ne cilesine sesa sasine e tyre.

Per sa i perket komunave te zonave pilot te projektit SSD, aty kishte vetem nje punonjes i cili kryesisht merrej me ndarjen e ndihmes ekonomike, duke i kushtuar fare pak rendesi vleresimit te nevojave per sherbime sociale dhe planifikimit te programeve per plotesimin e tyre. Shumica e ketyre punonjesve (rreth 95% e tyre) ishte me arsim te larte kryesisht edukimin ekonomi-plan, perjashto administratorin e ndihmes ekonomike ne Komunen Kerrabe i cili ishte me arsim te mesem. Nga pikpamja e infrastruktures se zyrave dhe pajisjes se tyre ne pjesen me te madhe te njesive te pushtetit vendor, keto ishin te pershtatshme per ushtrimin e aktivitetit, kuptohet qe ka vend per permiresime (me perjashtim te Komunes Kerrabe, e cila kishte dispononte vetem nje kompjuter i cili ndodhej ne zyren e drejtuesit te kesaj Komune). Nevoja per pajisje kompjuterike u evidentua edhe ne Bashkine e Kamzes dhe ne Komunen e Paskuqanit.

Ne perfundim te analizese se kapaciteteve njerezore te bashkive/komunave, mund te konkludohet se mbetet ende shume per te bere lidhur me trainimin e stafit te tyre, si ne Qarkun e Tiranese ashtu edhe ne qarqet e tjera. Ne pjesen me te madhe te komunave, nga intervistat u evidentua fakti qe administratoret e ndihmes ekonomike kishin kohe (me teper se nje vit) qe nuk ishin perfshire ne trainime. Shume prej tyre nuk njihnin strategjine dhe aktet e rendesishme ligjore lidhur me shperndarjen e sherbimeve sociale, standardet e ketyre sherbimeve per kategorite e caktuara.

Eshte pozitiv fakti qe kapaciteti i qendrave te sherbimeve sociale eshte disa hapa perpara njesive te qeverisjes vendore, por prapambetja e ketyre te fundit, veçanerisht ne drejtim te zhvillimit te pergjegjesive te tyre, ne te ardhmen mund te behet pengese serioze per vijueshmerine e veprimtarise se qendrave sociale.

## 15. Vleresimi i nevojave per sherbime sociale

Shpesh nga intervistat me drejtuesit e bashkise/Komunes u perballem me filozofine se bashkia/komuna interesoheshin me teper per problemet e furnizimit me uje, energji elektrike dhe permiresimi i infrastruktures rrugore. Pra, vihet re se drejtuesit e ketyre njesive i kushtonin vemendje realizimeve dhe investimeve te dukshme ne favor te popullsisë, ne menyre qe te siguronin mbeshtetjen elektorale, duke i perceptuar dhe kategorizuar sherbimet sociale si jo teper te rendesishme. Drejtuesit dhe stafi i nje pjese te bashkive/komunave si Bashkia Fushe Kruje, Bashkia Kamez, Komuna Vaqarre, ende nuk ishin ndergjegjesuar per rolin e ri qe po merrnin si njesi te qeverisjes vendore ne procesin e decentralizimit te sherbimeve sociale, i cili perfshin vleresimin e nevojave te komunitetit te tyre dhe administrimin e shperndarjes se sherbimeve sociale ne komunitet<sup>29</sup>. Per rrjedhoje, mbetet ende shume per te bere lidhur me krijimin e nje sistemi te vleresimit te nevojave per sherbime sociale ne komunitet nga njesite e qeverisjes vendore. Nga intervistat me stafin e ketyre njesive rezultoi qe ky vleresim ishte ende mjaft larg atij modeli qe synohet.

Ne Bashkine e Tiranese, sistemi i vleresimit konsistonte ne nje proces te vleresimit te drejtperdrejte te nevojave per sherbime sociale per komunitetin, i kryer nga njesite bashkiake perkatese te zones bashkiake, te cilat marrin informacione nga kryepleqte, por shpesh keto te dhena jane te pasakta. Pervec kesaj stafi i Bashkise deklaroi se pergatiste pyetsore te ndryshem duke dale ne terren, duke kontaktuar kategori te caktuara dhe ne baze te tyre evidenton relativisht nevojat. Pas grumbullimit te te dhenave te ketyre pyetesoreve hartoheshin studime per kategori te caktuara, duke evidentuar nevojat e kesaj

<sup>29</sup> Shih: Aneks #4/6, Niveli i Bashkepunimit ne Vleresimin e Nevojave te Komunitetit, BIA e SSDP, ACER 2006

kategorie te caktuar. Duhet theksuar qe edhe keto studime ishin mjaft modeste, gjithsesi gjate vitit 2006 ishte hartuar nje studim per moshen e trete dhe ne baze te rezultateve te nxjerra nga ky studim per te plotesuar nevojat e evidentuara per kete kategori, ne bashkepunim me Kryqin e Kuq Shqiptar (KKSh) u ngrit nje qender ditore per moshen e trete ne ambientet e KKSh. Ne baze te vleresimeve te nevojave, Bashkia Tirane hartonte planet perkatese duke bashkepunuar gjithashtu me OJF te ndryshme lokale dhe organizata nderkombetare.

Ne Bashkine Shkoder vleresimi i nevojave behej ne baze te bashkepunimit me institucionet e tjera, duke proceduar me ngritjen e grupeve te punes te cilat ne baze te te dhenave te mbledhura nga institucionet benin vleresimin e nevojave per secilen grup personash ne nevoje, si femijet, te rinjte, grate, personat me aftesi te kufizuar, romet, te moshuarit etj. Ne baze te ketyre nevojave Bashkia ne bashkepunim me te gjitha aktoret e tjera, ku nje rol teper te rendesishem luajne OJF-te, hartonte planet e veta ne funksion te plotesimit te nevojave te komunitetit per sherbime sociale.

Ndersa ne komuna si njesi me te vogla vendore praktikisht eshte me e lehte vleresimi i drejteperdrejte i nevojave per sherbime sociale qe mund te behet nga punonjesit social i administrates komunare. Prej tyre behej nje perditesim i te dhenave per secilen kategori ne risk dhe bashke me te dhenat per numrin e personave qe perfitojne ndihme ekonomike te plote dhe te pjesshme evidentoheshin ne formularet perkatese qe dergoheshin prane drejtorise rajonale te SHSSH. Megjithate, nga intervistat me stafin e Drejtorise Rajonale te Tiranes rezultoi qe keto te dhena statistikore qe plotesoheshin cdo 3 muaj (shpesh me shkrim dore) nga njesite e pushtetit vendor lidhur me grupet dhe kategorite ne risk shpesh plotesoheshin aty per aty duke mos qene nje baze te dhenash te sakta per vleresimin e situates.

## 16. Partneriteti midis pushtetit Vendor, OJF-ve dhe komunitetit

Nga intervistat qe u realizuan ne njesite e pushtetit vendor, rezultoi se kryesisht ishte vendosur nje marredhenie partneriteti ndermjet institucioneve te qeverisjes vendore dhe OJF-ve, dhe kjo fale modelit dhe vizionit te ri qe projekti i SSD kishte prezantuar ne fazen pilot te zbatimit te tij. Duke qene pale ne kontratat e nenshkruara midis tyre, OJF-ve dhe NJKP, pjesa me e madhe njesive te qeverisjes vendore kishin ofruar godinat prone te tyre si dhe marrjen persiper te mbulimit te shpenzimeve operative.

Me miratimin e VKM nr.564, date 12. 8. 2005 "Per licencimin e ofruesve te sherbimeve te perkujdesjes shoqerore", eshte institucionalizuar me tej partneriteti midis organeve te qeverisjes vendore dhe OJF- qe operojne ne fushen e sherbimeve sociale. Nje nga kriteret per licensimin e OJF-ve nga MPÇSSHB eshte pikerisht dhenia me shkrim e vleresimit nga njesia e qeverisjes vendore perkatese lidhur me veprimtarine e OJF, kapacitetet e saj dhe ndikimin e sherbimeve te ofrura prej saj ne komunitet.

Gjithashtu edhe ne proceset e ndryshme vendimarrrese ne Qark (Komiteti i Vleresimit te Nevojave dhe Planifikimit te Sherbimeve i ngritur prane Keshillit te Qarkut ka si anetare te tij edhe perfaqesues te OJF-ve qe ushtrojne aktivitet ne fushen e sherbimeve sociale) dhe ne Keshillat Bashkiake ftoheshin te merrnin pjese edhe perfaqesues nga shoqeria civile dhe OJF-te te cilat shpesh edhe lobonin per marrjen e vendimeve te rendesishme dhe te duhura ne dobi te komunitetit.

Nga intervistimi konstatohet lehte edhe nje opinion mosbesues i stafit te ketyre njesive (kryesisht drejtuesve dhe stafeve sociale te bashkive te vogla dhe komunave) ndaj veprimtarise se OJF-ve, duke i konsideruar keto te fundit, ne parim, me teper si perfituese te fondeve dhe pa ndonje ndikimin thelbesor per shkak te veprimtarise se tyre.

## 17. Roli i OJF-ve ne Sistemin e Sherbimeve Sociale<sup>30</sup>

Duke ju referuar dokumenteve kryesore te pergatitura per Raportin e VNDP te projektit SSD, vihet re perfshirja e OJF-ve ne Strategjinë e Sherbimeve Sociale, Strategjinë Kunder Trafikimit të Qenieve Njerezore (SKTQNj), Strategjine Rome (SR), Strategjine e Personave me Aftesi te Kufizuara, Standardet Kombetare te Sherbimeve Shoqerore, Strategjine për Barazine Gjinore, etj. Keshtu, vetem duke ju referuar OJF-ve ne objektin e vzhgimit te GP/QSHKE, gati gjysma e tyre, respektivisht 4 ne qarkun Tirane, 2 ne ate te Vlores dhe 2 ne qarkun Shkoder, kane qene te perfshira gjeresisht ne kete proces. Kjo perben nje nga arritjet e projektit, duke futur ne Shqiperi modelin e gjithepershirjes se aktoreve, qe ne fazen e hartimit te politikave. Ne kushtet qe OJF-te jane bere nje subjekt i rendesishem ne zbatimin e nje shumellojshmerie sherbimesh sociale, ishte e rendesishme qe pervojat e tyre te reflekttoheshin ne vendosjen e perparësive ne strategjite per sherbimet sociale.

Kjo perfshirje qe ne hapat e para te hartimit te politikave ka rendesi sepse ato sigurojne mandatet per te gjitha programet dhe sherbimet sociale ne nivel komunitar. Nese objektivi i pare i politikës sociale ne vendin tone ishte ngritja e rritjetit te mbrojtjes sociale per te permbushur nevojat emergjente per ushqim dhe mbeshtjetjen me te mira materiale per individet/familjet ne nevoje, tani synohet te sigurohet mbeshtetja me sherbime per te gjithë individet ne nevoje, me qellim integrimin e tyre ne jeten shoqerore. Dhe ketij qellimi i ka sherbyer edhe projekti, me investimet shumeplanesh: *“Synimi madhor i projektit është: të ndihmojë Qeverinë e Shqipërisë të arrijë një sistem kombëtar të qëndrueshëm të shërbimeve të përkujdesit social”*.<sup>31</sup>

Pare nen kete kendveshtrim, çeshtja shtrohet se ne c'mase projekti ka mbeshtetur pikerisht ato OJF qe tentojne te realizojne sherbime sociale per personat/grupet sociale ne nevoje me synim qe ata te aftesohen per t'u integruar ne jeten e komunitetit, per t'u çliruar nga varesia dhe per t'u rritur mundesite e zgjedhjes ne jete.

Nese do ta shtronim çeshtjen nga pikpamja e zhvillimit te nje sistemi te qendrueshem, disa nga elementet qe duhet te zoterojne OJF-te për të siguruar vazhdimesine e sherbimeve qe ofrojne jane: planifikimi me vizion te qarte per te ardhmen; gjithepershirja – partneriteti; pershtatshmeria me nevojat e komunitet; siguria financiare; menaxhim i mirë; staf profesional; mjedise dhe pajisje të përshtatshme, etj.

Nga analiza e këtyre treguesve në veprimtarinë e OJF-ve qe kishte ne objektin e tij projekti SSD dhe informacionit te grumbulluar per kete qellim, rezulton se pergjithesisht projekti SSD ka ndikuar pozitivisht ne shumicen dermuese te ketyre elementeve. Do te veconim OJF -te:

- Every Child Tirane & Shkoder, Dimension Human Shkoder, Qendra e Planifikimit Familjar Vlore, per pershtatjen e programeve te meparshme me programe te reja te mbeshtetura nga projekti SSD.
- Te qendrojme se bashku –Kombinat dhe The door- Shkoder per sherbime te kualifikuara ndaj kategorise se Femijeve ne risk dhe PAK.
- Grate pa perkrahje-Bushat, Media sociale dhe Mbeshtetje psicosociale-Krrabe , Qendra Komunitare per te moshuarit dhe te rinjte ne risk- F.Kruje dhe Qendren e sherbimeve per te moshuarit- Orikum, per bashkepunim te sukseshem me pushtetin vendor.

<sup>30</sup> Shih: Aneks #1/1, Lista e Personave te Intervistuar, Op. Cit.,

<sup>31</sup> Shih: British Council, Raport 2005.

## 18. Planifikimi i veprimtarive per te ardhmen

Formulimi i qartë i qëllimit dhe misionit është një çështje ku disa nga OJF-te hasin vështirësi. Nga vëzhgimi i programeve te OJF-ve shihet se ne disa prej tyre misioni nuk përcaktohet qartë, sepse ka një ndryshim të fushave te veprimtarise – tipike per OJF qe kane hyre ne sferen e sherbimeve sociale si rezultat i mbeshtetjes nga ky projekt. Konkretisht, sikurse del nga Pasqyra Anekse Nr.4<sup>32</sup>, rasti i OJF-se ne Vaqarr, e cila duke pasur nje pervoje pune ne kete zone per nxitjen e biznesit te vogel, ndonese eshte perfshire tashme ne sistemin e sherbimeve sociale, ende synon te drejtohet ne sherbimet e punesimit. OJF te tjera nuk kane arritur ende te identifikojne nje target grup te caktuar, por me shume se nje dmth disa të tillë, sikurse eshte rasti i Krrabes. Edhe qendra e krijuar prej saj ka nisur veprimtarine me mbeshtetjen nga projekti i BB me synim mbeshtetjen kryesisht te grave. Pastaj, sikurse shprehet koordinatorja e qendres, “duke pare veshitresite ne terheqjen e tyre, veprimtaria eshte fokusuar tek femijet, si nje target grup qe do te terhiqte edhe grate<sup>33</sup>”. Kuptohet qe te futesh nje sherbim social ne zonat rurale te Tiranes, si ne Vaqarr dhe ne Krrabe nuk eshte e lehte, sepse keto jane iniciativat e para ne kete fushe, aq me teper te nxjerresh grate shtepiake nga shtepite e tyre per t’i organizuar ne veprimtarite e nje qendre sociale. Me pajisjen e qendres nga projekti SSD me kompjutera, qendra po synonte tani te zhvillonte programe per te rinjte, trajnime per perdorimin e kompjuterave. Nderkohe qe, ne bashkepunim me mjekun e zones, kishte te kartelizuar te moshuarit me probleme shendetesore. Prandaj gjate vizites se GP/QSHKE ne kete qender te sherbimeve sociale, na u krijua me teper pershtypja sikur futeshe ne nje ambient ku do zhvillohej ndonje koncert, se sa ne nje qender komunitare. Pra ate dite te Shtune, aty ne qender te komunes ishte grumbulluar thujase i gjithe komuniteti. Mirepo një shoqatë e re, ne fillimet e veprimtarive te saj ne fushen e sherbimeve sociale, aq me teper kur ka marre persiper sfiden e zhvillimit te modeleve te reja ne nje nga zonat e thella rurale te Tiranes, me gjithë dëshirën e mirë, e ka të vështirë të kryeje aq shumë veprimtari sa ka parashikuar ne programet e saj<sup>34</sup>.

Nga intervista me drejtuesen e qendres “Every Child” qe vepron ne qender te Tiranes dhe bashkepunon me disa nga minibashkite e qendres se kryeqytetit<sup>35</sup>, GP/QShKE konstatoi se ndonese ishte pergjegjesia e pushtetit vendor te bejne vazhdimisht vleresimin e nevojave sociale dhe mbi kete baze te hartojne planet komunitare, ku duhej të terhiqte OJF si ofrues te sherbimeve per t’ju pergjigjur ketyre nevojave, kjo ishte nje detyre e veshtire per ta. Per t’i lehtesuar pushtetit vendor nevojave, kjo ishte nje detyre e veshtire per ta. Per t’i lehtesuar pushtetit vendor permbushjen e ketij funksioni, si dhe per te siguruar mbeshtetjen ne veprimtarise se vet – OJF-ja (“Every Child”) qe kishte nje pervoje te gjate ne fushen e sherbimeve sociale me femijet dhe kishte ndjere nevojën e mbeshtetjes nga autoritetet vendore – qe ne fillim organizoi nje trajnim me perfaqesuesit te mini-bashkive me te cilat do te bashkepunonte, per t’u dhene disa ide se si do te realizohej ky bashkepunim me qellim mbeshtetjen reciproke per te arritur ne synimin final: pambushjen e nevojave sociale te komunitetit. Megjithate, pushteti vendor ende nuk eshte ne gjendje te terheqe ne veprimtarite e tyre qe të gjithë aktoret e komunitetit, qe te bashkerendojne veprimtaritë e tyre per mbeshtetjen e sherbimeve sociale. Pa mbeshtetjen e pushtetit vendor dhe komunitetit, OJF-te nuk mund te kene sukses ne zbatimin e sherbimeve sociale. Aty ku ky bashkepunim ka ecur ne kahun pozitiv, ka edhe nxitje pozitive te OJF-ve.

Megjithate, sikurse eshte rasti i Every Child, deri tani veprimtaria e OJF-ve eshte stimuluar dhe mbështetur nga projektet e organizatave te huaja qe kane vepruar ne vendin

<sup>32</sup> Shih: Pasqyra Aneks #4, “Tipologjia e Sherbimeve dhe A”, BIA e SSDP, QSHKE 2006

<sup>33</sup> Shih: Dosja e Intervistimit ne Terren/Dosja e Komunes Kerrabe, BIA e SSDP, QSHKE 2006, Op. cit.,

<sup>34</sup> Shih: Aneks #6/2, Te Dhena mbi Anketimin Sipas Zonave (Rurale & Urbane), BIA e SSDP, ACER 2006

<sup>35</sup> Shih: Dosja e Intervistimit ne Terren/Dosja e Bashkise Tirane, BIA e SSDP, QSHKE 2006, Op. cit.,

tone. Nje specialiste per OJF-te ne MPÇSSHB, gjate intervistes shprehet se: “Nga eksperiencia e punës këtu, në sektorin e OJF ne MPÇSSHB, arrita në konkluzionin se sikurse OJF-të kanë nevojë për mbështetje nga strukturat publike në realizimin me sukses të misionit të tyre, ashtu kanë nevojë edhe strukturat publike për idetë dhe eksperiencën e OJF-ve, për të hartuar politika e për të ngritur shërbime në përputhje me nevojat e qytetarëve. Vleresimi i veprimtarisë së OJF-ve, nevojave dhe vështirësive me të cilat ato po ndeshen dhe realizimi i nderhyrjeve për bashkepunimin me to, ka rëndësi jo vetëm për fuqizimin e organizatave të shoqërisë civile, zhvillimin e tyre të qëndrueshëm dhe mbështetjes për realizimin e misioneve të tyre, por për dobinë e shoqërisë sonë në përgjithësi”<sup>36</sup>.

Formimi dhe zhvillimi i OJF te mbështetura nga projekti SSD, objekt i këtij vzhgimi është influencuar nga faktore të ndryshëm, ndër të cilët permendim:

- a) Mbeshtetja e donatoreve te huaj, tipike rastet si qendra “Te qendrojme se bashku” ne Kombinat, “Every Child” (Tirane, Shkoder) qe kane nje periudhe te gjate kohe duke zhvilluar veprimtari ne fushen e sherbimeve sociale, kryesisht e para per PAK dhe e dyta respektivisht per femijet – familjet ne nevoje.
- b) Tradita, ku kryesisht organizatat e grave kane qene aktive ne Shqiperi edhe ne te kaluaren. Rasti i OJF qe mbeshtet qendren e sherbimeve per te moshuarit ne Tirane, ajo ne Vlore “Qendra per planifikim dhe zhvillim”, apo ajo ne Kombinat eshte tipik, ku te organizuara me pare si shoqata grash, ato kalojne ne mbeshtetjen e grupeve qe perbejne nje ngarkese shtese per grate ne familje, siç jane femijet e tyre me probleme te aftesive te kufizuara, apo te te moshuarve, ne kushtet qe shteti ofron shume pak ne kete drejtim. Përfaqësimi i këtyre grupeve, mbrojtja e të drejtave të tyre, sensibilizimi i opinionit dhe i niveleve vendimarrëse për problemet që ato përjetonin, është një kontribut i rëndësishëm i tyre.
- c) Kultura e zones, rasti i qendres ne Krrabe – ku ka pasur nje qender kulture teper aktive dhe qe tani, sikurse u permend edhe me siper, qendra sociale synon te terheqe gjithë komunitetin duke i dhene gjalleri jetes se tij.
- d) Ngjarjet historike, p.sh. qendra e Kamzes e kishte nisur veprimtarine ne ate zone menjehere pas ngjarjeve te luftes se Kosoves dhe kishte vazhduar te punonte me te njejtin komunitet, edhe pas largimit te kosovareve.
- e) “Gjuajtja” e projekteve – rasti i Fushe Krujes, ku si rezultat i ofertes nga projekti i BB vihet re qarte ndryshimi i destinacionit te OJF-se, qe ende i mundon stafi profesionist per te realizuar sherbimet e synuara.

Megjithate, shkalla e zhvillimit te tyre varet shume nga disponibiliteti i burimeve dhe mjedisi mbështetes shoqeror. Lëvizja e grave, lulëzoi shpejt ne Shqiperi dhe ishte më e organizuara, qe solli krijimin jo vetem te OJF-ve te tyre, por edhe koalicionet dhe rrjetet, e fuqizuan më shumë aftësinë lobuese të organizatave të grave. Ketu e ka zanafillen edhe nje nga OJF me te suksesshme qe realizon projektin “Te qendrojme se bashku”, ne zonen e Kombinatit. Kjo verteton qe pervoja sjell rezultate te dukshme edhe ne efektivitetin e sherbimeve te ofruara prej tyre. Megjithate, edhe OJF relativisht te reja, te mbështetura fuqishem nga PROJEKTI SSD duken premtuese ne kete drejtim (Krraba).

Gjatë viteve të fundit, OJF-të po kthehen gjithmonë e më tepër drejt projekteve që ofrojnë shërbime sociale për shtresat vulnerable, ndërkohë që ndërgjegjësohen se kanë nevojë për trajnim dhe asistencë teknike në këtë fushë. Kjo jo vetëm për ndryshimin e destinacionit të veprimtarisë së tyre kryesore, por edhe për faktin se ato kuptojnë qe sherbimet sociale te konceptuara fillimisht si te thjeshta, kerkojne nderhyrje

<sup>36</sup> Shih: Nga intervista me znj. A. Selmani, Specialiste e OJF ne OLSA, BIA e Projektit SSD, ET/QSHKE, Tirane 2006.

shumeplaneshë. Prandaj shërbimet e tyre synojnë të jenë multidisiplinare OJF-të janë angazhuar në një shumëllojshmeri veprimtarish<sup>37</sup>.

## 19. Vleresime mbi veprimtarinë e qendrave të shërbimeve sociale

### 19.1 Gjithëpërshirja – në të gjitha fazat e zhvillimit të shërbimeve sociale

Shumica e ofruesve pretendojnë të shndërrohen në qendra multidimensionale. Pavaresisht nëse ky është vizioni i tyre për të ardhmen, GP/QSHKE vlereson se Projekti i BB mund të kishte ndikuar më mirë në krijimin e një profili të caktuar të tyre, në varesi të zones ku veprojnë. Psh nëse në Kombinat mbështetet një OJF që ka ngritur një qendër ditore për fëmijet me nevojë të veçanta, kjo lidhet së pari me modelin e mirë të krijuar prej ofruesit të saj, që ka një përvojë të gjatë në këtë fushë dhe vazhdon në të njëjtin shërbim veprimtarinë e saj.

Sipas intervistave me drejtuesin dhe stafin e saj, shërbimi filloi me fëmijet si target grup, ku u konstatua se në një pjesë të mirë të rasteve, edhe prinderit kishin aftësi të kufizuara më të mirë, që sillte situatë të rënduara sociale (të papunë) dhe ekonomike (të varfër). Në këtë situatë, ideja e shërbimit të titulluar “Të qendrojmë së bashku” në këtë qendër ka synuar që së bashku me trajtimin e fëmijëve të trajtohen edhe nënat e tyre. Prandaj qendra ka ofruar shërbim edhe për nënat e këtyre fëmijëve, madje edhe për të rinjtë në risk. **Pra, ky është një zgjerim i natyrshëm, gradual, një model që duhet të përgjithësohet edhe për qendrat e tjera, në lidhje me zhvillimin e shërbimeve të orientuar nga vleresimi i nevojave të komunitetit.**

Sikurse shprehet drejtuesja e saj, ato kanë arritur të evidentojnë nevojat në bashkëpunim me komunitetin dhe familjarët e këtyre fëmijëve me aftësitë të kufizuara. “Gjatë vizitave të tyre në qendrën publike të PAK “Pellumbat”, fillimisht profesionistët e kësaj OJF-je që shkoi t’i asistonte, realizonin biseda dhe ju ofronin asistencë për të kuptuar më mirë situatën e fëmijëve të tyre me aftësi të kufizuara, mënyrën e kuptimit të nevojave të veçanta dhe të trajtimit të tyre. Aty konstatuan që shumica e familjeve vinin nga zona e Kombinatit, prandaj kjo OJF vendosi të zhvendoset dhe përqendrohej përsëri në këtë zonë, duke hapur këtë qendër ditore. Në të njëjtën zonë ndodhet edhe spitali publik distrofik”. Nga viti 1998, me mbështetjen e Organizatave të ndryshme të huaja, krijuan këtë model të ri shërbimesh për fëmijet me nevojë të veçanta.

OJF –të që sapo kanë hyrë në fushën e shërbimeve sociale të mbështetura nga projekti ende nuk janë të qarta në format e bashkëpunimit për të realizuar programet e veprimtarive të tyre, prandaj kanë nevojë për më tepër mbështetje në të ardhmen.

### 19.2 Procedura dhe aktoret e përfshira në vleresimin e nevojave sociale

Përgjigjet e drejtuesit, profesionistëve, klientëve dhe familjarëve të tyre tregojnë për një larmishmeri formash të përdorura për vleresimin e nevojave dhe për tërheqjen e komunitetit në qendrat e shërbimeve sociale. Me konkretisht ato klasifikohen në disa:

Së pari, vleresimi i nevojave vjen nga klientela e krijuar nga vazhdimësia e veprimtarisë së qendres<sup>38</sup>. Përvoja e tyre tregon një numër aktoresh të përfshira, që nga përfituesit – individët në nevojë/familjarët, deri tek shkollat, qendrat shëndetsore, OJF të tjera dhe donatorët të tjerë.

<sup>37</sup> Shih: Pasqyra Aneks #2, “Karakteristikat e OJF-ve të Mbështetura nga Projekti SSD”, BIA e SSDP, QSHKE 2006, Op.cit..

<sup>38</sup> Shih: Pasqyra Aneks #2, “Karakteristikat e OJF-ve të Mbështetura nga Projekti SSD”, BIA e SSDP, QSHKE 2006, Op. cit.,

Se dyti, administratoret sociale ne bashki/komuna qe mbulojne sherbimet sociale ju referojne here pas here raste qe kane nevojë per trajtime nga qendrat. Kjo tregon per fillimin e nje bashkepunimi te frutshem ne nivel komuniteti per trajtimin e nevojave te grupeve ne risk: femijeve – Every Child, personave me aftësi te kufizuara - Kombinat, te grave – Vaqarr, te te moshuarve – Orikum, etj.

Se treti, perfituesit drejtohen ne qender nga mjeket apo mesuesit e zones, si ne rastin e PAK – Kombinat; te te moshuarve dhe femijve – Krrabe. Madje ne disa qendra, mesuesit dhe mjeket ishin pjesemarres aktive ne realizimin e sherbimeve sociale. Konkretisht ne Fushe-Kruje ku mjeku i zones kishte hapur kartela per te moshuarit, apo per femijet ne qendren ne Kamez, apo mesuesi i shkolles ne Krrabe zhvillonte programin per femijet me probleme te shkolles dhe qe na u referuan si pjesetare te personelit te ketyre qendrave. (Pasqyra 4.)

Se katerti, ne disa qendra, terheqja e komunitetit dhe e personave ne nevojë eshte favorizuar nga vendndodhja e tyre: p.sh ne Qendren Kombinat nje pjese e PAK vinin nga Spitali distrofik i femijve te vegjel qe ndodhej ne te njejtin vend ne Kombinat. Femijet qe kalonin kufirin moshor 3 vjeç ne grupin e femijeve qe merrnin sherbim ne spitalin publik, mund te vazhdonin sherbimin ne kete qender. Po ashtu, qendra e sherbimit per te moshuarit ne Shkoder ishte ne te njejtin vend me qendren residenciale publike per te moshuarit. Ndersa nje pjese tjeter kishin zgjedhur si vendodhje dhe i zhvillonin sherbimet ne te njejten godine me ate te pushtetit vendor, prandaj ishte e lehte per t'i terhequr personat ne nevojë qe drejtoheshin per problemet e tyre ne zyrat e tij. (Rasti i qendrave si ajo ne Krrabe, Vaqarr, Fushe Kruje, etj.,)

Se pesti, ne disa qendra kryhet nje vleresim i vazhdueshem i nevojave si rezultat i bisedave, pyetesoreve, kutive te kerkesave/ankesave te perfituesve apo familjareve te tyre. Kjo veçanerisht per rastet e qendrave ditore, ku perfituesit jane prezent çdo dite ne qender.

Nderkohe qe ne njerën salle qendronte specialistja me dy femije te cileve u mesonte si te shkruanin, me beri shume pershtypje se nenat e tyre ishin mbledhur ne nje salle dhe se bashku me njerën prej punonjesve sociale diskutonin per probleme te ndryshme. Klima dhe harmonia qe mbizoteronte tregonte se kjo nuk ishte dicka qe zhvillohej per here te pare. Edhe nga bisedat e zhvilluara me nenat mora konfirmimin se keto mbledhje organizoheshin shpesh dhe ishin shume spontane, sipas nevojave qe lindnin per rastet e femijeve te veçante. (Pershtypje te intervistuesit nga qendra ne Kombinat.)

Se gjashti, nje forme tjeter e vleresimit te nevojave eshte kur profesionistet e nje qendre, ne fund te dites bejne vleresimet e tyre per ecurine e programit dhe te perfituesve te veçante. Keto rezultate, zakonisht reflektohen nga punonjesja sociale, psikologjia, edukatorja, mjekja, etj. ne bashkepunim mes tyre dhe nen drejtimin e menaxheres se qendres, ne hartimin e planeve ditore/mujore. Ne disa qendra ka nje vijimesi ne vleresimin e herepashershem te nevojave, qe jane ne varesi te rasteve konkrete. Ky vleresim nevojash pasqyrohej edhe ne fleksibilitetin ne hartimin e punes individuale me çdo klient te sherbimit ne qender.

Se shtati, qendrueshmeria e stafit profesionist eshte faktor baze ne vleresimin e nevojave dhe cilesine e sherbimeve. Ne Qendren Kombinat disa here ishte provuar qe punonjes te tjere te asistonin gjate zhvillimit te seancave me femijet AK, por kjo gje nuk kishte qene rezultative, pasi ata ishin familiarizuar me nje prej punonjesve dhe nuk ndiheshin komfort ne prani te personave te tjere, qofshin keta edhe pjestare te stafit.

Interesant ishte nje bllok ditor voluminoz, ne te cilin nuk evidentohet vetem ecuria e çdo femije, por edhe nje gershetim i asaj çka bente edukatorja me femijet dhe rezultatin qe arrinte me punen e saj tek femijet. Ne te kishte shenime te tilla si “dje e kam djallusur fare, mesimi i zanoreve nuk duhet bere ne ate menyre”, ose “...fitore, Altini pas 3 muajsh filloi te marre ilacet qe vazhdimisht jua refuzonte prinderve, me sa duket ndikoj perralla me figura me lepurushin e semure”.

Nje bllok tjeter shenimesh, qe ajo e konsideronte "top sekret", kishte te bente me vleresimin e edukatores per gjenezen e semundjes se femijes sipas pikepamjes se vet. pa u ndikuar nga diagnoza mjekesore. Kishte shenime te tilla qe "femija e ka ne gen", e ka "aksidentalisht", e ka "pasoje te nje semundjeje", etj. Interesant ishte fati qe per dy motra qysh ne vitin 2003 ajo kish vene shenimin, "pasoje e babait te alkoolizuar". Nje vit me pas. ne 2004 nena e tyre ishte ndare nga burri dhe ne vitin 2005 ishte rimartuar e tashme kishte nje femije nje vjeç, mese normal edhe sipas kontrollit mjekesor.

Se teti, krijimi i rrjeteve me ofrues te tjere jashte qendres. Sikurse u vu re nga nje dite qendrimi ne qendren ne Kombinat, perfshirja e ofruesve te tjere te sherbimeve ne nderhyrjet ndaj femijeve AK perben nje nga prioritetet e punes se qendres. Madje personeli kishin fituar besimin e familjareve sa qe ne nje rast konkret, kur nena erdhi sepse dikush i kishte rekomanduar nje mjek ne spital per ta vizituar djalin e saj 13 vjeçar dhe po e diskutonte me drejtuesen e qendres, kjo e fundit me qetesë e uli dhe i kerkoj qe ta diskutonin shtruar kete pune. Ideja ishte qe kerkesat e tyre bejne qe ofruesit te dalin jashte qendres per t'i plotesuar ato. Kete e realizon edhe "Every Child" ne Tirane qe bashkepunon me zyrat e punesimit, bizneset per ofrimin e sherbimeve te punesimit klienteve te saj.

### 19.3 Licensimi i OJF - siguri per arritjen e sherbimeve cilesore

Qëllimi që i vë vetes një OJF, duhet të formulohet qartë në përputhje me nevojat e komunitetit, përndryshe nuk mund të ekzistojë gjate, përveç rasteve kur, për disa arsye, ka mbështetje të fortë financiare apo nga pushteti vendor. "Kquadri ligjor per OJF pothuajse është i plotë dhe i mirëdetajuar, edhe si rezultat i projektit SSD"<sup>39</sup>.

Gjate vezhgimit sociologjik te realizuar per qellimet e ketij studimi, shpesh GP/QSHKE u referua neper "qendra te sherbimeve sociale me baze komunitare". Qendra është një formë e re e OJF-ve, e njohur nga Ligji nr. 8788, dt 7.5.2001, "Për OJF-të". Nga 15 Qendra te mbështetura nga projekti i BB vetem disa jane te licensuara, ndonese licensimi i ofruesve të shërbimeve socialë është një proces që tashmë ka filluar të aplikohet, që nga viti 2005.<sup>40</sup> Parimi i licensimit të veprimtarive të tyre lidhet me vlerësimin e kapaciteteve dhe sigurinë që shërbimet dhe veprimtaritë e tyre janë cilësore dhe plotësojnë standartet në fuqi që lidhen me mjedisin, profesionet, mënyrat e trajtimit te perfituesve, etj.

Po të mbështetemi tek qëllimi i licensimit, i cili kërkon të vlerësojë kapacitetet dhe kompetencën për të kryer një veprimtari në momentin që organizata sapo e ka ngritur shërbimin, matja e tyre bëhet me e vështirë. Kjo sepse në fillimet e tyre organizatat kanë më shumë ide dhe dëshira, sesa struktura e burime konkrete që të mund të vlerësohen.

Nga ana tjeter, marrja e licensës për një veprimtari në një fushë te caktuar ka si anë pozitive specializimin, konkretisht ne shërbimin për një grup të caktuar. Por kjo mund të rrezikojë jetëgjatësinë e disa organizatave, të cilat për shkak te mungeses se mbështetjes ne vendin tone kalojnë veprimtarine nga një fushë në tjetrën, sipas mbështetjes nga donatoret.

<sup>39</sup> Nga intervista me znj. A. Selmani, Specialiste e OJF ne OLSA, BIA e Projektit SSD, ET/QSHKE, Tirane 2006, Op. Cit.,

<sup>40</sup> Licensimi i ofruesve të shërbimeve sociale është detyrë e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, sipas VKM-së nr. 564, datë.12.08.2005, "Për licensimin e ofruesve te sherbimeve te perkujdesjes shoqerore", mbështetur në Ligjin Nr. 9355, datë 10.03.2005 "Per ndihmen dhe sherbimet shoqerore". Bazuar në këtë Udhëzim është ngritur Komisioni i licensimit në MPÇS, i cili shqyrton aplikimet si dhe vlerësimet e bëra nga Shërbimi Social Shtetëror. Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Drejtoria Juridike në MPÇS, për aplikimet.

Ideja e nevojës së licensimit të OJF-ve në projekt lidhet drejtpërdrejtë me arritjen e qëllimit të tij, sigurimit të qendrueshmerisë së veprimtarisë së këtyre OJF-ve në fushën e shërbimeve sociale. Konkluzioni nga studimi ynë është se disa ofrues shërbimesh e kanë kaluar fazën e fillimit dhe kanë krijuar vizionin e tyre për të ardhmen – OJF-ja e Kombinatit, Every Child, The door, etj. Prandaj dhe ato i shohim ta kenë kaluar me sukses fazën e licensimit, sepse kanë një target grup të përcaktuar dhe kanë përcaktuar strategjitë për arritjen e qëllimit dhe objektivave të tyre.

#### 19.4 Pershtatshmeria e shërbimeve të ofruara nga OJF

Ky komponent do të vlerësohet nga dy këndvështrime: ai i ofruesit dhe ai i perfituesve të shërbimit, si të perfituesve të drejtpërdrejtë, ashtu edhe të atyre jo të drejtpërdrejtë (të terthorë).

Referuar objektit të veprimtarisë së tyre, shumica e OJF-ve në shqyrtim synojnë të jenë qendra multidimensionale, 10 prej tyre, nga 15 OJF. Meqenëse tashmë OJF-të pretendojnë të ofrojnë më shumë shërbime, kuptohet se stafi profesionist me të cilin punojnë nuk mund t'i përgjigjet plotësisht këtij synimi. Ka ende mungesa në kapacitetin institucional të OJF-ve për t'i zbatuar plotësisht këto synime, për rrjedhojë edhe në aftësinë e tyre për t'iu përgjigjur nevojave të komunitetit. Varësia nga financimet e donatorëve është një nga shkaqet kryesore të kësaj situatë, që ato nuk janë në të njëjten linjë me kërkesat e komunitetit, por të donatoreve. Një nga ndikimet e projektit SSD është pikërisht ky, që t'i drejtoje shërbimet e reja të jenë të pershtatshme me nevojat e komunitetit, duke i kombinuar me burimet e forta të OJF-ve, si puna vullnetare dhe aftësia për të organizuar perfituesit dhe komunitetin.<sup>41</sup>

Një analizë e veprimtarisë së OJF-ve në fushën sociale sjell një spektër të gjerë shërbimesh që synon t'u drejtohet nevojave të komuniteteve ku ato veprojnë. Fakti që ato janë kontaktuar nga pushteti vendor, teorikisht duhet të jetë tregues i pershtatshmerisë së tyre, por realisht ky gjykim nuk mund të jetë plotësisht i drejtë. Disa nga argumentet janë:

- a) Pushteti vendor po përfshihet për herë të parë në fushën e shërbimeve sociale dhe natyrisht që i mungon përvoja.
- b) Mundësitë e zgjedhjes së pushtetit vendor janë të pakta, në kuptimin që qendrat e shërbimeve sociale sapo kanë nisur edhe ato veprimtaritë në fushën sociale. Nga analiza e situatës rezulton se në disa zona ato janë të vetmet qendra. Madje në kushtet e mungesës së OJF-ve të zonës, janë kontraktuar OJF- nga zona të tjera: rasti i Fushe Krujes (që i takon rajonit të Durrësit) që ka kontraktuar OJF me qendër në Tiranë. Nisur nga fakti se nevojat janë të shumta, investimi i OJF-ve në çfarëdoq fushe që ka të bëjë me grupet e përcaktuara në risk, mund të konsiderohet i dobishëm për komunitetin. Prandaj si ofruesit, ashtu dhe perfituesit shprehen se shërbimi ju pershtatet nevojave të komunitetit.<sup>42</sup>

<sup>41</sup> Nga Pasqyra Anekse nr. 8, rezulton se përfshirja e pushtetit vendor në mbulimin e kostove administrative, sipas parashikimit në kontratat me OJF, le shume për të dëshiruar. Vetëm 5 OJF, që e kanë mbështetur vetëm nga projekti SSD, kanë siguruar këto mbështetje edhe nga pushteti vendor. Ndonese jo me ndonjë kosto të veçantë. Kjo mbështetje ka konsistuar në faktin që OJF-ve, për të ushtruar veprimtarinë e tyre të deritanishme, u janë vënë në dispozicion mjediset e godinës së bashkisë/komunes. Shih Aneks #12, Minutat e Takimit të Grupit të Fokusuar, BIA e SSDP, ACER 2006.

<sup>42</sup> Në vijim të Raportit do të jepen karakteristikat sociale të këtyre zonave pilote dhe Qendrave respektive që veprojnë sipas rajoneve, me shërbimet sociale ndaj grupeve në risk. Për më shumë hollësi, shih: Aneks #6/4, Te dhëna mbi Anketimin e Grupit "Fëmijë" sipas Njesive Vendore dhe OJF-ve, sipas NjKP & VNDP të SSD, QShKE 2006 Aneks #6/5, Te dhëna mbi Anketimin e Grupit "Te rinj" sipas Njesive Vendore dhe OJF-ve, sipas NjKP & VNDP të SSD, QShKE 2006.

Sherbimet e ofruara nga OJF- te tentojne te përfshijne te gjitha grupet ne risk, ndonese te fokusuara ne sherbimet si me poshte:

- Shërbime për fëmijë :

1. Qendra për fëmijë nga familje në vështirësi social ekonomike - Kamez; The Door, Shkoder;
2. Qendra komunitare për gratë dhe fëmijët, kujdestari – synon Every Child;
3. Mbrojta e të drejtave të fëmijëve dhe kujdesi për ta - The Door, Shkoder; Every Child, Aulona - Vlore;
4. Fushata sensibilizmi për të drejtat e fëmijëve, mbrojtjen e fëmijëve nga trafikimi, shfrytëzimin e punës së tyre etj. - Every Child - Shkoder, Aulona - Vlore;

- Shërbime për gratë dhe vajzat:

1. Shërbim psiko-social - Vaqarr; Every Child, Aulona - Vlore;
2. Këshillim ligjor dhe shërbim avokatie – Everychild, Vaqarr; The Door, Shkoder;
3. Shërbime të shëndetit riprodhues Every Child - Shkoder, Aulona - Vlore;
4. Trainim, ndërmjetësim, kredi dhe mbështetje për punësimin e grave – Every Child – Shkoder, synon Vaqarri dhe Kamza;
5. Mbrojtja e të drejtave të grave dhe sanksionimi i tyre në legjislacion - Every Child - Shkoder, Aulona - Vlore;
6. Mbështetja për gratë kryefamiljare – Every Child – Tirane. Shkoder; Aulona - Vlore;
7. Formim profesional, etj. – Vaqarr, Every Child – Tirane ndërmjeteson per ofruesit e tjere

- Shërbime për personat me aftësi të kufizuara

1. Qendra ditore për fëmijët me AK - Kombinat;
2. Projekte për riintegrimin e PAK - Kombinat;
3. Përmirësimi i statusit ligjor të PAK - Kombinat;
4. Qendra informacioni për PAK - Kombinat;
5. Iniciativa të punësimit të PAK - Kombinat.

- Shërbime për të rinjtë:

1. Qendra rinore – Krrabe, Vaqarr;
2. Shërbime për parandalimin dhe rehabilitimin nga përdorimi i drogës dhe alkoolit: Krrabe, Vaqarr, Fushe Kruje.

Shërbime për të moshuarit

1. Shërbime ditore, në shtëpi – Fushe Kruje; Tirane, Orikum dhe Vlore.

Sikurse shihet OJF-të kane futur ne Shqiperi shërbime të reja dhe të shumëllojshme, krahasuar me shërbimet e kufizuara publike në llojshmëri dhe shpërndarje. Ato jane te vendosura si ne zonat urbane, edhe ne ato rurale, kur dihet qe sherbimet kane qene kryesisht te fokusuara ne qytete. Kryesisht qendrat qe veprojne ne Tirane jane me te medha ne numer, ndonese ato kane ne fokusin e punes se tyre shumicen e perfituesve nga familjet e ardhura vitet e tranzicionit ne Tirane nga zonat e tjera te vendit. Keta erdhen me shpresen e nje jete me te mire, por po perballen me veshtiresite e integrimin, kryesisht ne gjetjen e nje punesimi te qendrueshem, qe perben nje nga nevojat kryesore te zonave te vleresuara si nga pushteti vendor edhe nga kerkesat e perfituesve ndaj OJF-ve.

Aneks #6/6, Te dhena mbi Anketimin e Grupit “Gra” sipas Njesive Vendore dhe OJF-ve, sipas NjKP & VNdp te SSD, QShKE 2006.

Aneks #6/7, Te dhena mbi Anketimin e Grupit “Te moshuar” sipas Njesive Vendore dhe OJF-ve, sipas NjKP & VNdp te SSD, QShKE 2006.

Aneks #6/8, Te dhena mbi Anketimin e Grupit “Te paafte” sipas Njesive Vendore

## 20. Kapacitetet e OJF si ofruese te sherbimeve

Ketu do te analizohen disa komponente te rendesishem per realizimin e sherbimeve sociale te qendrueshme, te tilla si: siguria financiare; menaxhim i mirë; staf profesional; mjedise dhe pajisje të përshtatshme, etj.

Pasqyra Aneks #4 tregon se shumica e OJF-ve (10) kane perfituar mbeshtetje edhe nga donatore te tjere, qe mbulonin pothuajse pjesen dermuese te kostove te sherbimeve te tyre. Megjithate kostot e investimeve te realizuara nga projekti SSD tejkalojne te gjitha te tjerat dhe qe kane pasur nje ndikim te ndjeshem ne cilesine e sherbimeve te ofruara nga OJF-te ne studim.

Duke ju referuar vezhgimit te GP/QSHKE, ndonese projekti SSD ka ofruar investime te konsiderueshme ne krijimin e mjediseve dhe pajisjeve te pershtatshme per qendrat e reja qe kane vetem financimin e tij, mjediset e tjera lene per te deshruar. Ato kufizojne realizimin e sherbimeve sipas objektiveve te percaktuara, si dhe terheqjen e profesionisteve te kualifikuar ne keto sherbime.

Megjithate, nga intervistat si me ofruesit, ashtu dhe me perfituesit ata shprehen te kenaqur me personelin e sherbimeve sociale. Nga Pasqyra 7. rezulton se punonjesit sociale dhe psikologet e diplomuar jane te pakte ne numer dhe nuk figurojne ne te gjitha OJF-ofruese te sherbimeve sociale.

Vleresimet si te drejtuesve ashtu dhe te perfituesve per stafin, pergjegjshmerine dhe profesionalizmin e profesionisteve te sherbimeve rezultojne te jene te mira. Sipas intervistave, gati te gjitha drejtuesit ishin te kenaqur me stafin e tyre, vecanerisht per rastet kur ata e kishin rekrutuar ate vete. Ndersa ne nje pjese te rasteve, kur stafi ju ishte ofruar nga pushteti vendor, ka vend edhe per medyshje. Konkretisht stafi profesionist i Fushe Krujes, si punonjesi social apo personi ne rolin e psikologut, nuk kishin kualifikimin e duhur, por qe ishin rekrutuar me sugjerimin e Kryetarit Bahkise. Apo edukatorja e femijve ne Kamez, qe nuk kishte arsimin perkates si edukatore, por ishte nje nga grate banore te zones, e ofruar nga bashkia Kamez per tu punesuar aty. Nderkohe qe drejtuesja e qendres ne Krrabe, ndonese kishte punesuar staf vendas, me orientimin e kryetarit te komunes, ishte e kenaqur nga puna e mesueses me femijet apo e mjekes me te moshuarit. Po ashtu edhe drejtuesja e qendres ne Vaqarr, e cila kishte arritur te gjente nje punonjese sociale te diplomuar, ish banore e zones, e punesuar me kohe te plote dhe qe kryente nje pune te lavderueshme dhe te admirueshme nga komuniteti.

Gjithsesi, vleresimet pozitive te të intervistuarve qe mendonin se stafi i cili ofronte shërbimet në qëndër ishte i kualifikuar dhe ofronin një shërbim cilësor, mbeten subjektive dhe te lidhura edhe me nje sere faktoresh te tjere qe duhen vleresuar ne nje kontekst me te gjere. Vete drejtuesit kishin rol kryesor, prandaj ndonese ne disa raste kontaktet e tyre me qendren ishin te rralla (nje here ne jave – Krraba, Vaqarri, Fushe-Kruja, Kamza) ata ishin nje stimul i fuqishem per veprimtarine edhe te profesionisteve te tjere te qendres. Marredheniet e tyre me stafin ishin teper miqesore, te aferta, pa distanca hierarkie, qe sherben edhe si nje model i mire per institucionet publike qe ofrojne sherbime sociale. Ata bisedonin lirshem per problemet e sherbimeve, sa here qe dilnin probleme dhe mbeshtetja e drejtuesit ishte e ndjeshme, ndonese mungonin vleresimet e tyre për punen e stafit. Kjo ka nevojte te reflektohet ne te ardhmen, ne perpilimin e rregulloreve me kriteret e qarta si per rekrutimin e personelit, ashtu edhe per vleresimin sistematik te puens se tij. Bashkemenaxhimi i qendrave, nga drejtuesit dhe nga profesionistet permes nje komunikimi të mirë rrit ndjeshem cilësinë e shërbimit të ofruar – rastet e qendrave Every Child, Kombinat,.

Nga vizitat në qëndrat rezulton se 100% e drejtuesve ishin me arsim të lartë, ndonese asnjëri nuk kishte mbaruar studimet në fushën përkatëse<sup>43</sup>. Megjithate, pothuajse

<sup>43</sup> Shih Aneks #4/4, Te dhena mbi Nivelin Arsimor te Drejtoreve/Stafit OKryesor te PJF-ve, BIA e SSDP, ACER 2006

te gjithë, 100% e drejtuesve ishin të trainuar për problemet e shërbimeve sociale. Punonjësit social 42% e tyre kishin mbaruar arsimin përkatës (Punë sociale), mjekët 100% kishin mbaruar arsimin përkatës (Mjekësi), Edukatorët 50 % arsim përkatës, dhe Psikologë vetëm 0.25 kishin arsimin përkatës (psikologji). Kjo lidhet edhe me faktin që keto profesione kane filluar të njihen në Shqipëri vetëm pas vitit 1996 – puna sociale dhe pas vitit 2002 – psikologjia, si dege të Fakultetit të ri të Shkencave Sociale (Krijuar për herë të parë në vitin 1992, i njëjti vit me krijimin e MPCSSH).  
 Deri me tani në vendin tonë sistemi i centralizuar kishte vendosur qendra shërbimesh në disa nga qytetet kryesore, ku perfituesit e tyre ishin të detyruar të shkeputeshin nga mjedisi i meparshëm, familjaret, rrethi shoqëror, etj. Vendosija e shërbimeve në një zonë të vogël, me një klientelë në nivel komune apo lagjeje të Tiranës, sigurisht që do të ndikojë pozitivisht në cilësinë e tyre. Trajtimi me shërbime sociale i familjeve kryesisht të varfëra, sigurisht që lehtëson problemet e tyre të integritetit në komunitet, veçanërisht në rastin e fëmijëve, që ju projektohet një e ardhme ndryshe. Megjithatë, terheqja e grupeve të ndryshme sociale në një qendër, kryesisht p.sh. fëmijet problematike në shkollë si rasti i Krrabës, bën të mundur të të qëndrojnë së bashku të varfër dhe jo të varfër.

Paraqitja e shërbimeve alternative, midis shërbimit residencial dhe atij ditor, si rasti i kujdestarisë që po përpunohet ta fusë Every Child, apo i shërbimit për të moshuarit në familje – Shkoder, tregon për prirjen për të nderthurur traditën me modernën, duke përfituar nga avantazhet e të dyjave me qëllim që të rritet ndikimi tek perfituesit.

Zhvillimi me përparësi i keshillimeve psiko-sociale, kërkon angazhimin e me tepër punonjësve sociale dhe psikologëve në qendrat e shërbimeve sociale. Shembujt që në gjetëm janë premtues, ku si drejtuesit e qendrave ashtu dhe perfituesit e tyre shpreheshin të kenaqur me këtë formë të reja nderhyrjesh që nuk i kanë njohur më parë në jetën e tyre. Rasti i Vaqarrit ku psikologjia shkonte neper shtëpi e bente biseda intime me grata e vajzat e reja është tepër kuptimplote, për të inkurajuar angazhimin e profesionistëve të zonës në veprimtarinë e OJF, sepse në këtë rast edhe besimi i personave që trajtohen me shërbime është më i madh. Në këtë drejtim, bashkëpunimi me pushtetin vendor për rekrutimin e personelit të shërbimeve sociale ka nevojë të thellohet me tej në sensin e impakteve pozitive.

Një bashkëpunim me i mirë i ofruesve të shërbimeve sociale publike dhe OJF-ve do të ndikojë pozitivisht në shkëmbimin e përvojave pozitive dhe në rritjen e cilësisë së shërbimeve. Kjo do të bëjë që të zhvillohen me tej funksionet e tyre proaktive, në përmbushjen e nevojave të grupeve të vulnerabël. Keshtu jo vetëm që do të rritet mbulimi i grupeve në nevojë me shërbime të shumanshme, por edhe kapacitetet e ofruesve do të zhvillohen me tej.

Për zhvillimin me tej të kapaciteteve të ofruesve të shërbimeve për të rritur cilësinë e shërbimit të ofruar, gjithmone e me tepër del nevojë e një përzgjedhje më e kujdesshme në stafin profesionist të tyre, në kushtet që edhe oferta për profesionet e kerkuara vjen në rritje, me rritjen e të diplomuarve nga Fakulteti i Shkencave Sociale.

Sikurse duket dhe nga të dhënat e Pasqyrës Aneks #8, me pak se gjysma e njesive vendore kanë shlyer plotësisht detyrimet kontraktuale për funksionimin e qendrave të shërbimeve sociale. Sipas gjykimit tonë, kjo ndodh me shumë për shkak të koncepteve përjashtuese të drejtuesve të këtyre njesive vendore, dhe jo për mungesë të burimeve financiare, sepse s'ka si shpjegohet fakti që ato i shlyen Komuna Krrabe, një nga me të varferat në shkallë vendi dhe nuk i shlyen bashkia në Kombinatin (Tiranë) në Shkoder apo Vlorë.

Një konkluzion tjetër që GP nxorri nga vërtetimi ishte se me të predispozuar për të mbështetur veprimtarinë e qendrave sociale janë komunat se sa bashkitë, në një kohë që burimet monetare në dispozicion të tyre janë krejt të ndryshme.

## 21. Karakteristikat socialo-demografike të përfituesve të intervistuar<sup>44</sup>

### 21.1 Karakteristika social demografike per Qarkun Tirane

Ne qarkun e Tiranës tabloja paraqitet me e kompletuar, jo vetem per faktin se ne projekt eshte perfshire Bashkia e Tiranës dhe 3 minibashki te saj, por edhe sepse zona rurale paraqet diversitet social ekonomik dhe demografik. Ketu projekti ka realizuar mbeshtetjen e sherbimeve sociale edhe ne nje komune te zones fushore (Vaqarr), edhe ne nje komune te zones kodrinore (Krrabe) dhe mbi te gjitha nje bashki (Kamez) dhe nje minibashki te Tiranës (Kombinat) ku dominojne te ardhurit nga zonat verilindore e qe tashme priten te marrin statusin legal te banimit.

Ne Pasqyren Aneksë e meposhtme ne menyre te permbledhur paraqiten si te dhenat demografike ashtu edhe ato te target grupeve.

Pasqyra # 6

Te dhena Social Demografike per Qarkun Tirane

Njesia nr vendore	Popullsia		Femra		Familje				Papunesia	
	Gjithsej	Ne % ndaj qarkut	Gjithsej	Ne % ndaj qarkut	Gjithsej	Ne % ndaj qarkut	Me ndihme ekonomike	Ne % ndaj qarkut	Gjithsej	Ne % ndaj qarkut
1 B. Tirane	561395	76.1	284627	77.7	138916	77.2	5372	41.5	12683	56
2 " Kamez	81896	11.1	41696	11.4	16079	8.9	1529	11.8	2413	11
3 " Kavaje	36075	4.89	18264	5.0	8389	4.7	2087	16.1	1018	4.5
4 K. Vaqar	8600	1.17	4203	1.1	1828	1.0	46	0.4	134	0.6
5 " Krrabe	3063	0.42	1594	0.4	731	0.4	224	1.7	312	1.4
6 " Paskuqan	34540	6.78	24940	6.8	9804	5.5	763	5.9	469	2.1
<b>Qarku</b>	<b>737387</b>	<b>23.5</b>	<b>366139</b>	<b>23.2</b>	<b>179850</b>	<b>25.6</b>	<b>12941</b>	<b>12</b>	<b>22795</b>	<b>14</b>
Shqiperia	3142065		1576749		703712		111372		163030	

Burimi: VNDP SSDP/ QShKE 2006

Pasqyra #7

Te dhena per grupet ne risk

Njesia vendore	Grupet ne risk														Grupet ne risk te njesise gjithsej	
	Femijet			Te rinjte			Grate			Te moshuarit			Te paaflet			
	Gjithsej	Ne % ndaj femijeve ne risk te qarkut	Ne % ndaj gr. ne risk te njesise	Gjithsej	Ne % ndaj te rinjveve ne risk te qarkut	Ne % ndaj gr. ne risk te njesise	Gjithsej	Ne % ndaj grave ne risk te qarkut	Ne % ndaj gr. ne risk te njesise	Gjithsej	Ne % ndaj gr. ne risk te moshuarve ne risk te qarkut	Ne % ndaj gr. ne risk te njesise	Gjithsej	Ne % ndaj te paaflet te qarkut		Ne % ndaj gr. ne risk te njesise
1 B. Tirane	4604	25.2	9.6	11384	31.8	23.8	25224	55.3	52.6	4143	20.4	8.6	2565	36.1	5.4	47920
2 " Kamez	874	4.8	13.2	2458	6.9	37.2	1504	3.3	22.7	796	3.9	12.0	980	13.8	15	6612
3 " Kavaje	2454	13.5	30.7	2600	7.3	32.5	2336	5.1	29.2	284	1.4	3.5	328	4.6	4.1	8002
4 K. Vaqar	105	0.6	8.9	350	1.0	29.8	210	0.5	17.9	370	1.8	31.5	140	2.0	12	1175
5 " Krrabe	35	0.2	2.3	710	2.0	46.2	586	1.3	38.1	160	0.8	10.4	46	0.6	3	1537
6 " Paskuqan	189	1.0	27.4	29	0.1	4.2	79	0.2	11.5	261	1.3	37.9	131	1.8	19	689
<b>Qarku</b>	<b>18240</b>	<b>41.3</b>	<b>14</b>	<b>35810</b>	<b>29.0</b>	<b>28</b>	<b>45620</b>	<b>31</b>	<b>36</b>	<b>20260</b>	<b>20.8</b>	<b>15.9</b>	<b>7110</b>	<b>15.6</b>	<b>5.6</b>	<b>127040</b>
Shqiperia	44138			123351			147983			97227			45461			458160


Burimi: VNDP SSDP/ QShKE 2006

<sup>44</sup> Shih: Aneks #6/3, Te Dhena mbi Anketimin Sipas Njesive Vendore, BIA e SSDP, ACER 2006

Sikurse del nga te dhenat e mesiperme ne qarkun e Tiranes, projekti SSDP, do t'i sherbente nje popullsi ne qytete prej 215.746 (ose 29.3% te popullise qytetare te qarkut) dhe 46.203 banoreve ne zonen rurale (ose 23.16% te popullise rurale ne rang qarku). Nga pikpamja e shperndarjes se popullise, qendrat kane disproporcione te konsiderueshem. Keshtu ndersa ne Krrabe qendra sociale i sherben nje popullsi prej rreth 3.063 banoreve, ne Kamez ajo eshte per nje popullsi prej 81.896 banore. Per rrjedhoje edhe ngarkesa e stafit sipas grupeve ne risk te evidentuara nga zyrtar e ndihmes ekonomike dhe perkrahjes sociale prane komunave dhe minibashkive ka diference te theksuara. Keshtu, ne se ne Komunen Vaqarr nje psikologe sherben per 210 perfitues (gra dhe familje ne risk), ne minibashkine nr. 6 Kombinat eshte nje psikologe per 1.880 perfitues potencial nga grupet ne risk. Edhe pas venies ne funksionim te 6 qendrave sociale te reja te planifikuara per t'u hapur ne fazen e dyte te projektit SSD, perseri ne qarkun e Tiranes mbeten edhe 22 njesi vendore pa qendra te sherbimit social, te pa mbeshtetura nga programe financimi te BB, disa prej te cilave me popullsi rreth 20 mije banore.

### 21.1 Karakteristikat e perfituesve te intervistuar sipas njesive vendore, ofruesve te sherbimit dhe kategorive sociale per qarkun Tirane

U intervistuan gjithesej 205 perfitues te drejteperdrejte, ne te cilet ne 161 prej tyre u bene intervista me pyetesor dhe 44 bashkebisedime dhe investigime gjate procesit te marrjes se sherbimit, meqenese ishin ne moshe te vogel dhe/ose me aftesi te kufizuara. Ne te intervistuarit 144 prej tyre, (ose 70%), ishin femra dhe 61 (ose 30%) meshkuj. Perfituesit e intervistuar perbenin 13.6 % te perfituesve te drejteperdrejte te parashikuar ne 9 projekt- propozimet e OJF-ve dhe 10.7 % referuar numurit te perfituesve gjithesej, llogaritur per 6 qendrat qe kishin filluar nga aktiviteti si dhe 37.4 % te perfituesve totale qe kishin perfituar sherbime sociale prej fillimit te aktivitetit te po ketyre qendrave. Ndersa sipas grup moshave te perfituesve te drejteperdrejte te intervistuar, ishte kjo shperndarje:




**Grafiku #4:** Perfituesit Direkte ne Qarkun e Tiranes

Sipas nivelit arsimor, perfituesit e drejteperdrejte te intervistuar kane kete shperndarje,

- Pa arsim 46 perfitues ose 21.8% e perf. te intervistuar
- me arsim fillor dhe 8-vjecar 126 perfitues ose 61.0% e perf. te intervistuar
- me arsim te mesem 35 perfitues ose 17.2% e perf. te intervistuarve

Sipas perberjes familjare per 161 perfituesit te intervistuar me pyetesor kemi situaten qe paraqitet ne grafikun e meposhtem.

## Perberja familjare e perfituesve te intervistuar




Grafiku #5: Perberja Familjare e Perfitueve te Intervistuar ne Qarkun e Tiranes

Sikurse del nga te dhenat e mesiperme peshen specifike me te madhe e zene familjet me 5 e mbi 5 pjestare, rreth 59%, kur keto familje ne qarkun e Tiranes zene vetem 37.8% te kesaj kategorie te perberjes familjare.

Kurse sipas statusit te gjendjes civile, vetem per perfituesit e intervistuar me pytesor, tabloja paraqitej si me poshte,

## Gjendja civile e perfituesve te intervistuar



Grafiku #6: Statusi Civil i Perfituesve te Intervistuar ne Qarkun e Tiranes

Sipas nivelit te punesimit familjet e 161 perfituesve direct te intervistuar paraqiten si me poshte,

- pa asnje pjestar te punesuar 88 ose 54.4% e perf. te intervistuar
- me nje e dy te punesuar 33 ose 20.9% e perf. te intervistuar
- te vetepunesuar 40 ose 24.7% e perf. te intervistuar


Nga te intervistuarit si perfitues direkte vetem 55 ose 34.1% e te intervistuarve, ishin qe familjet e tyre perfitonin ndihme ekonomike.

Niveli i papunesise paraqitet shume me i larte se niveli mesatar i qarkut te Tiranes(17.1%) dhe po keshtu edhe niveli i familjeve te trajtuara me ndihme ekonomike kundrejt nivelit mesatar ne qarkun e Tiranes.

34 perfitues direct te intervistuar ose 21.5% e totalit te te intervistuarve kishin nga nje ose me shume pjestare te familjes ne emigracion.Kjo mund te jete nje nga shkaqet kryesore te mosperputhjes midis nivelit te punesimit, pra dhe te te ardhurave dhe gjendjes faktike ekonomike( psh ne lagjen e Bathores te Bashkise Kamez te gjitha dhtepite jane te

reja, me volume te medhe dhe te ndertuara ne 10 vjetet e fundit, nderkohe qe vetem 11.4% e te intervistuarve paraqiten probleme aktuale per strehimin e familjeve te tyre.)

Sikunder del edhe nga paraqitja grafike ne fig.2, 25 perfitues ose 15.8% e totalit te perfituesve te intervistuar ishin te ardhur pas viteve 90 ne zonat ku qendrat sociale ushtonin aktivitetin e tyre.



□ te ardhur pas viteve 90 ■ banore vendas

**Grafiku #7: Perberja e te Intervistuarve sipas Levizjes Demografike**


Shperndarja e sherbimeve sipas 205 perfituesve gjithsej te intervistuar ishte si me poshte:

• Edukim	187 ose 91.0% e perf. te intervistuar
• Shlodhje argetim	205 ose 100.0% e perf. te intervistuar
• Vetebesim integrim	10 pd ose 5.0% e perf. te intervistues
• Mbrojtje nga drogat	20 pd ose 10.0% e perf. te intervistuar
• Mbrojtje nga trafikimi	20 pd ose 10.0% e perf. te intervistuar
• Keshillim ligjor	35 pd ose 17.2% e te intervistuar
• Mbrojtje ndaj te kercenuarve	10 pd ose 5.0% e te intervistuar
• Sherbime rehabilitimi	31 pd ose 15.3% e te intervistuar
• Trajtim i familjes	41 pd ose 20.3% e te intervistuar
• Sherbim ne shkolle	40 pd ose 20.1% e te intervistuar
• Sherbim baze shtepie	39 pd ose 19.3% e te intervistuar
• Informim public	85 pd ose 42.1% e te intervistuar
• Sherbim Shendetesor	34 pd ose 17.0% e te intervistuar
• Sherbim punesimi	18 pd ose 8.9% e te intervistuar

Sikurse del nga te dhenat e mesiperme sherbimi me i perhapur dhe me peshe specifike me te madhe nder perfituesit eshte ai i edukimit, shlodhje argetimit dhe informimit public. Ne grupin e dYTE perfishihen sherbimi trajtimit te familjes, sherbimi ne shkolle. Sherbimi shendetesor, keshillimi ligjor dhe sherbimi i rehabilitimit. Kurse kurse 5 sherbimet e tjera zene nje peshe specifike me te vogel.

Kurse sipas sherbimeve te perfituara, perfituesit e intervistuar klasifikohen si me poshte:

**Perfituesit e intervistuar sipas Sherbimeve te perfituara**



**Grafiku #8**

Mesatarisht perfituesit e intervistuar kishin perfituar rreth 4.3 sherbime. Vetem 32 perfitues te intervistuar, ose 19.6% e gjithe perfituesve te intervistuar, kane perfituar sherbime sociale para se te merrnin nga qendrat sociale te perfshira ne projektin e mbeshetur financiarisht nga BB. Ajo cka eshte evidente nga kjo pasqyre eshte se sherbimi i perfituar nga perfituesit te drejteperdrejte te intervistuar eshte multidimensional.

## 21.2 Karakteristika social demografike per Qarkun Shkoder

Ne qarkun e Shkodres, nga projekti SSD jane zbatuar 5 projekte te sherbimeve sociale, 3 ne bashkine Shkoder dhe 1 ne Komunen Bushat dhe 1 bashkine e Pukes. Po zbatohen normalisht te gjitha projektet duke ofruar sherbimet sociale te percaktuara ne kontratat e tyre, edhe pse projekti i OJF –se “Qendra ditore e hapur” “The Door” nuk ka filluar akoma ne ambientet e reja, pasi eshte nderprere rikonstruksioni i pjeses se objektit qe do te vihet ne dispozicion te tyre.<sup>45</sup>

Ne pasqyren e meposhme (Pasqyra #2) jepen te dhenat social-demografike te popullsise, familjeve dhe niveli i papunesise ne qarkut Shkoder dhe te njesive vendore ku eshte implementuar projekti i financuar nga BB.

Te dhenat social-demografike per Qarkun Shkoder

Pasqyra #2

Njesia vendore	Popullsia		Femra		Familje				Papunesia	
	Gjithsej	Ne % ndaj qarkut	Gjithsej	Ne % ndaj qarkut	Gjithsej	Ne % ndaj qarkut	Me ndihme ekonomike	Ne % ndaj qarkut	Gjithsej	Ne % ndaj qarkut
B. Shkoder	112440	32,1	6512	3,7	26771	38,3	5465	31	15998	63,9
" Puke	5761	1,65	1068	0,6	1529	2,2	259	1,5	1941	7,8
K. Bushat	22550	6,44	10887	6,2	5744	8,2	214	1,2	398	1,6
<b>Qarku</b>	<b>349969</b>	<b>11,1</b>	<b>175334</b>	<b>11,1</b>	<b>69905</b>	<b>9,9</b>	<b>17800</b>	<b>16,0</b>	<b>25012</b>	<b>15,3</b>
Shqipëria	3142065		1576749		703712		111372		163030	

Burimi: VNDP SSDP, QShKE 2006

Te dhenat per grupet ne risk

Pasqyra #3

nr	Njesia vendore	Grupet ne risk												Grupet ne risk te njesise (gjithsej)			
		Femijet			Te rinjte			Grate			Te moshuarit				Te paafjet		
		Gjithsej	Ne % ndaj femijeve ne risk te qarkut	Ne % ndaj grupeve ne risk te njesise	Gjithsej	Ne % ndaj te rinjve ne risk te qarkut	Ne % ndaj grupeve ne risk te njesise	Gjithsej	Ne % ndaj grave ne risk te qarkut	Ne % ndaj grupeve ne risk te njesise	Gjithsej	moshuarve ne risk te qarkut	Ne % ndaj grupeve ne risk te njesise		Gjithsej	Ne % ndaj te paafjetve ne qarkut	Ne % ndaj grupeve ne risk te njesise
1	B. Shkoder	1406	49,6	7,5	7413	45,4	38,9	7134	57,1	37,5	1102	48,2	5,8	1985	47	10,3	19040
2	" Puke	132	4,7	8,3	635	3,4	40,0	642	5,1	40,4	74	3,2	4,6	107	2,5	6,7	1590
3	K. Bushat	70	2,5	14,8	113	0,7	24,0	140	1,1	29,7	85	3,7	18,2	63	0,2	13,3	471
	<b>Qarku</b>	<b>2832</b>	<b>6,4</b>	<b>7,41</b>	<b>16335</b>	<b>13,2</b>	<b>42,8</b>	<b>12492</b>	<b>8,4</b>	<b>32,7</b>	<b>2286</b>	<b>2,4</b>	<b>6,0</b>	<b>4257</b>	<b>9,4</b>	<b>11,1</b>	<b>38202</b>
	Shqipëria	44138			123351			147983			97227			45461			458160

Burimi: VNDP SSDP, QShKE 2006

<sup>45</sup> Shih: Aneks #4/3 Niveli i Mbeshettes per Mjediset e Punes dhe Pajisjet, BIA e SSDP, QSHKE 2006.


Nga analiza e dhenave te ofruara nga qarku, rezulton se numri i familjeve ka ardhur duke u ulur si rezultat i levizjes drejt qendrave urbane kryesisht ne brezin Tirane-Durres, megjithese ka nje rritje te konsiderushme te popullsisë se qytetit te Shkodres si rezultat i zbritjes se popullsisë nga zona malore si dhe nga rrethet Malesi e Madhe dhe Puke.

Nga te dhenat e Ministrise se Punes e Çeshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta te vitit 2004, ne qarkun e Shkodres jane 2832 femije ne risk ose 6 % te atyre ne shkalle vendi, por ne kete qark 338 femije jane viktime te gjakmarrjes, duke u renditur i dyti pas qarkut Tirane, per numrin me te madh te tyre. Prandaj ne qarkun e Shkodres jane mbeshtetur nga projekti dy qendra sherbimesh sociale qe i drejtohen ketij grupi te femijeve qe jane viktime te gjakmarrjes, si ajo The Door ne qytetin e Shkodres dhe qendra e komunen e Bushatit, qendra ne Barbullush.

Ne teresi rezulton qe ne qarkun e Shkodres, projekti ka ofruar sherbime sociale pothuajse per te gjitha grupet ne risk, ndonese sherbimet per te rinjte ka nevojte te mbeshteten me perparesi ne kete qark. Mbeshtetja me sherbime sociale eshte perqendruar me teper ne Bashkine Shkoder, edhe per faktin se kjo njesi vendore ka 32.1 % te popullsisë se qarkut dhe 49.8 te personave ne risk. Po ashtu ne bashkine Shkoder familjet e varfera qe perfitojne ndihme ekonomike perbejne 31% te perfituesve ne nivel qarku, si dhe papunesia shkon ne masen 63.9 % te personave te papune ne qark.

### 21.2.1 Karakteristikat social demografike te perfituesve te intervistuar sipas njesive vendore, ofruesve te sherbimit dhe kategorive sociale per qarkun Shkoder

Ne qarkun e Shkodres perfitojne drejperdrejte nga sherbimet sociale te mbeshtetura nga projekti i Bankes Boterore 258 femije ose 9.2 % e femijeve ne risk, 461 gra ose 3.7 % e grave ne risk, 89 te rinj ose 0.5 % e te rinjeve ne risk dhe 108 te moshuar ose afer 4.7 % e atyre ne risk. Ndersa numri i perfituesve te terthorte eshte 2,975 vete. Perfituesit e terthorte, te ndare sipas grupeve paraqiten ne grafikun e meposhtem:



**Grafiku #2:** Perfituesit Indirekte ne Qarkun e Shkodres

Ne qarkun e Shkodres nga 916 perfitues direkte u intervistuan 90 prej tyre ose 9.8% dhe nga 2975 perfituesit indirekte 47 prej tyre (afer 2 %). Sipas grupeve sociale 40.0 % e intervistave gjithsej u perkasin femijeve, te rinjte zene 5,5 %, ndersa 41,2 % jane gra dhe 13,3 % jane te moshuar. Nga 137 persona te intervistuar gjithsej, 93 jane femra ose 67,9 % e tyre.

Megjithese zbatimi i mbeshtetjes nga projekti SSD ka filluar ne vitin 2005, rezulton se keto OJF kane nje pervojte te pasur ne fushen e sherbimeve sociale, pasi 33% ose 30 te intervistuar nga perfituesit e drejteperdrejte jane trajtuar edhe me pare nga keto organizata.

Perfituesit gjithsej te intervistuar te ndare se si jane pjestare te numrit te anetareve te familjes si me poshte:


nga familjet me 1 e 2 anetare	17	perfitues ose	12,4 %
nga familjet me 3 e 4 anetare	29	"	ose 21,2 %
nga familjet me 5 anetare	75	"	ose 54,7 %
nga familjet me mbi 6 anetare	16	"	ose 11,7 %

Nga te 137 intervistuarit gjithsej rezulton se jane femije parashkollor 30 ose 21,9 % e tyre; 8 veta jane me arsim fillor (5,8 %); 65 jane me arsim 8vjeçar (47,4 %) . 34 jane me arsim te mesem (24,8 %).

Nga te dhenat e mesiperme rezulton se numrin me te konsiderueshem e perben niveli i arsimit 8-vjeçar dhe ne vend te dyte ato me shkolle te mesme. Kjo eshte pothuajse tersisht per grate dhe vajzat perfituese, pasi femijet jane kryesisht te moshes parashkollore dhe ne nje perqindje edhe tek te moshuarit.

Lidhur me statusin civil te te intervistuarve gjithsej verehet klasifikimi i meposhtem:

### Gjendja civile e perfituesve te intervistuar



**Grafiku #3:** Statusi Civil i te Intervistuarve

E veçante duket dhe gjendja e punesimit e familjeve te perfituesve, ku 73 % e tyre nuk kane te punesuar pjesetare te familjes (kjo edhe ne baze te njohjes qe kishte stafi i projekteve per femijet); 14 jane pjestare qe punojne ne ekonomine informale (10 %); me 1 pjestare te punesuar (10 %); me 2 te punesuar 4 % dhe 3 % kane pjestare te familjes te vetepunesuar. Nga te intervistuarit gjithsej, rezultojne 29 familje qe perfitojne ndihme ekonomike ose 21 % e tyre dhe 35 % e tyre kane pjestare te familjes ne emigracion. Ne te tre projektet e Shkodres, 52 % jane perfitues te ardhur ne kete bashki pas vitit 1990. Ne fakt ne se zbritet kategoria e te moshuarve, kjo shifer rritet ne 58 % e tyre.

Sherbimet sociale qe kryhen ne Shkoder dhe Bushat jane ekzistuese, çka tregon se OJF ne kete rajon kane zhvilluar aktivitet dhe jane te njohura edhe me pare se te fillonte mbeshetja e projektit te BB. Kjo vertetohet edhe nga numri i perfituesve te drejteperdrejte te intervistuar qe njohurite per aktivitetin e projektit i kane marre nga qenia e tyre ne projektet e meparshme ne masen 33 %. Ndersa kane marre njohuri nga familjaret e tyre 17 te intervistuar te drejteperdrejte ose 19 % e tyre, 10 intervistues nga administratoret dhe zyrat e sherbimit social shteteror, pra 9,2 % e tyre, 14 % nga perfituesit e fillimit dhe pjesa e tjetere nga njohja e stafit te OJF-ve zbatuese te projektit.

Persa i perket kohes qe marrin sherbim, menyra e te trajtuarit nuk eshte e lidhur me kohen e fillimit te projektit, por me periudhen qe jane trajtuar nga OJF ofruese e tyre.

Keshtu, 60 nga 90 perfituesit direkte kane me pak se 1 vit trajtim ose 67 % e tyre; 25 nga 1-2 vjet ose 28 % dhe dhe 5 % mbi 2 vjet.

Pare sipas llojit te sherbimit social, rezulton se per te gjithë grupet e trajtuara eshte ofruar sherbim si shlodhje dhe qender rekreative; femijet marrin edhe edukim e sherbim shendetesor si dhe sherbim ne shkolle; te rinjte edhe edukim e mbrojtje ligjore e informim; grate edhe argetim, mbrojtje ligjore dhe informim; te moshuarit vetebesim dhe integrim, rehabilitim, sherbim shendetesor dhe sherbim ne shtepi si dhe informim publik.

### 21.3 Karakteristikat Social Demografike per qarkun Durres

Ne kete Qark eshte vetem nje qender sherbimesh sociale qe mbeshtetet nga projekti SSD dhe konkretisht ne Bashkine Fushe- Kruje. Megjithate, ne i jemi referuar edhe te dhenave ne nivel Qarku. Ne analize te te dhenave te ofruara nga administrata e Qarkut Durres kemi kete tablo social demografike:

Te dhena Social Demografike per Qarkun Durres

Pasqyra #4

Njesia vendore	Popullsia		Femra	Familje					Papunesia	
	Gjithsej	Ne % ndaj qarkut	Gjithsej	Ne % ndaj qarkut	Gjithsej	Ne % ndaj qarkut	Me ndihme ekonomike	Ne % ndaj qarkut	Gjithsej	Ne % ndaj qarkut
	B. F-Kruje	23056	7,9	11318	7,7	5684	6,0	340	14	1182
<b>Qarku</b>	<b>291070</b>	<b>9,3</b>	<b>147529</b>	<b>9,4</b>	<b>94656</b>	<b>13,5</b>	<b>2386</b>	<b>2,1</b>	<b>8565</b>	<b>5,3</b>
Shqiperia	3142065		1576749		703712		111372		163030	

Burimi: VNDP SSDP/ QShKE 2006

Te dhena per grupet ne risk

Pasqyra # 5

Njesia vendore	Grupet ne risk												Grupet ne risk te njesise gjithsej			
	Femijet			Te rinjte			Grate dhe familjet			Te moshuarit				Te paafet		
	Gjithsej	Ne % ndaj femijeve ne risk te qarkut	Ne % ndaj grupeve ne risk te njesise	Gjithsej	Ne % ndaj te rinjteve ne risk te qarkut	Ne % ndaj grupeve ne risk te njesise	Gjithsej	Ne % ndaj grave ne risk te qarkut	Ne % ndaj grupeve ne risk te njesise	Gjithsej	Ne % ndaj te moshuarave ne risk te qarkut	Ne % ndaj grupeve ne risk te njesise		Gjithsej	Ne % ndaj paafteve te qarkut	Ne % ndaj grupeve ne risk te njesise
B F- Kruje	161	5.4	4.1	300	6.1	7.6	575	6.6	14.6	2540	16.5	64.6	353	8.2	9.0	3929
<b>Qarku</b>	<b>3005</b>	<b>6.8</b>	<b>8.3</b>	<b>4935</b>	<b>4</b>	<b>13.6</b>	<b>8647</b>	<b>5.8</b>	<b>23.8</b>	<b>15377</b>	<b>15.8</b>	<b>42.4</b>	<b>4292</b>	<b>9.4</b>	<b>11.8</b>	<b>36256</b>
Shqiperia	44138			123351			147983			97227			45461			458160

Burimi: VNDP SSDP/ QShKE 2006

Nga te dhenat e pasqyave te mes te mesiperme rezulton qe, ndonese popullsia e Bashkise Fushe-Kruje ze 7.9 % e popullsesise se qarkut Durres dhe ka vetem 10.8 % te

kategorive te personave ne risk, per vecorite ekonomiko sociale te kesaj Bashkie, me te drejte eshte gjykuar ngritja dhe venia ne funksionim e nje qendre sociale multidisiplinare kryesisht per te moshuarit, por edhe per te rinjte. Keto grupe zene nje perqindje te ndjeshme ne totalin e grupeve ne risk, konkretisht te moshuarit ne risk zene 16.5% ndaj ketij grupi ne nivel qarku, qe eshte me e larte sesa mesatarja e qarkut per kete grup ne nivel kombetar.

### 21.3.1 Karakteristikat social demografike te perfituesve te intervistuar sipas njesive vendore, ofruese te sherbimit dhe kategorive sociale per qarkun Durres

Nga qendra e sherbimeve sociale ne bashkine e Fushe Krujes qe ka siguruar mbeshtetjen nga projekti i Bankes Boterore perfitues te drejteperdrejte jane 20 te rinj ose 6,7 % e te rinjve ne risk ne nivel bashkie dhe afer 0,4 % ne nivel qarku si dhe 80 te moshuar ose 3 % e atyre ne risk te bashkise dhe 0,5 % ne nivel qarku. Ndersa 300 eshte numri i perfituesve jo te drejteperdrejte. Perfituesit e drejteperdrejte te ndare sipas grupeve jane:

- Te rinj 20 perfitues ose 20 %
- Te moshuar 80 perfitues ose 80 %

Ne qarkun e Durresit nga 100 perfitues direkt u intervistuan 13 prej tyre ose 13 % dhe nga 300 perfituesit jo te drejteperdrejte 6 prej tyre (2 %). Sipas grupeve sociale 74 % e intervistave gjithsej u perkasin te moshuarve dhe 26 % te rinjve. Nga 19 perfituesit e intervistuar gjithsej, vetem 2 jane femra ose 10 % e tyre.

Mbeshtetja e projektit te Bankes Boterore per sherbimet sociale qe i drejtohen kategorise se te rinjve dhe te te moshuarve ne risk eshte e rendesishme perderisa krijimi i nje qendre te tille eshte nje sherbim i ri qe nuk ka ekzistuar me pare. Prandaj dhe perfituesit nuk jane trajtuar me pare me sherbime sociale. Perfituesit e intervistuar, te ndare sipas numrit te anetareve te familjes qe i perkasin jepen me poshte:

- nga familjet me 1-2 anetare 15 perfitues ose 78,9 %
- nga familjet me 3-5 anetare 4 “ ose 21,1 %

Nga te 19 perfituesit gjithsej te intervistuar rezulton se:

- 5 jane me arsim fillor ose 26,2 %
- 11 jane me arsim 8-vjeçar ose 58,0 %
- 3 jane me arsim te mesem ose 15,8 % .

Nga te dhenat e mesiperme del se numrin me te konsiderueshem e perben niveli i arsimit 8-vjeçar kjo e lidhur edhe me peshen specifike te te moshuarve perfitues te intervistuar.

Lidhur me gjendjen civile te perfituesve te intervistuar gjithsej, verehet klasifikimi i meposhtem:

- te martuar 47,3 % ose 9 persona
- te divorcuar 5,7 % ose 1 person
- te veje 31,2 % ose 6 persona
- beqare 15,8 % ose 3 persona

Nisur nga punesimi i familjareve te perfituesve te intervistuarve reflektohet niveli i larte i papunesise, ku asnjeri prej tyre nuk ka te punesuar. Kjo vjen edhe per shkak se te moshuarit jane kryesisht te vetmuar (edhe ne baze te njohjes qe kishte stafi i projektit).

Nga perfituesit gjithsej te intervistuar ne kete qender, 2 familje perfitojne ndihme ekonomike ose 10.5 % e tyre dhe 5 % e tyre kane pjestare te familjes ne emigracion. Eshte me se e kuptueshme per kategorine e te moshuarve te cilet po i analizojme, lidhur kjo edhe me faktin qe vetem 1 perfitues i intervistuar rezulton te jete banor i pas viteve '90 ne bashkine e Fushe-Krujes.

Po ashtu te gjitha sherbimet sociale qe kryhen jane te reja. Perfituesit e drejteperdrejte (13) ne pjesen me te madhe (9) rreth 70 % kane patur si burim informacioni zyren e ndihmes ekonomike dhe perkujdesjes sociale ne bashki dhe pjesa e tjeter nga familjaret e tyre.

Meqenese jane sherbime te reja, qe te gjitha perfituesit kane me pak se nje vit qe jane perfshire, ende nuk kane marre te gjitha sherbimet e planifikuara nga kjo qender. Kjo per shkak se edhe ambienti ishte I papershtatshem, ende qendra funksiononte ne ambientet e bashkise dhe pritej perfundimi I investimit modern brenda nje kohe te shkurter.

Pare sipas llojit te sherbimit social, rezulton se per dy grupet e trajtuara ( te rinjte dhe te moshuarit) u ofrohet sherbim si shlodhje e qender rekreative, si dhe keshillim dhe mbrojtje ligjore (100 % e perfituesve drejteperdrejte); ndersa te rinjve u ofrohet gjithshu edukim, integrim, mbrojtje nga droga dhe alkoli<sup>46</sup> dhe sherbim ndermjetesim punesimi (20 % e perfituesve te drejteperdrejte). Te moshuarve u ofrohet edhe sherbim shendetesor (80 % te perfituesve te drejteperdrejte).

#### 21.4 Karakteristikat social demografike per qarkun Vlore

Tabloja social demografike per kete qark paraqitet si me poshte:

Pasqyra #8

Te dhena Social Demografike per Qarkun Vlore

Njesia vendore	Popullsia		Femra		Familje				Papunesia	
	Gjithsej	Ne % ndaj qarkut	Gjithsej	Ne % ndaj qarkut	Gjithsej	Ne % ndaj qarkut	Me ndihme ekonomike	Ne % ndaj qarkut	Gjithsej	Ne % ndaj qarkut
	B. Vlore	125432	61	63234	61,2	29328	61	1859	76,4	4120
" Orikum	10887	5	5397	5,23	2651	5,5	13	0,5	344	4,0
<b>Qarku</b>	<b>207038</b>	<b>6,6</b>	<b>103264</b>	<b>6,5</b>	<b>48148</b>	<b>6,8</b>	<b>2433</b>	<b>2,2</b>	<b>8520</b>	<b>5,2</b>
Shqiperia	3142065		1576749		703712		111372		163030	

<sup>46</sup> Shih: Ankes #9, Te Dhena mbi Grupet sociale te Perfshira ne Vepriptari Kriminale, sipas MB, BIA e SSDP, ACER 2006 (Sqarim Metodologjik: Megjithe perpjekjet per te grumbulluar informacion nga institucionet publike dhe jo publike, vendase dhe te huaja qe ishin perdorur si burime indormacioni ne raportin VNICA, per nje numer aresyesh duke perfshire edhe kohen e shkurter qe nga fillimi i zbatimit te projektit dhe afatin e pergatitjes se Vleresimit te Ndikimit te tij tek Perfituesit, GP nuk pati mundesi te ballafaqonte te njetet tregues ne dy periudha te ndryshme kohe).

## Te dhena per grupet ne risk


Lloji i vendore	Grupet ne risk															Gjithsej
	Femijet			Te rinjte			Grate dhe familjet			Te moshuarit			Te paafet			
	Gjithsej	Ne % ndaj femijeve ne risk te qarkut	Ne % ndaj grupeve ne risk te njesise	Gjithsej	Ne % ndaj te rinjve ne risk te qarkut	Ne % ndaj grupeve ne risk te njesise	Gjithsej	Ne % ndaj grave ne risk te qarkut	Ne % ndaj grupeve ne risk te njesise	Gjithsej	Ne % ndaj fte moshuarave ne risk te qarkut	Ne % ndaj grupeve ne risk te njesise	Gjithsej	Ne % ndaj te paafteve te qarkut	Ne % ndaj grupeve ne risk te njesise	
Vlore	1341	44.6	5.9	2178	39.7	9.6	7033	35.7	31.0	9740	51.7	42.9	2393	33.6	10.5	22685
Orikum	78	2.6	9.6	164	2.988	20	383	1.943	47.2	86	0.5	5.81	101	2.45	12.4	81
Qarku	3003	6.8	5.9	5489	4.45	10.7	19716	13.32	38.5	18842	19.4	36.8	4115	9.05	8.04	5116
hqiperia	44138			123351			147983			97227			45461			45816

Sikurse duket dhe nga te dhenat e mesiperme ne qarkun e Vlores, sherbimet e mbeshtetura nga projekti SSD, kane mbuluar nje popullsi prej rreth 138,3 mije banore ose rreth 65% te popullsisë se qarkut. Peshen specifike kryesore e ze bashkia Vlore. Ndersa personat ne risk te perfshire ne sherbimet sociale te qendrave te mbeshtetura nga projekti I BB zene rreth 44.3 % te kesaj kategorie ne nivel qarku.

#### 21.4.1 Karakteristikat social demografike te perfituesve te intervistuar sipas njesive vendore, ofruese te sherbimit dhe kategorive sociale per qarkun Vlore

U intervistuan gjithsej 62 perfitues te drejtperdrejte, prej tyre 18(ose 29%), femra dhe 44 (ose 71%) meshkuj. Perfituesit e intervistuar perbenin rreth 4% te perfituesve te drejtperdrejte te parashikuar ne projekt propozimet e 4 OJF/ve dhe 4.7% te parashikimeve te atyre qe kishin filluar aktivitetin. Ata perbenin rreth 23.4% te te gjithe perfituesve qe kishin marre sherbime ne qendrat sociale prej fillimit te aktivitetit te tyre.

Shperndarja sipas grup moshave te perfituesve te drejtperdrejte te intervistuar, eshte si me poshte:



**Grafiku #9:**


Sipas nivelit arsimor, perfituesit te drejtperdrejte te intervistuar kane kete shperndarje,

- me arsim fillor 4 perfitues ose 6.5% e perf. te intervistuar
- me arsim 8/vjecar 35 perfitues ose 56.4% e perf. te intervistuar

- me arsim te mesem 22 perfitues ose 35.4% e perf. te intervistuar
- me arsim te larte 1 perfitues ose 1.7% e perf. te intervistuar

Sipas perberjes familjare perfituesve te drejteperdrejte paraqiten si me poshte,

### Perberja familjare e perfituesve te drejteperdrejte te intervistuar




#### Grafiku #10:

Sikurse del nga te dhenat e mesiperme, peshen specifike me te madhe e zene familjet me deri 3 pjesetare, rreth 54%, sepse dy nga qendrat ne kete qark ju sherbenin pensionistev dhe te moshuarve te vetmuar. Kjo duket dhe ne faktin se ndersa ne rrethin e Vlores numri mesatar i pjesetarve te familjeve eshte 4,7 pjesetare ne kete kategori perfituesish te intervistuar del 3.34 pjesetare.

Kurse sipas statusit te gjendjes civile tabloja paraqitej si me poshte:

### Gjendja civile e perfituesve te intervistuar



#### Grafiku #11:

Sipas nivelit te punesimit, familjet e perfituesve te drejteperdrejte te intervistuar paraqiten si me poshte:

- pensioniste 41 pd ose 66.1% e te intervistuarve
- te punesuar 13 pd ose 20.9% e te intervistuarve
- te pa pune 8 pd ose 13.0% e te intervistuarve


Nga perfitues te drejteperdrejte te intervistuar, vetem 7 ose 11.3% e familjeve te tyre perfitonin ndihme ekonomike.

Niveli i papuncsise paraqitet pothuajse ne te njejten shkalle si niveli mesatar i qarkut te Tiranës(13.8%), por gjithsesi e gjykojme si coincidence, per shkak te peshes se madhe te pensionisteve.

39 perfitues te drejteperdrejte te intervistuar ose 62.9% e totalit te perfituesve te intervistuar kishin nga nje ose me shume pjestare te familjes ne emigracion.

Shperndarja e sherbimeve sipas perfituesve te drejteperdrejte (dpd) ishte si me poshte,			
Edukim	62 perf te dpd	ose	100.0% e perf. te intervistuar
Shlodhje argetim	41 perf te dpd	ose	66.1% e perf. te intervistuar
Keshillim ligjor	5 perf te dpd	ose	8.5% e perf. te intervistuar
Mbrojtje ndaj te kercenuarve	10 perf te dpd	ose	17.0% e perf. te intervistuar
Sherbime rehabilitimi	20 perf te dpd	ose	34.1% e perf. te intervistuar
Trajtim i familjes	20 perf te dpd	ose	34.1% e perf. te intervistuar
Sherbim baze shtepie	5 perf te dpd	ose	8.5% e perf. te intervistuar
Sherbim Shendetesor	62 perf te dpd	ose	100.0% e perf. te intervistuar

Kurse sipas sherbimeve te perfituara, perfituesit e intervistuar klasifikohen si me poshte



**Grafiku #11:** Perfituesit e Intervistuar Sipas Sherbimeve te Perfituara

Vetem 12 perfitues te intervistuar, ose 19.3% e gjithe perfituesve te intervistuar, kane perfituar sherbime sociale nga qendrat sociale para se ato te perfshiheshin ne projektin e mbeshtetur financiarisht nga BB. Ajo cka eshte evidente nga kjo pasqyre eshte se sherbimi i perfituar nga perfituesit e drejteperdrejte eshte multidimensional, me nje mesatare per cdo perfitues prej 3.5 sherbimesh.

## 22. Përshtatshmëria e shërbimeve të projektit ndaj përfituesve

Ne kete pjese do te vleresohet pershtatshmeria nga kendveshtrimi i perfituesve. Nese do t'i referohemi opinioneve te grumbulluara nga intervistat me perfituesit (Pyetja 6 – Pyetesori per Perfituesit) rezulton se 2/3 e të intervistuarve ishin “të kënaqur” nga shërbimi i ofruar. Ketu perfshihen kryesisht perfituesit e qendrave Kombinat (PAK), Every Child (Tirane, Shkoder) (nenat), Dimensioni Human Shkoder, The Door Shkoder, qendra e planifikimit familjar Vlore, etj. Në të njëjtën kohë, një përqindje disi me e vogel, rreth gjysma e te intervistuarve dëshironte të ndryshonte llojin e shërbimit, referuar disa

perfituesve, kryesisht vajza te reja ne qendrat Vaqarr, Kamez, Shkoder, Vlore etj. Ka rreth 20% qe shprehen disi te kenaqur, kryesisht Fushe Kruje, Vlore dhe nje pjese e vleresonin shërbimin jo të lidhur në mënyrë të drejtperdrejte me nevojat e tyre.

Ndër faktorët që çonin në idene e mungeses se përshtatshmerise se sherbimeve, të intervistuarit cilësohen faktore te mjedisit, te tille si:

- a) 50 % ambientet e papërshtatshme si rezultat i mospërfundimit të rikonstruksionit të ndërtesave që do të shërbejnë për zbatimin e projektit; (Pasqyra Anekse #8).
- b) 20 % distanca e përfituesve nga qendrat që ofrojnë shërbimin social kryesisht në zonat rurale si Vaqarr, Kamëz dhe Bushat dhe mungesa e mjeteve te transportit. veçanerisht per PAK.
- c) 30 % per te ndryshuar llojin e sherbimit ose sherbime te tjera vec atyre qe u afrohen, si dhe shkaqe te tjera me individuale.

Pra, ne pergjithesi ka nje vleresim te tille ku si perfituesit e drejtperdrejte edhe familjaret e tyre shprehen te kenaqur me sherbimin e ofruar nga qendrat dhe i konsiderojne ato te pershtatshme per nevojat e tyre. Por sa te kenaqur jane me sherbimin, aq kerkues jane per forma te reja sherbimesh, per te cilat kane shprehur kerkesa. Kjo sepse nevojat e tyre jane te shumta dhe prandaj sherbimet e reja te mbeshtetura nga projekti SSD jane multidimensionale. Konkretisht, po t'i referohemi Pasqyres nr.5 mbi llojet e sherbimeve te ofruara, rezulton qe shumica e tyre jane klasifikuar si qendra multidimensionale, por qe aktualisht e kane te kufizuar veprimtarine e tyre per shkaqe te permendura ne pjesen e OJF-ve.

Ne rastin e qendrave ditore te sherbimeve per PAK (Kombinat) apo femijet, familjaret e femijeve qe merrnin sherbime shprehen teper te kenaqur me cfare u ofrohej. Madje ata i kishin zhvendosur femijet nga qendra te tjera, disa edhe pse keto ishin ne distance me te largeta nga shtepite e tyre. Ne Kombinatin nje nene me femijen e saj PAK vinte cdo dite duke bere nje ore rruge ne kembe, prandaj nje nga kerkesat urgjente te kesaj qendre ishte mjete i transportit per PAK, qe dominonin perfituesit e saj.

*"Eshte absurde- shprehet drejtuesja e qendres se sherbimeve sociale – qe femijet normale kane mjete transporti per te shkuar ne shkolla dhe ne nuk mund tua ofrojme kete mjete transporti ketij grupi qe dihet se nevojat i ka shume me te medha, per me teper kur edhe familjaret e tyre shpesh jane edhe ata PAK. Megjithate, keta familjare, teper te interesuar per femijet e tyre, bejne sakrifica te perditshme per te frekuentuar qendren"<sup>47</sup>.*

Megjithate, situata paraqitet edhe me komplekse, qofte edhe brenda nje qendre te vetme sherbimesh. Konkretisht, ne rastin e sherbimit ne Kamez, ku pretendohet nje qender sherbimi per femijet parashkollore dhe per nenat e femijeve, grate e vajzat e reja. Nga intervistat me nenat, kryesisht te reja te papuna, te grupmoshes 20-30 vjeç dhe te shperngulura vitet e fundit ne kete zone, ato ishin te kenaqura per sherbimin ndaj femijeve, e shihnin ate teper te pershtatshem per integrimin e tyre ne komunitetin e ri ku kishin ardhur, por pretendonin shume me teper per sherbimet ndaj tyre. Ato kerkonin sherbime punesimi, informimi, ndermjetesimi dhe keshillimi nga punonjesja sociale apo psikologjia, qe t'u pergjigjeshin nevojave te tyre. E njejtja kerkese ishte edhe nga te rejat e Vaqarrit, te cilat jane vetem 20 minuta larg Tiranes dhe kerkonin te perfshiheshin ne kurse formimi profesional ne Tirane.

Nga kendveshtrimi zonal, niveli me i larte i perceptimit si "teper te pershtatshme" nga ana e përfituesve për shërbimet e ofruara është në Qarkun e Shkodrës, ku edhe

<sup>47</sup> Shih: Nga intervista me znj. Rajmonda Prifti, drejtuese e qendres se sherbimeve sociale, Kombinatin, Tirane, BIA E Projektit SSD, QSHKE 2006.

problemet e varfërisë janë më të theksuara, prandaj edhe interesimi i pushtetit lokal pritej të ishte më i madh për mbeshtetjen e tyre. Kështu, 107 perfitues janë të kenaqur me shërbimet, të cilët përbejnë 78% nga të 137 të intervistuarit. Ndërsa në Qarkun e Durrësit sipas vërtetimit rezultojnë "të kënaqur" 10,5% e të intervistuarve, e lidhur kjo me mungesën e ambjentëve për ofrimin e shërbimit.<sup>48</sup> Kurse në qarkun e Tiranës shprehen "të kenaqur" 141 perfitues, ose rreth 69% e tyre dhe në atë të Vlores 45 perfitues, ose 73% e tyre.

Prioritet e llojeve të shërbimeve janë të lidhura me kategoritë sociale që përfshijnë shërbime. Në këtë mënyrë, për kategorinë e fëmijëve prioritarë mbeten problemet e edukimit, për gratë dhe të rinjtë shërbimet e punësimit, për të moshuarit rritja e shërbimeve në shtëpi. Gjithsesi, nevojat prioritarë të këtyre grupeve sociale ndryshojnë në varësi të rajonit ku zbatohet projekti. Psh. fëmijët në Kamez, krahas edukimit, nevojë prioritarë kanë integrimin, kjo si pasojë e zhvendosjes së popullsisë nga zonat malore drejt zonave urbane. Të rinjtë e Fushë Krujës, kanë më tepër nevojë për integrim në komunitet, pasi shumica janë të papunë dhe një pjesë e tyre kanë patur rekorde kriminale. Gratë e Vlorës kanë nevojë prioritarë integrimin dhe ndihmë psiko-sociale, si rezultat i vendodhjes gjeografike të qytetit të Vlorës, ku mundësia e trafikimit jashtë vendit është më e madhe. Të moshuarit në Shkoder shprehin më tepër nevojën për shërbime në shtëpi, sesa frekuentimin e tyre në qendrën ditore.

Po t'i referohemi Pasqyrës nr. 3, mbeshtetja nga projekti SSD i takon vetëm vitit korrent, prandaj veshitë të behen vleresime mbi ecurinë në kohë të shërbimeve si impakt i projektit.

Nisur nga intervistat me perfituesit: Pyetja: "Cili ka qenë burimi juaj i informacionit për këto qender" mori këto përgjigje:

a) Familjaret dhe t'afërmit	35%
b) Autoritetet vendore (bashki/komune)	30%
c) Zyra rajonale e SHSSH	5% (Vetëm Shkodra)
e) Qender Tjeter	30%

(vete secila qender me kalimin e kohës, me reputacionin që ka krijuar, si dhe qendrat e tjera)

Sic shihet, tre janë burimet kryesore të informacionit për shërbimet sociale të ofruara nga OJF-te: familjaret, administratoret sociale të pushtetit vendor dhe vete qendrat sociale që referojnë tek njëra-tjetra klientet për shërbime sociale. Kjo është e evidente sidomos në zonën e Tiranës, ku vete qendrat, sikurse tregon Pasqyra nr. 2 kanë një veprimtari ekzistuese të mëparshme në këtë fushë. Familjaret mbeten gjithmone një burim i rëndësishëm informacioni, ndërkohe që roli i zyrave rajonale të SHSSH, që pritej të ishte më i ndjeshëm, është tepër i kufizuar, vecanërisht në Tiranë.

Spektri i shërbimeve të ofruara nga qendrat sociale ishte mjaft i gjerë. Nga pikpamja e specialiteteve në 12 qendra nga 15 të monitoruara ishte shërbimi i psikologes, 70%, e të cilave ishin me arsim të lartë profesional, në të 15 qendrat kishte 1-2 punonjës socialë sipas target grupit që iu shërbente qendrave, në 11 prej tyre kishte edukator dhe në të 14 qendrat (kurse njëra ishte në tentativë e sipër) sigurohej shërbimi mjekësor. Ashtu siç është përmendur edhe më sipër, jetëgjatësia e aktivitetit të këtyre qendrave është e vogël, por ajo ç'ka pamë, veçanërisht për përkushtimin e psikologes dhe punonjës socialë, është shumë premtuese për të ardhmen. Është komoditet i madh që në komuna me rreth 8,600 banorë si në Vaqarr, apo me rreth 3,063 banorë në Krrabë të ketë psikologë, kur në këtë raport për banorë ose grupe në risk mund të mos ketë në asnjë qytet të madh. Njëherazi ky është një ogur premtues për shërbime të kualifikuara dhe efektive për shërbime të përshtatshme.

<sup>48</sup> Ndërtesa e qëndrës, investim i Projektit SSD ishte në përfundim të rikonstruksionit, prandaj shërbimi për të moshuarit ofrohej në ambientet e bashkisë.

Evident është fakti që shërbime të rëndësishme nuk kishin kontigjente të plota përfituesish, por jepeshin si shërbime me efekte parandaluese, për klientët që frekuentonin aktualisht qendrën. Kështu p.sh 82% e grave që merrnin shërbime në qendër ishin trajtuar me dhenie informacioni e biseda mbi dhunën në familje, dhunën ndaj gruas dhe fëmijëve. Shërbimi më i përshtatshëm dhe i pëlqyer nga përfitueset gra, ishte ai i planifikimit familjar, në të cilin gërshetohej shërbimi i mjekut, psikologut dhe punonjësit social dhe ku frekuentimi dhe pjesëmarrja aktive e përfituesve ishte maksimale. Aspekti i integritetit, si tek të rinjtë dhe tek gratë ishte ende i zbehtë dhe i pafuqishëm e jo integruar për përfituesit. Në evidencat e pjesëmarrësve në këto raste sigurohej një pjesëmarrje prej 6 deri në 10 gra e vajza.

Me interes do të ishte, që edhe për efekt të trajnimit të stafëve, për efekt të përshtatshmërisë së shërbimeve ndaj përfituesve, midis 15 qendrave sociale që përfshin projekti pilot, të bëhen takime me rotacion, midis vetë qendrave, për atë lloj shërbimi, që ato kanë përvojë maksimale në frekuentim dhe veçanërisht në rrezatim të përfitimit jashtë qendrës sociale. Kjo mund të shërbejë edhe për hartimin e një *“Manuali për përshtatjen e shërbimeve sipas target grupeve”*. Zyrat rajonale të SHSSH në të ardhmen mund të luajnë një rol të rëndësishëm në këtë përhapje të modeleve me të mira të shërbimeve sociale.

### 23. Pjesëmarrja e përfituesve në faza të ndryshme të shërbimeve

Pjesëmarrja e përfituesve në faza të ndryshme të projektit rezultojnë të jetë e ndryshme. E rëndësishme është që në të gjitha qendrat, përfituesit konsiderohen të kenë rol kryesor në hartimin e programeve të shërbimeve sociale. (Pasqyra Aneks 4/6) Nga ballafaqimi i asaj që ofrohet dhe asaj ku shprehet perceptimi dhe kërkesat e përfituesve, rezultojnë se nuk është aq e lehtë që në çdo rast programet e shërbimeve të ndryshohen në interes të klienteve. Aresyet janë përmenduar edhe në pjesën e ofruesve.

Nga intervistat e zhvilluara rezultojnë se 72% e të intervistuarve shprehin se marrin pjesë që në fazën e vlerësimit të nevojave, nëpërmjet takimeve individuale dhe në grupe, 13% nëpërmjet pyetësorëve që u vihen në dispozicion nga stafi i qendrës, ndërsa 15% janë indiferent ndaj këtij procesi. Kuptohet që për target grupin e fëmijëve nevojat e tyre reflektohen në programe nëpërmjet përfituesve indirekt (Familjarëve të tyre). Kërkesat e përfituesve pasqyrohen pastaj në planet ditore/ mujore të OJF-ve, si në Vaqarr. Kombinat. Pra, ata marrin pjesë aktive, jo vetëm në procesin e vlerësimit të nevojave, por kjo shërben edhe si pikënisje e programimit të shërbimeve sociale.

Nga vizitat në qendrat e shërbimeve, u konstatua se përfituesit - klientet dhe familjarët e tyre - komunikojnë mirë si me drejtuesit e qendres, ashtu dhe me stafin profesionist. Ndonese të kufizuar me kërkesat e tyre, anëtarët e komunitetit i shihnin këto shërbime të ofruara nga qendrat si një fillim i mbare për të zhvilluar shërbime edhe me të shumta për të ardhmen.

Pavarësisht se pjesa më e madhe e përfituesve janë përfshirë në zbatimin e aktiviteteve të ofruesve të shërbimit, aktivizimi i komunitetit si në projektet aktuale edhe në projektet e ardhshme sociale kërkon hartimin e strategjive për përfshirjen e komunitetit, që përgjithësisht mungojnë. Ka disa tentativa të vecanta të OJF-ve me përvojë për përfshirjen e përfituesve edhe në zbatimin e programit – rasti i Kombinatit – për kjo praktike ende është në fillimet e saj.

Nga vëzhgimi ynë rezultojnë se vetëm 6 OJF nga 15 OJF ofruese të shërbimeve (ose 37,5%) janë ftuar të marrin pjesë në vlerësimin e nevojave për shërbime sociale nga pushteti vendor.<sup>49</sup> Pra, ndikimi i projektit për zhvillimin e planeve komunitare ende

<sup>49</sup> Kryesisht 4 në Tiranë, 1 në Fushe Krujë dhe 1 në Orikum.

ndjehet me teper ne Tirane, e lidhur kjo edhe me kapacitetet me te zhvilluara te organeve te pushtetit vendor te kryeqytetit.

58% e të intervistuarve i kanë shprehur kerkesat e tyre për shërbime nëpërmjet kontakteve me stafin e qëndrës. (Menaxher/Koordinator, Punonjës social, psikolog, edukator, mjek). Kjo reflektohet pastaj prej tyre ne programet e shërbimeve dhe mund te konsiderohet edhe pjesëmarrje e përfituesve në vlerësimin e shërbimeve. Por nuk ka perpjekje nga OJF-te, edhe ne zbatim te standardeve te shërbimeve sociale, per te terhequr perfituesit ne vleresim sistematik. Madje, ne nje pjese te mire te rasteve, edhe ne Tirane, ka OJF (Vaqarri, Kamza), dhe Fushe Kruja ne zonen e Durrësit, qe nuk jane kane as dijeni per standardet e shërbimeve sociale.

Ne lidhje me programet, ka nje larmishmeri shërbimesh sociale te mbështetura nga projekti SSD. Ka nje planifikim kryesisht mujor, ndonese ne qendrat e shërbimit ditor ka edhe plane ditore, vecanerisht per grupe te tilla si PAK, dhe femijet. Ne keto raste, kerkesave nga perfituesit apo familjaret e tyre, ofruesit ju pergjigjeshin ne menyre te drejtperdrejte me ndryshimin e programeve te tyre. Konkretisht, ne qendren Dimesnioni human ne Shkoder, vete te moshuarit i drejtoheshin punonjesit social per ndryshime ne planet ditore, kur organizoheshin veprimtari ne qytet ku ata donin te ishin te pranishem; sikurse kerkonin mjekun per vizite ne shtepi, ne rastet kur nuk mund te shkonin ne qender. Keshtu qendrat e shërbimeve sociale siguronin vazhdimesine e trajtimit te dyanshem, nga qendra dhe nga institucionet e tjera te kujdesit shendetesor ne komunitet. Dhe raste te tilla te ngjashme ato kishin vazhdimisht, per trajtime te klienteve te tyre sipas kerkesave te familjareve, apo te vete klienteve sipas rastit. Pothuajse ne te gjitha qendrat ishin pergatitur dosje qe plotesoheshin me te dhenat per perfituesit, si per shërbimet mjekesore, apo edhe mbi zhvillimin psiko-motorr ne rastin e PAK.

Instrumentet e perdorura per vleresim nevojash variojne ne varesi te llojit te shërbimit dhe te perfituesve. Per qendrat qe ofronin keshillim per gra e te rinj, plani mujor behet i ditur paraprakisht dhe cdo perfitues bente nderhyrjet sipas interesit. Kuptohet qe reagimi ne planin e ardhshem merrte ne konsiderate ato kerkesa qe jane te mundshme per tu realizuar dhe qe perputhen me misionin e qendres se shërbimit. Konkretisht, grate e Vaqarrit shprehin interesin per t'u keshilluar ne lidhje me mundesi formimi profesional dhe ofruesit grumbullojne informacione per kurse formimi profesional ne Tirane dhe bejne ndermjetesimin qe ato te rregjistrohen ne keto kurse sipas interesit. Po keshtu, pas pajisjes se qendres Krrabe me kompjutera, ato planifikonin kurse per mesim kompjuteri per te rinjte e zones qe kishin shprehur interes ti njihnin e perdornin kompjuterat.


Apo pervoja nga Every Child Shkoder, qe duke pasur parasysh paaftesine e individeve ne nevojte per te shprehur kerkesat e tyre drejtperdrejte, ata kishin aplikuar metoden e terheqjes se mendimeve te tyre nepermjet vendosjes se nje kutie ku secili shprehte kerkesat/ankesat. Edhe ne Vlore tek shoqata e planifikimit familjar, apo ne qendren Dimension Human ne Shkoder. Kjo perben nje kerkese te standardeve te shërbimeve sociale.

Mund te thuhet se ende nuk eshte punuar sa duhet per njohjen e dokumentit te standardeve te shërbimeve sociale, qe te kete nje linje te percaktuar ne menyren e vleresimit te nevojave dhe qe programet e shërbimeve te pasqyronin keto nevoja.

## 24. Përfituesit direkte dhe indirektë të shërbimeve

Nga analiza e qendrave sociale që u perfshine ne vzhgim, rezultoi se ato gjatë paraqitjes së projekteve konkurruese kishin parashikuar të trajtonin gjithsej 23,020 përfitues, prej të cilëve 6,700 ose 29.1% përfitues direkte dhe 116,320 (ose 70,9%)

përfitues indirektë<sup>50</sup>. Shpërndarja e përfituesve sipas target grupeve në shkallë vendi paraqitet në diagramën e mëposhtme:



**Grafiku #12:** Shperndarja e Perfituesve ne Shkalle Vendi

Vlen te theksohet se nga drejtuesit dhe stafet e qendrave nuk kish një vizion të qartë për përfitimet indirekte dhe kjo gjë pak reflektohej në analien e veprimtarisë së tyre. Kjo ishte më sinjifikative për ato qendra sociale që ofronin shërbim për një kategori të caktuar dhe më pak evidente tek ato që ishin multidimensionale, në kuptimin e grupeve në risk që merrnin persiper t'u ofronin shërbime.

Në qendrat me kohë të shkurtër aktiviteti, të krijuara si rezultat i projekti SSD në Vaqarr, Krrabë, Fushe Kruje veprimtaria ishte fokusuar në përfitimet e klientëve direkt dhe më pak tek përfituesit indirekt. Kurse në qendrën Kombinat PAK, multidimensionale Vlorë, E. Ch. Tiranë apo The Door dhe multidimensionale Shkodër përpjekja për të evidentuar edhe përfituesit indirektë dhe për t'i bërë ata pjesë aktive të veprimtarisë së qendrës ishte më e dukshme.

Evident ishte fakti që pjesa më aktive e përfituesve indirektë ishin veçanërisht nënat e fëmijëve që trajtoheshin në qendër, qoftë fëmijë në risk<sup>51</sup> apo ato PAK, sikundër ndodhte në E.Ch. Tiranë, Shkoder, Kombinat apo The Door në Shkodër. Por nuk mund të quheshin aktive përfituesit indirekte në qendrat sociale ku trajtohen të moshuarit në Oriku dhe ne Fushe Kruje.

Megjithatë ka një diversitet të theksuar të përfituesve të drejtperdrejte dhe jo të drejtperdrejte sipas qarqeve dhe target grupeve.

Kështu ndërsa në **Tiranë** gratë që kanë përfutuar shërbime direkte zënë **44,7% të** të gjithë përfituesve, në **Shkodër** **50,2%** të tyre, në Vlorë ato zënë vetëm **22.5 %** të përfituesve. Sipas gjykimit tonë kjo e ka burimin në disa fakte:

- Në Shkodër dhe në Tiranë ka shumë të ardhur nga zona verilindore dhe gratë nga këto zona për shkak të vështirësive ekonomike, por edhe për nevojën e integritimit në jetën e qyteteve të mëdha janë më shumë të prirura për të frekuentuar qendra sociale.
- Në projekt/idetë e tyre, qendrat janë fokusuar në këtë kategori, pasi grate janë kontigjent që konsiderohen si më të lehta për t'u trajtuar, në krahasim me kategoritë e tjera (fëmijët, të moshuarit, PAK etj)
- Është kontigjenti që rrezaton më shumë tek përfituesit indirektë (familjet, fëmijët, burrat etj). Kjo duket edhe nga fakti se përfituesit indirektë të target grupit gra zënë 77% të totalit të këtij target grupi.

<sup>50</sup> Shih: Aneks #6/1, Te dhena mbi Anketimin sipas Qarqeve dhe Grupeve Sociale, BIA e SSDP, ACER 2006

<sup>51</sup> Shih: Aneks #6/4. Te dhena mbi Anketimin e Grupit Femije, BIA e SSDP, ACER 2006

Është pozitiv fakti që kanë filluar të mbeshteten me shërbime sociale edhe të rinjtë, veçanërisht po të përfshihet ketu edhe target grupi i grave të reja. Këto shërbime janë me të përhapura në qarkun e Vlorës, ku zënë 33% të të gjithë target grupeve që marrin shërbim. Shërbime për këtë target grup është e nevojshme të ofrohen me teper në Qarkun e Shkodrës, ku të rinjtë në risk zënë gati 40% të grupeve në risk në përgjithësi. Në qytetin e Shkodrës në veçanti, ky target grup në veçanti ka kontigjente të prirur për t'u implikuar me krime që e kanë burimin kryesor në gjakmarrje, por edhe në faktorë të tjerë social-ekonomikë, si niveli lartë i papunesisë dhe varferisë. Po ashtu edhe në qarkun e Durrësit, që përfaqësohet nga qendra e Fushe Krujes, pësha specifike e të rinjve është relativisht e ulët, në raport me të moshuarit që zënë vendin kryesor në shërbimet e ofruara.

Ndër perfituesit indirekte janë klasifikuar grupet që shërbimin e ofruar në përfitimin direkt të klientit e shohin edhe si përfitim të: familjareve të tij, në të gjitha rastet, apo të komunitetit – si shkolles në Krrabe, Kombinat, qendres shëndetsore në Krrabe, Fushe-Kruje; rritjes së reputacionit të pushtetit vendor – Krrabe, si dhe zbutjes së problemeve sociale të komunitetit në përgjithësi; përmirësimit të marrëdhënieve në familje – Vaqarr; gjallërimit të jetesës së komunitetit në Krrabe, etj. Në rastin kur qendrat janë multidimensionale, nuk ndihet mirë përfitimi konkret i perfituesve, por që është me teper në përfitim të komunitetit në përgjithësi. – tipike Krraba. Perfitues indirekte në Kombinat është shkolla, ku përfshihen edhe femijë PAK që arrijnë të futen në sistemin e edukimit me femijet normale, 3 të tilla për vitin 2006 nga qendra e Kombinatit.

## 25. Vlefshmëria dhe cilësia e shërbimeve të OJF-ve

Sa të gatshëm janë ofruesit për t'ju përgjigjur nevojave? Ketu rezulton se ndonëse ofruesit janë të hapur dhe në intervistat me to del që ata duan të vihen totalisht në dispozicion të perfituesve, nga analiza e OJF-ve rezulton se kjo jo gjithmone është e lehtë të arrihet. Sot për sot, shërbimet e ofruara sikurse analizohet me siper konsiderohen të vlefshme për perfituesit dhe me pak nga autoritetet vendore, që ende nuk kanë marrë përgjigje që ju takojnë në fushën e shërbimeve sociale.<sup>52</sup>

Përfituesve dhe stafëve të projektit u është kërkuar të shprehin opinionet e tyre mbi cilësinë e ofrimit të shërbimeve sociale. 27,7 % e perfituesve të intervistuar patën mundësi të shprehin lirshëm në lidhje me cilësinë e shërbimit, pasi kishin qënë përfitues të këtyre shërbimeve edhe më parë. 50,4 % nuk patën mundësi të shprehin qartë mbi cilësinë e shërbimit, pasi shërbimet janë relativisht të reja dhe ato nuk kanë shumë informacion se çfarë ofrojnë ato. Pjesa tjetër u shprehën që nuk kanë njohuri.

Të gjithë të intervistuarit përgjigjeshin me vlerësim pozitiv maksimalisht për cilësinë e shërbimit të ofruar kur kjo pyetje iu drejtohej nëpërmjet pyetësorit. Por biseda me ta nxirrte në pah pretendime të tyre për shërbim cilësor. Duke mbajtur parasysh të dy këndvështrimet, rezultoi se vlerësimi i perfituesve për cilësinë e shërbimit sipas qarqeve ishte si më poshtë:

<sup>52</sup> Pasqyra nr.7 me qarqet, grupet në risk që dominojnë në to dhe shërbimet sipas llojit dhe qendrave që janë ngritur në qarqe të caktuara gjenden në Aneksin X.

Pasqyra #10

## Perceptimi i Perfituesve per nivelin e Sherbimit (ne perqindje) %

Qarku	Shërbim i njëjtë	Shërbim i përmirësuar pak	Shërbim i përmirësuar shumë	Shërbim i përkeqësuar
Tiranë	41,7	13,6	44,7	0
Shkodër	35,2	24,7	40,1	0
Vlorë	57,3	15,4	27,3	0
Durrës	36,2	27,3	36,5	0

Sipas gjykimit tonë, vlerësimin pozitiv për përmirësimin e cilësisë më shumë jepet nga impresioni i investimeve të bëra nga projekti për përmirësimin e ambjentëve dhe kompletimin e tyre me pajisje të kohës. Megjithatë kjo mungon në Kombinat, perfituesit shprehin vlerësimin maksimal për ndikimin e qendres në përmirësimin e jetesë së familjeve të femijëve AK që trajtohen aty.

Nga 104 perfituesit e intervistuar që u shprehën për cilësinë e shërbimit, 73 prej tyre u shprehën se cilësia e shërbimit është pak më e mirë sesa shërbimet e njëllajta të ofruara më parë nga këto qendra, apo nga qendra të tjera në komunitetet e tyre. Kjo ka ardhur si rezultat i kualifikimeve të ndryshme që kanë marrë profesionistët e qendrave, e përvojës së krijuar, krijimit të mjediseve – investim i drejtperdrejtë i projektit SSD dhe pajisjeve të nevojshme, bashkëpunimit me qendra të tjera që ofrojnë shërbime alternative, si dhe shtimin e llojeve të shërbimeve.

Kur të intervistuarve ju është drejtuar pyetja se çfarë dëshironi të ndryshoni në formën e shërbimit, përgjigja e tyre ka qenë se cilësia e tyre është normale dhe ndjehen mirë me këto lloje shërbimesh që ofron qendra. Vetëm në Vaqarr e Krrabe, 39 nga 56 perfitues të intervistuar (ose 69.6 %) perfitues direkte kërkojnë ndryshimin e llojeve të shërbimeve, duke i dhënë prioritet zhvillimit të shërbimeve për nxitjen e punësimit në fushën e agrobiznesit.

Rezultatet këtu tregojnë se shërbimet e ofruara janë të një cilësie relativisht të mirë, pasi nga 15 projekte në zbatim 5 janë të reja, nga të cilat 2 në zonat rurale të qarkut Tiranë. Megjithatë është e vështirë të arrijmë në një konkluzion të qartë për të bërë një vlerësim nëse shërbimet sociale janë të një cilësie më të mirë, pasi kemi mungëse informacioni dhe perfituesit nuk kanë mundësi perceptimi për të bërë krahasimin, për shkak të kohës relativisht të shkurtrë të veprimtarisë së tyre dhe faktit se në mjaft nga këto zona ato janë të vetmet shërbime sociale.

Qendrat ku ne besojmë se do të merrnim vlerësime në lidhje me këto çështje ishin pothuajse të sapo hapura, madje shumica me investime ende të papërfunduara. Për ato që ishin hapur, mund të thuhet se ishin krijuar mjedisë të tilla ku mundësitë për veprimtari të ndryshme, që nga informimet, keshillimet, formimet profesionale ishin të kënaqshme, ndonëse ende nuk kishin hyrë në funksione të tilla, për shkak të vonësive në pajisjet.<sup>53</sup>

Brenda të njëjtë lloj shërbimi dhe target grupi kishte ngarkesa të ndryshme për personelin që ofruar shërbimeve. Kështu në qendrën për të moshuarit e vetmuar në Vlorë ishin dy mjekë dhe një infermiere full time dhe deri tani iu ishte ofruar shërbimi 40 përfituesve direkt, ndërkohë në Orikum për 100 përfitues direkt ishte një mjek part time. Në të vërtetë nuk pamë ndonjë diferencë thelbësore në shërbimin shëndetësor midis dy qendrave të sipërcituara.


Në intervistat e bëra me nënat në Kombinat, The Door dhe E.Ch. Shkodër, apo Gruaja në Zhvillim Kamëz, rezultonte se ecuria e fëmijëve në shkollë, pasi kishin marrë

<sup>53</sup> Në Vaqarr dhe Krrabe, ambientet sapo ishin inauguruar, në Fushe Kruje shprehenin që punimet e objektit të përfundonin në fund të këtij viti.

shërbim në qendër, ishte më e mirë, si në pikpamje të frekuentimit ashtu edhe të rezultateve, gjë që nuk konfirmohej nga prindërit e intervistuar në Krrabe.

Pothuajse të gjitha gratë e intervistuar në qendrën sociale Vaqarr, megjithëse kishin vlerësim për cilësinë e shërbimit të ofruar, ai nuk ishte në përputhje me kërkesat e tyre dhe kushtet reale të jetës në fshatin Vaqarr. Pretendimi i tyre ishte për ofrim shërbimi për punësim e vetëpunësim në fushën e agrobiznesit, përpunimi i produkteve blegtorale, zhvillimi i fermave, rrobaqepësi etj, përpara shërbimeve të keshillimit psiko-social që iu ofrohej nga qendra.

Ne grafikun e mëposhtëm paraqitet plotësimi i nevojave të përfituesve në raport me cilësinë e shërbimeve.



**Grafiku #13:** Plotësimi i Nevojave Sipas Përfituesve në zonat Pilot

Nese do të bënim një klasifikim të përgjithshëm, nga pikpamja e zhvillimit ekonomik social, midis 4 qarqeve pilot, qarku i Shkodrës është qarku më i prapambetur midis tyre. Besojmë se kjo është edhe arsyeja pse kemi marrë një nivel më të lartë të përgjigjeve pozitive mbi plotësimin e nevojave nëpërmjet cilësisë së shërbimeve të ofruara. Po e njëjta tabllë paraqitet edhe brenda përbrenda qarkut. Kështu në zonën rurale të qarkut të Tiranës, në përgjigje të kësaj pyetjeje, vlerësim pozitiv japin 62.0 % e të intervistuarve.

Sipas vlerësimit të të intervistuarve, plotësimi i nevojave në mënyrë me cilësore është në këto drejtime:

- Për përmirësimin e marrdhenieve brenda familjeve, 29.8% e të intervistuarve,
- Për përmirësimin e marrdhenieve burrë-grua, 13.7% e të intervistuarve,
- Për përmirësimin e nivelit të mirërritjes së femijëve, 40.6% e të intervistuarve,
- Për përmirësimin e marrdhenieve prindër-fëmijë, 5.8 % e të intervistuarve,
- Për aspekte të tjera, 10.1% e të intervistuarve.

## 26. Ndikimi në jetën e përfituesve

Shumica e përfituesve mendojnë se shërbimet e ofruara<sup>54</sup> kanë ndikuar pozitivisht në jetën e tyre dhe të familjeve. Po ti referohemi qendrave, ndikimet e tyre janë në

<sup>54</sup> Shih: Aneks #4/5, Tipologjia e Shërbimeve sipas Grupeve të Përfituesve, BIA e SSDP, ACER 2006

drejtime te ndryshme, sipas tipologjise se sherbimeve qe ato ofrojne. Me konkretisht ato paraqiten si me poshte:

Pasqyra #11

### Llojet e Sherbimeve sipas Grupeve ne Risk

<b>Ndihimi ne jeten e pordhuesve - JEMINI</b>	
403 ose 100%	Permireson Edukimin
322 ose 80 %	Qender shlodhjeje/rekreative
101 ose 25%	Rrit Vete-besim/integrim
22ose 5,5%	Sherbim ne shkollë
214 ose 53%	Sherbim per kujdes shendetesor
<b>Ndihimi ne jeten e pordhuesve - KUNAJ</b>	
294 ose 100%	Permireson Edukimin
294 ose 100%	Qender shlodhjeje/rekreative
120 ose 41%	Rrit Vete-besim/integrim
294 ose 100%	Mbrojtje nga perdorimi i narkotikeve/drogave psikotrope
29 ose 10 %	Keshillim/Mbrojtje ligjore
265 ose 90%	Qendra informimi publik
194 ose 66%	Sherbim per kujdes shendetesor
<b>Ndihimi ne jeten e pordhuesve - QIRA</b>	
616ose 81%	Permireson Edukimin
472 ose 62%	Qender shlodhjeje/rekreative
411 ose 54%	Rrit Vete-besim/integrim
38 ose 5%	Mbrojtje nga perdorimi i narkotikeve/drogave psikotrope
235 ose 31%	Mbrojtje nga /prej trafikimi
502 ose 66%	Keshillim/Mbrojtje ligjore
320 ose 42%	Sherbime rehabilitimi
418 ose 55%	Trajtim i familjes
418 ose 55%	Qendra informimi publik
388 ose 51%	Sherbim per kujdes shendetesor
<b>Ndihimi ne jeten e pordhuesve - PAVK</b>	
35 ose 100 %	Permireson Edukimin
35 ose 100%	Qender shlodhjeje/rekreative
35 ose 100%	Rrit Vete-besim/integrim
35 ose 100 %	Sherbime rehabilitimi
35 ose 100%	Sherbime baze ne shtepi
25 ose 71%	Sherbim per kujdes shendetesor
<b>Ndihimi ne jeten e pordhuesve - DE MOSHAR</b>	
348 ose 100 %	Qender shlodhjeje/rekreative
248 ose 71 %	Rrit Vete-besim/integrim
348 ose 100 %	Keshillim/Mbrojtje ligjore
348 ose 100%	Sherbime rehabilitimi
60 ose 17%	Sherbime baze ne shtepi
348 oser 100%	Qendra informimi publik
348 ose 100 %	Sherbim per kujdes shendetesor

Përgjigjet e të intervistuarve përfitues gjykojnë se sherbimet sociale te mbeshtetura nga projekti kane patur një ndikim pozitiv në jetën e tyre. Kjo vërehet në atë

që 68 % e të intervistuarve janë të kënaqur nga niveli i shërbimit të ofruar, çka do të thotë se ka influencuar pozitivisht në jetën e përfituesve.

Efekte direkte në përmirësimin e jetës së përfituesve vërehen në Qendrën e hapur ditore (the Door) Shkodër e cila ju ofron 66 fëmijeve përfitues direkt një vakt ushqim si dhe ndihmë të hërëpasherëshme në ushqime familjeve të tyre. Përfitimi në sensin ekonomik për familjet, tek grate sepse ato vinin nga zonat e thella malore, nga një situatë ekonomike kritike, që karakterizon gjithë rajonin e Shkodrës. Indirekt është edhe shkolla, pasi në këto qender investohet në edukimin e fëmijeve. Grave, që kishin marrë nga projekte të tjera makina qepese, dhe aktualisht u ofroreshin kurse formimi profesional që t'i përdornin ato në favor të rritjes së mirëqenies së familjes dhe ngritjes së nivelit të komunitetit në përgjithësi.

Ndikimi i këtyre shërbimeve ndihet edhe në jetën e komunitetit të cilit i shërben (përfitues indirekt –Komuniteti). Meqenese zbatimi i atyre që janë totalisht të mbështetur nga projekti i BB është përgjithësisht në fazat fillestare, duket pothuajse e pamundur matja e treguesve të përmirësimit të jetësës së këtyre përfituesve.

Megjithatë ajo çka ne vëmë re është se sa më shumë largohemi nga qendra (Tiranë) në rrethe aq më funksionale dhe me një shkallë përgjegjësie më të madhe janë qendrat që ofrojnë shërbimin. Kjo si rezultat i mundësive të pakta që ka atje, krahasuar me Tiranën, numri i ofruesve të shërbimeve dhe i mundësive për punësim. Prandaj dhe të krijohet pershtypja se ato kanë një ndikim më të madh në jetën e përfituesve, të cilët i konsiderojnë shërbimet “teper të pershtatshme”, sikurse është përmendur edhe më sipër.

Në përgjithësi, një kerkese për të rritur Ndikimin e shërbimeve në jetën e përfituesve ishte ofrimi i shërbimit në shtëpi, gati 90% e përfituesve të intervistuar të shërbimeve për të moshuarit, kishin si tendencë të kërkonin shërbimet në shtëpi. Kjo sipas vleresimit të tyre dhe të ofruesve, kryesisht nga intervistat me drejtuesit e qendrave, do të sjelle përmirësime të ndjeshme në jetën e përfituesve të këtij grupi.

Shumica e OJF-ve që kishin aplikuar për t'u mbështetur nga projekti i BB kishin përvojë të pasur në trajtimin e target grupeve dhe, në një vështrim të përgjithshëm, pjesëmarrja në projekt iu kish shërbyer për të konsoliduar shërbimet ekzistuese, duke i zgjeruar shërbimet e tyre ekzistuese. Në shumicën e rasteve ato kishin zgjeruar gamën e shërbimeve, duke ofruar një larmishmeri shërbimesh që nga ato të kujdesit shëndetësor, keshillimi psiko-social, keshillim juridik dhe informim-ndermjetesim, ku ishin tërhequr profesionet e reja të psikologut dhe punonjësit social.

## 27. Ndikimi i shërbimeve të ofruara mbi target grupet në risk

Në bazë të qarku do të kishim këta përfitues të trajtuar deri në fillim të muajit dhjetor 2006:

Pasqyra #12

Numri i Perituesve të Trajtuar nga SSDP sipas Qarqeve

Qarku	Përfituesit											
	Fëmije				Te Rinj				Gjithsej (Fëmije+te Rinj)			
	PD	Në % ndaj vendit	PI	Në % ndaj vendit	PD	Në % ndaj vendit	PI	Në % ndaj vendit	PD	Në % ndaj vendit	PI	Në % ndaj vendit
Tiranë	145	36.0	295	26.1	85	28.9	105	18.2	230	33.0	400	23.5
Shkodër	258	64.0	835	73.9	89	30.3	220	38.3	347	49.8	1055	61.8
Durrës	-	-	-	-	20	6.8	50	8.7	20	6.8	50	8.7
Vlorë	-	-	-	-	100	34.0	200	34.8	100	34.0	200	34.8
Gjithsej	403	100	1130	100	294	100	575	100	697	100	1705	100

Karakteristika dalluese e grupit të fëmijëve ishte se në të përfshiheshin kryesisht fëmijë të familjeve në vështirësi ekonomike. Kjo besojmë se është dhe shkak që si në qendrën sociale Kamëz dhe atë The Door në Shkodër kishte pjesëmarrje maksimale të fëmijëve, sepse qendra iu ofronte dhe një vakt ushqimi, që ishte jashtë financimit të projektit të BB. Nga afër pamë se ky ushqim ishte tepër minimal dhe i thatë (produkte të ambalazuara).

Ne do të sugjerorim që në thellim të këtij shërbimi nga këto qendra, mund të bëhet një kombinim investimesh që projekti të nxise njësitë vendore përkatëse të kontribuojnë në shpenzimet për ushqim. Ndërkohë që edhe stafi i qendrave mund të kërkojë vete mbështetje nga biznesi lokal për të financuar (qoftë edhe në natyrë), për ushqimin e këtyre fëmijëve.

